13. Спроведување ништење на податоци прибавени со ПИМ - Да се обезбеди доследна примена на законските одредби за ништење на податоците прибавени со примена на ПИМ, во случаи кога се исполнети законските услови, со цел да се гарантира заштита на правата на засегнатите лица, да се намали ризикот од неоправдано задржување класифицирани информации и лични податоци и да се зајакне интегритетот и довербата во постапките поврзани со ПИМ.

14. Заштита на адвокатско-клиентската привилегија - Да се напушти практиката на слушање телефонски разговори остварени помеѓу обвинет и неговиот адвокат во судница за време на расправа, бидејќи тоа ја нарушува адвокатско-клиентската доверливост и правото на одбрана.

15. Јасна регулација на судската контрола - Да се дефинира подетално начинот на спроведување на судската контрола врз органите овластени за примена на ПИМ, вклучително и техничките аспекти на таа контрола, со цел зголемена правна сигурност и отчетност.

16. Институционален дијалог и усогласување на практиката - Да се воспостави редовна пракса на организирање средби помеѓу судии, јавни обвинители и инспектори кои работат на спроведување на ПИМ, за дискутирање на предизвиците и усогласување на ставовите околу спорните прашања.

Користена литература

публикации:

Council of Europe, Recommendation CM/Rec (2017) 6 of the Committee of Ministers to member States on “special investigation techniques” in relation to serious crimes including acts of terrorism.

Deployment of Special Investigative Measures, COE, Office in Belgrade, Serbia, 2013, достапно на: <https://rm.coe.int/deployment-of-special-investigative-measures-eg/16807828fa>.

Hert, P. (2005). Balancing security and liberty within the European human rights framework. A critical reading of the Court’s Case law in the light of surveillance and criminal law enforcement strategies after 9/11. *Utrecht Law Review* 1: 68–96.

Mc Bride, J. (2018). *Human Rights and Criminal Procedure*, 2-nd Ed., Council of Europe.

The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts’ Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, Brussels, 8 June 2015. https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2016-12/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf.

Turanjanin, V. (2022). Special investigative measures: Comparison of the Serbian Criminal Procedure Code with the European Court of Human Rights Standards, *The International Journal of Evidence & Proof*, Vol. 26(1) 34–60.

Јанкуловски, З. (2000). Заштита на приватноста во Република Македонија (потреба за измена на чл. 17 од Уставот на Република Македонија) во Полицијата, јавното обвинителство, судот и адвокатурата во преткривичната постапка, Здружение за кривично право и криминологија на Македонија, Скопје.

Калајџиев, Г. (2004). Уставна рамка на приватноста и новите истражни мерки, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“, Скопје.

Калајџиев, Г., Ѓурчилова, П. (ур.). (2019). Прирачник за спроведување на мерките за следење на комуникациите, ДЦАФ - Центар за управување во безбедносниот сектор - Женева, подружница Скопје.

Калајџиев, Г., Лажетик Бужаровска, Г., Мисоски, Б., Илиќ Димоски, Д. (2015). Казнено процесно право, Скопје.

Калајџиев, Г., Лажетик, Г., Неделкова, Л., Денковска, М., Тромбева, М., Витларов, Т., Јанкуловска, П., Кадиев, Д. (2018). Коментар на законот за кривичната постапка, ОБСЕ, Скопје.

Лич, Ф. (2010). Поднесување на предмет пред Европскиот суд за човекови права, Табернакул.

Марјановиќ, Ѓ. (2002). За прислушувањето и за (не) одговорноста, Зборник на трудови Евроинтеграција - идеи, состојби, реализација, Правен факултет Јустинијан први, Скопје.

Матовски, Н. (2005). Новелата на Законот за кривична постапка на Република Македонија од 2004 година, Скопје.

Периќ, Ц. и др. (2024). Водич за ништење податоци собрани со посебни истражни мерки. Скопје: ДЦАФ, <https://jorm.gov.mk/vodich-za-nishtene-podatoczi-sobrani-so-posebni-istrazhni-merki/>.

правни акти:

Закон за внатрешни работи („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 160/2025)

Закон за кривичната постапка („Службен весник на Република Македонија“ бр. 150/2010, 100/2012, 142/2016 и 198/2018). Одлука на Уставниот суд на Република Македонија У. бр. 2/2016 од 28 септември 2016 година, објавена во „Службен весник на Република Македонија“ бр. 193/2016

Закон за Оперативно-техничка агенција („Службен весник на Република Македонија“ бр. 71/2018 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 98/2019)

Закон за следење на комуникациите („Службен весник на Република Македонија“ бр. 71/2018 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 108/2019 и 154/2023)

Устав на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 52/1991), со Амандманите I и II на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 1/1992), Амандманот III на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 31/1998), Амандманите IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII и XVIII на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 91/2001), Амандманот XIX на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 84/2003), Амандманите XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX и XXX на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 107/2005), Амандманот XXXI на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 3/2009), Исправката на Амандманот XXXI на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 13/2009), Амандманот XXXII на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 49/2011), Амандманите XXXIII, XXXIV, XXXV и XXXVI на Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ број 6/2019) и Објавата („Службен весник на Република Македонија“ број 36/2019).

ИЗВЕШТАИ:

Годишни извештаи на Јавното обвинителство на Република Северна Македонија за примена на посебни истражни мерки за периодот 2019-2024 година <https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>.

Годишни извештаи за работата на Оперативно-техничката агенција за периодот 2018-2024 година <https://ota.mk/odnosi-so-javnost/izvestai>.

АНЕКС I

ПРАШАЊА ЗА ФОКУС ГРУПА СО ПОЛИЦИСКИ ИНСПЕКТОРИ И ИСТРАЖИТЕЛИ

1. Кои се најчестите причини поради кои правосудната полиција предлага до јавното обвинителство примена на посебни истражни мерки?
2. Со какви предизвици се соочувате при собирање и доставување докази за оправданост на предлогот?
3. Како ја оценувате соработката со Јавното обвинителство при иницирањето на вакви мерки?
4. Дали одредени предлози биле одбиени и кои биле главните причини за тоа?
5. Со какви логистички и технички предизвици се соочувате при спроведување на мерките?
6. Каква контрола над спроведувањето на посебните истражни мерки се врши и од кого?
7. Дали постои потреба од дополнителна обука или ресурси за поефикасно користење на посебните истражни мерки?

ПРАШАЊА ЗА ФОКУС ГРУПА СО ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ

1. Дали предлозите за примена на ПИМ се вообичаено добро образложени и аргументирани?
2. Кои се главните правни и фактички предизвици при проценката на предлозите од правосудната полиција за примена на посебни истражни мерки?
3. Дали одредени предлози сте одбиле и кои биле главните причини за тоа?
4. Дали постојат случаи кога предлозите биле формално исправни, но не сте ги проследиле пред судот во форма на барање? Ако да, зошто?
5. Како ја оценувате соработката со правосудната полиција во процесот на предлагање и подготвување на барањата?
6. Како го оценувате судското одлучување во однос на одобрувањето или одбивањето на мерките?
7. Дали сте се соочиле со правни, институционални или технички пречки при примената на посебните истражни мерки?
8. Како го контролирате спроведувањето на посебните истражни мерки?

ПРАШАЊА ЗА ФОКУС ГРУПА СО СУДИИ

1. Кои се главните критериуми што ги земате предвид при одобрување или одбивање на барањата за посебни истражни мерки?
2. Дали барањата за издавање наредба за примена на ПИМ се вообичаено добро образложени и аргументирани?
3. Какви се најчестите недостатоци во барањата поднесени од јавното обвинителство?
4. Како ја оценувате меѓуинституционалната соработка, комуникација и координација на надлежните органи задолжени за спроведување на посебните истражни мерки со обвинителството и судот?
5. Врз основа на кои причини најчесто се бара продолжување на посебните истражни мерки?

6. Дали и врз основа на кои докази во Вашата практика била проширена наредбата за посебна истражна мерка?
7. Дали се преземаат доволно ефикасни мерки за заштитата на тајноста на спроведувањето на посебните истражни мерки?
8. Како го контролирате спроведувањето на посебните истражни мерки?
9. Дали сметате дека постојните законски рамки доволно ги дефинираат условите за примена на овие мерки?
10. Дали има примери на судска пракса каде што посебните истражни мерки биле исклучени како незаконски прибавени докази и поради кои причини било тоа?
11. Со какви предизвици се соочувате при изведување на докази кои се прибавени со примена на посебни истражни мерки?

ПРАШАЊА ЗА ФОКУС ГРУПА СО АДВОКАТИ

1. Дали сметате дека постои доволна судска контрола и надзор врз спроведувањето на ПИМ?
2. Дали добивате навремен и целосен пристап до материјалите добиени преку ПИМ кога браните клиент?
3. Какви предизвици постојат при користење на доказите прибавени преку ПИМ во судските постапки?
4. Дали постои стандардизирана практика или воочувате разлики меѓу различни судови или судии при прифаќање или исклучување на доказни материјали добиени преку ПИМ?
5. Дали сметате дека е потребна поголема стручна обука за адвокатите по ова прашање?

**ZBATIMI I MASAVE TË
POSAÇME HETIMORE
NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

Shkup, 2026

Autorët:

Prof. Dr. Biljana Karovska Andonovska, Doc. Dr. Kire Babanoski, Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev, Mr. Daniella Dimovska, Sandra Krstiq, Pajazit Pajaziti, Mr. Nenad Saveski, Ermon Neziri, Natasha Saramandova, Mr. Verica Berzhecka Krsteva, Engjëllushe Lleshi Kadriu, Gavriil Bubevski, Spasenka Andonova, Snezhana Petroviq Arsovska, Mr. Aleksandar Tumanovski, Mr. Gent Salihi, Mr. Radmilla K.Onçevska

Redaktor:

Mr. Gent Salihi

Numri I faqeve 152 / Printuar në Polyesterday Shkup / Tirazh 250

Botuesi:



©DCAF, 2025 All rights reserved DCAF – Geneva Center for Security Sector Governance
Maison de la Paix Chemin Eugène-Rigot 2E, CH1202- Geneva, Switzerland

©DCAF, 2025 Të gjitha të drejtat janë rezervuara DCAF – Qendra e Menaxhimit të Sektorit të Sigurisë
- Gjenevë - Zyra në Shkup rr. Maqedonia nr. 1000, 11-1/2 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Hulumtimi u implementua në kuadër të Programit të Reformës së Sektorit të Sigurisë dhe Zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i zbatuar nga DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë dhe i mbështetur financiarisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Programi, ndër të tjera, ndihmon institucionet e sistemit të drejtësisë dhe praktikuesit juridikë të forcojnë kapacitetet dhe ekspertizën e tyre të nevojshme për zbatimin konsekuent të procesit të kërkesës dhe miratimit gjyqësor të masave të posaçme hetimore.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk i shpreh pikëpamjet dhe opinionet e donatorëve apo të DCAF.



Parathënie

Vendimi për implementimin e këtij hulumtimi lindi nga nevoja për të analizuar në mënyrë sistematike zbatimin e masave të posaçme hetimore (MPH) në praktikën gjyqësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo qasje mundëson të kuptuarit më të mirë të mënyrave në të cilat MPH-të miratohen, zbatohen dhe kontrollohen, me qëllim që të përcaktohen sfidat praktike dhe të formulohen udhëzime për promovimin e tyre.

Metodologjia e implementimit të hulumtimit u bazua në një qasje të kombinuar që i bashkon metodat kualitative dhe kuantitative, duke e përfshirë analizën e kuadrit ligjor, prezantimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore zyrtare dhe zbatimin e fokus grupeve. Përmes kësaj qasjeje, u siguria një panoramë e plotë e aspekteve normative, institucionale dhe praktike të zbatimit të MPH.

Procesi i implementimit të hulumtimit përfshiu disa faza: mbledhjen dhe sistematizimin e të dhënave, organizimin e katër fokus grupeve me gjyqtarë, prokurorë publikë, inspektorë të policisë, hetues dhe avokatë, si dhe analizën e njohurive të siguruar. Nëpërmjet këtij procesi u identifikuan disa çështje kryesore në lidhje me kuadrin ligjor, praktikën dhe kontrollin mbi zbatimin e MPH.

Pritshmëria që u vendos para këtij hulumtimi kishte të bëjë me sigurimin e njohurive të argumentuara që do të kontribuonin në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në zbatimin e masave, dhe rekomandimeve konkrete për avancimin e procedurave. Rezultatet e fituara treguan se një qasje e tillë sistematike jo vetëm që ofron një vështrim kritik të situatës aktuale, por përbën edhe bazën për përmirësime të mëtejshme të kuadrit institucional dhe ligjor në të ardhmen. Hapat e ardhshëm në lidhje me këtë hulumtim duhet të synojnë zbatimin e mëtejshëm dhe verifikimin praktik të rekomandimeve të dhëna, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të tendencave sa i përket zbatimit të masave në praktikën gjyqësore.

Procesi është pjesë e **Programit të Reformave në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut**. Zhvillimi i metodologjisë, hulumtimit dhe analizës u realizuan përmes një sërë aktiviteteve (takime koordinuese, fokus grupe, tryeza të rrumbullakëta, punëtori, etj.) të organizuara nga DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë, në periudhën tetor 2023 - tetor 2025. Implementimi i hulumtimit u iniciua me kërkesë të Grupit të Ekspertëve të Drejtësisë të DCAF Shkup dhe u miratua nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në përputhje me rekomandimet e Manualit për Zbatimin e Masave të Posaçme Hetimore dhe Udhëzuesit për Shkatërrimin e të Dhënave të Mbledhura me Masat e Posaçme Hetimore.

Raporti i këtij hulumtimi është një përpjekje e përbashkët e të gjithë pjesëmarrësve. Gjatë punës, praktikuesit dhe ekspertët e drejtësisë i diskutuan standardet e përcaktuara ndërkombëtare, i analizuan gjetjet e fokus grupeve, si dhe detyrimet ligjore në lidhje me zbatimin dhe kontrollin e masave. Përmes një procesi participativ, u përcaktuan objektivat dhe përmbajtja e dokumentit, metodologjia e hartuar dhe teksti i finalizuar i cili më vonë iu adresua institucioneve kompetente. Në këtë mënyrë u siguria verifikimi profesional shtesë dhe harmonizimi me nevojat e institucioneve gjatë zbatimit të MPH.

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë
Shkup, Shkurt 2026

Deklaratë nga Drejtoresha e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë

Format bashkëkohore të krimit, veçanërisht ato të krimit të organizuar, nuk mund të zbulohen dhe të sigurohen prova pa zbatimin e masave të posaçme hetimore. Këto masa përcaktohen vetëm në raste kur me mjete të tjera provuese nuk mund të sigurohen prova relevante. Zbatimi i tyre është rreptësisht i kufizuar, por i domosdoshëm për zbulimin dhe vërtetimin efikas të formave më të rënda të krimit. Ato paraqesin një cenim të disa lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, në funksion të mbrojtjes së shtetit dhe qytetarëve nga krimi i organizuar, korrupsioni, terrorizmi, si dhe për një luftë të suksesshme kundër tyre.

Në këtë kuptim, masat e posaçme hetimore mundësojnë mbledhjen e njohurive që ndryshe do të mbeteshin të paarritshme për shkak të fshehtësisë dhe kompleksitetit të tyre. Organizatat kriminale vazhdimisht futin inovacione në mënyrën e funksionimit, prandaj është me rëndësi që shtetet t'i përditësojnë teknikat hetimore për të realizuar hetime të suksesshme.

Rëndësia e këtyre masave buron jo vetëm nga efikasiteti i tyre operacional, por edhe nga ndjeshmëria e tyre juridike. Sipas standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdo kufizim i së drejtës për privatësi, e garantuar me nenin 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duhet të jetë proporcional me qëllimin legjitim, rreptësisht i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe i shoqëruar me garanci të përshtatshme kundër abuzimit. Në vendin tonë, masat e posaçme hetimore janë të harmonizuara me standardet evropiane, ndërsa zbatimi i tyre i nënshtrohet kontrollit të rreptë gjyqësor, arsytimit me shkrim dhe kufizimit kohor.

Ky kërkim synon të ofrojë një analizë të sistematizuar të kuadrit ligjor dhe të aspekteve praktike të zbatimit të masave të posaçme hetimore, të lidhë rregullativën vendase me atë evropiane dhe praktikën krahasuese, si dhe të ofrojë udhëzime për prokurorët publikë, gjyqtarët dhe hetuesit. Qëllimi është të ofrohet një mjet praktik, i qartë dhe i zbatueshëm për përmirësimin e profesionalizmit, unifikimin e praktikës dhe forcimin e sigurisë juridike në procesin e caktimit të këtyre masave. Besojmë se kjo analizë do të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të rolit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë si mbrojtës të sundimit të ligjit dhe të të drejtave të njeriut në procedurën penale.

Falënderim i veçantë për DCAF për bashkëpunimin e suksesshëm shumëvjeçar në kuadër të “Programit për reforma në sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021–2026)”, komponenti i projektit që ka të bëjë me forcimin e kapaciteteve të organeve vendase të drejtësisë në lidhje me zbatimin dhe kontrollin e metodave invazive për mbledhjen e informacioneve nga organet e ndjekjes penale dhe shërbimet e inteligjencës.

Irina Trajkoska-Strezoski

Drejtoresha e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev”, Shkup
Shkup, Shkurt 2026

PËRMBAJTJA

Parathënie	56
Deklaratë nga Drejtoresha e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë	59
Lista e tabelave	59
Lista e grafikëve	59
Lista e shkurtesave të përdorura	59
Hyrje	60
1. Metodologjia	61
1.1. Përcaktimi teorik i objektit të hulumtimit	61
1.2. Objektivat e hulumtimit	64
1.3. Kuadri kohor i hulumtimit	65
1.4. Metodot e hulumtimit	66
1.5. Rezultatet dhe implikimet e pritshme	67
1.6. Arsyeshmëria e hulumtimit	67
2. Kuadri ligjor për masat e posaçme hetimore	67
3. Dinamika dhe tendencat në zbatimin e masave të posaçme hetimore	70
4. Propozimi i masave të posaçme hetimore	78
5. Kërkesë për aplikimin e masave të posaçme hetimore	79
6. Vendimmarrja për aplikimin e masave të posaçme hetimore	80
7. Zbatimi i masave të posaçme hetimore	81
7.1. Kohëzgjatja e masave të posaçme hetimore	83
7.2. Masat për mbrojtjen e fshehtësisë së zbatimit të masave të posaçme hetimore	84
8. Përdorimi i masave të posaçme hetimore si provë në procedurën penale	85
9. Bashkëpunimi ndërinstitucional gjatë aplikimit të masave të posaçme hetimore	87
10. Trajnimi dhe resurset për përdorimin më efikas të masave të posaçme hetimore	88
11. Kontrolli dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e masave të posaçme hetimore	89
11.1. Kontrolli mbi zbatimin e masave të posaçme hetimore	89
11.1.1. Kontrolli gjyqësor mbi aplikimin e masave të posaçme hetimore	89
11.1.2. Kontrolli i prokurorit publik mbi aplikimin e masave të posaçme hetimore	90
11.2. Mbikëqyrje mbi aplikimin e masave të posaçme hetimore	91
Konkluzione	93
Rekomandime	97
Literatura e përdorur	99
ANEKSI I	101

Lista e tabelave

Tabela 1. Pasqyrë komparative e të dhënave që duhet t'i përmbajnë raportet vjetore për MPH nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	71
Tabela 2. Pasqyrë e rasteve me MPH të aplikuara për periudhën 2010-2024	72
Tabela 3. Pasqyrë e MPH-ve të aplikuara sipas llojit të masës për periudhën 2015-2024	74
Tabela 4. Pasqyrë e rasteve të kohëzgjatjes së aplikimit të MPH nga neni 252, paragrafi 1, pika 1 për periudhën 2019-2024 të shprehura në muaj	76
Tabela 5. Pasqyrë e numrit të komunikimeve të aktivizuara nga AOT sipas autoriteteve të autorizuar për periudhën 2018-2024	77

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Pasqyrë e rasteve me MPH të aplikuara për periudhën 2010-2024.....	73
Grafiku 2. Pasqyrë e numrit të përgjithshëm të MPH-ve të aplikuara për periudhën 2015-2024.....	73
Grafiku 3. Pasqyrë e MPH-ve të aplikuara nga neni 252, paragrafi 1, pikat 1, 3 dhe 6 për periudhën 2015-2024.....	74

Lista e shkurtesave të përdorura

ACMIS	Sistemi i Automatizuar i Informacioneve Për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore (Automated Court Case Management Information System - ACCMIS)
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtat e Njeriut
LPP	Ligji për Procedurën Penale
LNK	Ligji Për Ndjekjen e Komunikimeve
TIK	Teknologjia e informacionit dhe telekomunikacionit
PP	Prokuroria publike
KP	Kodi Penal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
PTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
AOT	Agjencia Operative-Teknike
MPH	masa të posaçme hetimore
PSP	Prokuroria Speciale Publike
DPF	Drejtoria e Policisë Financiare

Hyrje

Masat e posaçme hetimore janë teknika të zbatuara nga autoritetet kompetente në kontekstin e hetimeve penale me qëllim parandalim, zblimin, hetimin, ndjekjen dhe luftimin e veprave të rënda penale¹. Ato kanë vlerë të lartë provuese, por paraqesin edhe ndërhyrje serioze në sferën e privatësisë së personave të dyshuar². Natyra e tyre është invazive dhe shpesh joselektive, si në kuptimin personal ashtu edhe në atë përmbajtjesor. Konsiderohen si masa jokonvencionale të cilat nga aspekti i të drejtave të njeriut, janë në kufirin e justifikimit për shkak se imponojnë një shmangie të domosdoshme nga vlerat e mbrojtura tradicionalisht.

Për shkak të këtyre karakteristikave, MPH hapin dilema në lidhje me garancitë e të drejtave personale, justifikimin e invazionit mbi privatësinë e individëve, sigurinë publike kundrejt asaj personale, prezumimin e pafajësisë dhe çështje të tjera sensitive. Megjithatë, inkorporimi i tyre në legjislacionet procedurale penale disa dekada më parë u imponua si një alternativë për t'u përballur në mënyrë efektive me krimin e organizuar dhe manifestimin e tij transnacional. Padyshim, në shoqëritë moderne demokratike, MPH përfaqësojnë një mjet adekuat për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale. Legalizimi i tyre nënkuptonte pranimin e një lloj kompromisi midis kërkesave për mbrojtjen e sigurisë publike, kundrejt garancive për respektimin e të drejtave të njeriut. Për të arritur një ekuilibër midis këtyre interesave thelbësore, thelbësore është përpjekja që të reduktohen në minimum mundësitë e cenimit të të drejtave individuale në funksion të sigurisë. Shteti duhet të ndërtojë një kornizë ligjore që do të sigurojë mbrojtje adekuate dhe efektive për mbrojtje nga keqpërdorimi i mundshëm të MPH dhe në secilin rast konkret të sigurojë prova eksplicite për domosdoshmërinë e zbatimit të tyre.

MPH-të janë pjesë e praktikësë procedurale penale maqedonase për njëzet vjet. Zbatimi i tyre në praktikë filloi në vitin 2005, ndërkaq tendenca e rritjes ishte evidente në vitin 2008, kur u krijuan kushte ligjore për zbatimin e masës së posaçme hetimore e cila e përfshin ndjekjen e komunikimeve në kushtet dhe procedurë të përcaktuar me ligj të posaçëm. Përkatësisht, si anëtare e organizatave ndërkombëtare relevante që fillojnë ta adresojnë seriozisht problemin e krimit të organizuar, krimit transnacional dhe terrorizmit në fund të shekullit të 20-të, Republika e Maqedonisë e kishte detyrimin të përfshihej në përpjekjet aktuale dhe të ardhshme r formuese që synonin parandalimin dhe luftimin efektiv të këtyre dukurive bashkëkohore shoqërore negative.

Reformat në legjislacionin e procedurës penale dhe inkorporimi i të ashtuquajturave metoda jokonvencionale për ballafaqimin me sfidat bashkëkohore për sigurinë publike, ndër të tjera, duhej të përfshinin inkorporimin e metodave speciale dhe përdorimin e teknikave që përfshijnë shmangie nga garancitë kushtetuese për të drejtën e privatësisë, fshehtësinë e komunikimeve, paprekshmërinë e shtëpisë dhe sigurinë e të dhënave personale.

Procesi i miratimit dhe zbatimit të masave të posaçme hetimore është kompleks dhe multidimensional. Në këtë proces janë përfshirë subjekte të ndryshme, të cilat më tej i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit nga subjekte të tjera relevante. Çdo subjekt, përmes prizmit të kompetencës së tij, duhet të vlerësojë me kujdes nevojën e ndërhyrjes në privatësinë e individëve në kontekstin e të gjitha rrethanave të rastit. Konform standardeve ndërkombëtare, nuk lejohet nënvlerësimi a priori i privatësisë para interesit për mbrojtjen e sigurisë.

Në këtë hulumtim analizohet praktika e sistemit të drejtësisë (praktika prokuroriale dhe gjyqësore) sa i përket miratimit, zbatimit dhe kontrollit të MPH. Analiza bazohet në supozimin se subjektet e ndryshme në këtë proces përballen me një sërë sfidash, secila nga perspektiva

¹ Council of Europe, Recommendation CM/Rec (2017) 6 of the Committee of Ministers to member States on "special investigation techniques" in relation to serious crimes including acts of terrorism.

² Hert, P. (2005). Balancing security and liberty within the European human rights framework. A critical reading of the Court's Case law in the light of surveillance and criminal law enforcement strategies after 9/11. *Utrecht Law Review* 1: 68-96.

e vet e kompetencës për të vepruar. Midis tyre, sigurisht, është sfida e balancimit të interesit të përgjithshëm në mbrojtjen e sigurisë kundrejt interesit të individëve në respektimin e privatësisë së tyre. Standardi i pranuar përgjithësisht se nga interesi individual për mbrojtjen e privatësisë duhet të shmanget vetëm nëse vlerësohet si e vetmja mënyrë për të mbrojtur një interes tjetër të lartë publik, e imponon detyrimin për autoritetet kompetente në këtë proces që të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe të propozojnë e miratojnë MPH vetëm nëse zbatimi i tyre është i nevojshëm si mjet i fundit, ultima ratio, në një rast konkret. Kjo kërkon zbatimin e parimit të subsidiaritetit ose gradualizmit, përkatësisht të fillohet me zbatimin e masave nga më pak intruzive në më shumë intruzive, ndërkaq të kërkohej dhe të lejohet zbatimi i masave më intruzive vetëm nëse ato më pak intruzive nuk e japin rezultatin e pritur.

Qëllimi që u vendos në këtë hulumtim është fokusuar në perceptimin gjithëpërfshirës dhe real të të gjitha sfidave dhe miratimit e konkluzioneve relevante në lidhje me zbatimin e MPH. Duke u udhëhequr nga ky qëllim, hulumtimi u zbatua me përdorimin e disa metodave relevante kërkimore shkencore³. Gjatë zbatimit të tyre, nuk është neglizhuar asnjë segment nga vargu i veprimeve procedurale të ndërmarra gjatë miratimit dhe zbatimit të MPH, duke filluar me propozimin për zbatimin e MPH të cilin policia gjyqësore ia dërgon prokurorisë publike, përmes kërkesës së prokurorisë publike për miratimin e MPH të cilën ia dërgon gjykatës, lëshimin e urdhrit për MPH nga gjyqtari i procedurës paraprake, zbatimin e MPH nga organet e autorizuar, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi zbatimin, kështu deri në përdorimin e rezultateve të MPH të zbatuar në procedurën penale. Propozimet për tejkalimin e sfidave, të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e praktikës, janë rezultat i këtyre observimeve. Hulumtimi kishte për synim të perceptojë në mënyrë të paanshme këndvës trimet e ndryshme të subjekteve të përfshira në këtë proces kompleks. Së këtejmi, në hulumtimin u përfshinë dhe u morën në konsideratë perceptimet e hetuesve në policinë gjyqësore, të cilët punojnë në sigurimin e informacioneve operative për ngjarje të veçanta të drejtësisë penale, të cilët propozojnë zbatimin e MPH, prokurorëve publikë në prokuroritë themelore publike bashkë me hetuesit në qendrat hetimore pranë prokurorive themelore publike, gjykatësve të procedurës paraprake, personave të autorizuar autoriteteve të autorizuar që punojnë në zbatimin e MPH-ve të miratuara, si dhe perceptimet e gjyqtarëve të trupit gjykues. Nuk ishte lënë anash as perceptimi i mbrojtjes nga sfidat me të cilat ballafaqohen mbrojtësit e të dyshuarve përkatësisht të pandehurve, në procedurën penale.

Në këtë hulumtim janë analizuar edhe të dhënat statistikore nga zbatimi njëzet vjeçar i MPH-ve në praktikën e drejtësisë maqedonase. Si baza relevante për hulumtimin janë përdorur të dhënat zyrtare të përfshira në raportet vjetore të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat në përputhje me nenin 271 të Ligjit për Procedurën Penale (LPP) i a paraqet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në bazë të këtyre të dhënave u monitorua dhe komentua tendenca e miratimit të MPH. Objekt i analizës ishin edhe të arriturat nga zbatimi i masave të posaçme hetimore të miratuara në drejtim të efikasitetit dhe rezultatit përfundimtar që rezultoi me një vendim përkatës gjyqësor.

1. Metodologjia

1.1. Përcaktimi teorik i objektit të hulumtimit

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit (TIK) dhe shtrirja dhe prania e saj në jetën e përditshme të qytetarëve e lehtëson ndjeshëm mënyrën e kryerjes së veprave penale dhe komunikimin midis kryerësve të tyre. Nga ana tjetër, me zhvillimin e arritjeve shkencore dhe teknologjike, po avancohet gjithnjë e më shumë praktika kriminalistike-operative për zbulimin e mënyrës së kryerjes dhe kryerësve të veprave penale. Pikërisht këto mjete moderne e përbëjnë burimin e provave të shumta, por njëherësh jashtëzakonisht cilësore dhe të

³ Metodologjia për zbatimin e këtij hulumtimi u propozua nga Prof. Dr. Boban Misoski, Prof. Dr. Aleksandra Guevska-Drakulevski dhe Prof. Dr. Besa Arifi.

vlefshme, përmes të cilave vërtetohet kriminaliteti para gjykatave⁴.

Duke i marrë parasysh karakteristikat e këtyre mjeteve të provave, mund të konstatohet se ato ndryshojnë në një masë të madhe nga mjetet tradicionale të provave. Këto janë mjete të provave që kanë një shkallë të lartë besueshmërie dhe duke i përdorur ato marrim të dhëna të drejtpërdrejta në lidhje me kryerësin e veprës penale dhe marrëdhëniet e tij me njerëz të afërt me të, të cilët në masë të madhe bëjnë pjesë në jetën e tij personale kurse sasia më e madhe e provave të këtij lloji merret me ndihmën e mjeteve bashkëkohore të provave⁵.

Pikërisht për shkak të këtyre karakteristikave, këto mjete provuese quhen edhe mjete të posaçme hetimore. Veçoria e këtyre mjeteve hetimore karakterizohet nga specifika që me këto mjete të provave, shpesh autoritetet e ndjekjes përdorin edhe metoda pro aktive për zbulimin e kryerësve, të cilat më së shpeshti nënkuptojnë ndërhyrje në sferën e jetës personale dhe private të personit të dyshuar. Atëherë, në një fazë të hershme të hetimit të një veprë të kryer penale ose në fillim të procedurës penale, organet e ndjekjes përdorin mjete elektronike për regjistrimin audio ose video, kërkimin elektronik të të dhënave kompjuterike, përdorimin e personave me identitet të fshehur si agjentë provokatorë ose themelojnë subjekte juridike të simuluar për të kryer operatione ekonomike të simuluar për të zbuluar veprat e kryera penale nga personat e dyshuar/pandehur⁶.

Duke i marrë parasysh karakteristikat e MPH, mund të konstatohet se ato janë një nga mjetet më efektive, por njëherësh edhe mjetet më kontroverse pro aktive të provës, për zbulimin dhe vërtetimin e kryerësve të veprave të rënda penale⁷. Arsyet për këtë qëndrojnë në faktin se personi ose personat ndaj të cilëve zbatohen këto masa ende nuk është provuar faji i tyre për kryerjen e veprës penale, ndërsa organet e ndjekjes janë akoma në nivelin e dyshimit të bazuar, kurse në të njëjtën kohë, personi të drejtat personale të të cilit kërcënohen nga zbatimi i tyre mbrohet me garancinë kushtetuese të prezumimit të pafajësisë. Së këtejmi, domosdoshmërisht imponohet detyrimi për zbatimin restriktiv të këtyre masave⁸.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare që janë përfshirë në legjislacionin kombëtar, MPH duhet të zbatohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, përkatësisht në rastet kur mbledhja e provave për të përcaktuar përgjegjësinë penale të kryerësit të veprës penale nuk është e mundur me mjete të tjera të provës, përkatësisht zbatimi i MPH bëhet vetëm me përjashtim edhe atë vetëm për vepra më të rënda penale⁹.

Duke e marrë parasysh specifikën, por edhe ndërhyrjen në jetën personale të personit të dyshuar/pandehur si rezultat i zbatimit të MPH, trajtimi i të dhënave të mbledhura me MPH është një çështje veçanërisht e rëndësishme që është trajtuar në mënyrë adekuate si nga legjislacionet kombëtare ashtu edhe përmes jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)¹⁰. Kështu, përmes aktgjykimeve, GJEDNJ e ka etabluar parimin se

⁴ Se bëhet fjalë për mjete bashkëkohore të provës relativisht të reja, zbatimi i të cilave në fillim ishte relativisht i parregulluar, është e dukshme edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së në Strasburg, e cila për herë të parë i trajtoi këto masa në vitet 1980, për shembull përmes lëndëve: *Malone v United Kingdom* 8691/79 ose *Huvig v France* 11105/84.

⁵ Shih: Hert, P. (2005). Balancing security and liberty within the European human rights framework. A critical reading of the Court's Case law in the light of surveillance and criminal law enforcement strategies after 9/11. *Utrecht Law Review* 1: 68-96

⁶ Për herë të parë të inkuorporuara në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Procedurës Penale në vitin 2004, të inspiruar nga nevojat për harmonizimin e legjislacionit kombëtar fillimisht me Konventën e OKB-së për luftë kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC), ose më mirë e njohur si Konventa e Palermos e OKB-së, dhe më pas të rishikuara në Ligjin e ri të Procedurës Penale të vitit 2010. Shih: *Matovski, N* (2005). *Ndryshimi i Ligjit të Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë të vitit 2004*, Shkup, f. 24-25

⁷ Shih: *Turanjanin, V.* (2022). Special investigative measures: Comparison of the Serbian Criminal Procedure Code with the European Court of Human Rights Standards, *The International Journal of Evidence & Proof*, Vol. 26(1) 34-60.

⁸ Shiko më shumë: *Deployment of Special Investigative Measures*, COE, Office in Belgrade, Serbia, 2013, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/deployment-of-special-investigative-means-eng/16807828fa>.

⁹ Shih: *Kallajxhiev, G., Lazhetiç Buzharovska, G., Misoski, B., Iliq Dimoski, D.* (2015). *E drejta procedurale penale*, Shkup, si dhe neni 252 i LPP-së.

¹⁰ Shih: *McBride, J.* (2018). *Human Rights and Criminal Procedure*, 2-nd Ed., Council of Europe, f. 140-147, si *Liç, F.* (2010). *Paraqitja e lëndës në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, Tabernakul, f. 281-284.

është e domosdoshme ekzistimi i rregullave të qarta dhe të sakta në lidhje me MPH, sa i përket zbatimit të tyre, kufizimit të qartë të rrethit të veprave penale për të cilat do të zbatoheshin këto masa, kohëzgjatjes së tyre, si dhe fatit të të dhënave të mbledhura me këto masa. Kështu, parimi i kërkimit të rregullave të qarta ligjore për veprimin e organeve të ndjekjes, si dhe mënyrat e ruajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave MPH në rastet kur nuk ka ndjekje penale ose personave për të cilët janë mbledhur këto të dhëna nuk u është ngritur ndjekje penale, janë etabluar nëpërmjet aktgjykimeve të mëposhtme: Roman Zakarov v. Russia (GC) 47143/06 4 dhjetor 2015, ku gjykata gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nëse ligji nuk e parashikon mënyrën dhe kohëzgjatjen e ruajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave të marra përmes MPH ndjekja e fshehtë ose në P.G. and J.H. v. United Kingdom, 44787/98 datë 25 shtator 2001, si dhe Van Vondel v. Netherlands, 38258/03 datë 25.10.2007, të dyja në lidhje me masën e regjistrimit të fshehtë audio dhe video. Një parim i ngjashëm artikullohet edhe në aktgjykimin Weber and Saravia v. Germany, 54934/00 në lidhje me përgjimin e fshehtë të komunikimeve telefonike. Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës në Strasburg, është përcaktuar parimi i nevojës për normim ligjor të qartë dhe jo kundërthënës të procedurës së zbatimit të MPH, me ç'rast me ligj në këtë kuptim konsiderohet ligji në kuptimin material. Kështu që, në aktgjykimet: Malone v United Kingdom 8691/79 ose Huvig v France 11105/84, thuhet qartë se procedura për zbatimin e MPH nuk është e domosdoshme të jetë e normuar në ligj, përkatësisht mund të normohet edhe përmes akteve nënligjore, për sa kohë që e njëjta procedurë është e qartë, e parashikueshme dhe jo kundërthënëse.

Rrjedhimisht me këtë parashtrohet pyetja se çfarë do të thotë një procedurë e qartë, jo kundërthënëse dhe e parashikueshme? Përmes prizmit të GJEDNJ-së, parashikohet se duhet të përcaktohet qartë kohëzgjatja e masave, mënyra e zbatimit të këtyre masave, personat kompetentë t'i miratojnë dhe zbatojnë, si dhe kufizimi kohor i kohëzgjatjes së këtyre masave. Duhet të parashikohet edhe mundësia, përkatësisht detyrimi për kontroll të jashtëm mbi punën e autoriteteve të ndjekjes në rastet kur i zbatojnë MPH. Kështu, konsiderohet se gjyqtari i procedurës paraprake, si garantues i ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra gjatë procedurës paraprake nga autoritete e ndjekjes, përkatësisht nga prokurori publik dhe/ose policia gjyqësore, është mekanizmi fillestar i kontrollit dhe garancisë për zbatimin korrekt të MPH. Pastaj, dispozitat procedurale për një procedurë të ndershme, të ndërthurura me dispozitat e ligjit procedural - LPP i japin garanci shtesë personit të pandehur se MPH zbatohen në mënyrë të ligjshme dhe vetëm në raste legjitime. Kjo formë e kontrollit mbi zbatimin e MPH quhet edhe formë e brendshme ose formë sistemike e kontrollit, sepse sigurohet nga subjektet që ndërmarrin veprime procedurale gjatë veprimit/procedimit penal, ndërkaq tradicionalisht janë pjesë e pushtetit gjyqësor. Kjo formë kontrolli është, në fakt, kontroll nga gjykata, edhe atë më së shpeshti gjyqtari i procedurës paraprake në çdo rast konkret. Së këtejmi, në përputhje me dispozitat e nenit 256 të LPP, për MPH të nenit 252, paragrafi 1, pikat 6 deri në 12, kontrollin e bën vetë prokurori publik në momentin e përcaktimit, duke e garantuar ligjshmërinë e veprimeve procedurale të ndërmarra, në mënyrën që ai i përcakton ato, në varësi të nevojave të hetimit. Kjo ka të bëjë me përcaktimin e MPH të mëposhtme: këqyrje në komunikimet telefonike dhe komunikime të tjera elektronike; blerje e simuluar e sendeve; mitë dhënie dhe mitë marrje e simuluar; livrimi i kontrolluar dhe transporti i personave dhe sendeve dhe prolongimi i arrestimit ose sekuestrimit të sendeve; përdorimi i personave me identitet të fshehur për regjistrimin, monitorimin dhe mbledhjen e informacioneve ose të dhënave dhe infiltrimi në grupe të organizuara kriminale; hapje e simuluar të llogarisë bankare dhe regjistrim i simuluar i personave juridikë ose përdorimi i personave juridikë ekzistues për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e kushteve për infiltrim. Arsyeja e mungesës së gjyqtarit të procedurës paraprake si garant i ligjshmërisë së këtyre masave, kryesisht lind për shkak të natyrës dhe karakteristikave të këtyre MPH. Për më tepër, në rastet e zbatimit të MPH të lartpërmendura, e mira e mbrojtur e personit të dyshuar është në një nivel më të ulët, në krahasim me MPH të specifikuara në nenin 252, paragrafi 1, pikat 1 deri 5. Kështu, në rastin e MPH-ve të përcaktuara nga prokurori publik, ka masa që nuk nënkuptojnë ndërhyrje të thellë në sferën e mbrojtur të jetës personale të personit të dyshuar ose të pandehur, por bëhet fjalë për masa që kanë prapavijë kriminalistike-taktike.

Përveç kësaj forme të kontrollit të brendshëm, në mënyrë plotësuese, pas zbatimit të MPH, parashikohet detyrimi për Prokurorinë Publike si autoritet i ndjekjes për të paraqitur raporte vjetore për masat e zbatuara. Kjo formë e kontrollit mbi MPH quhet edhe formë e kontrollit të jashtëm, përkatësisht kontroll i pushtetit legjislativ mbi pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësor, i njohur përmes sistemit të kontrollit dhe balancit midis pushteteve shtetërore (check and balance). Inkorporimi i kontrollit të jashtëm është substancial në përmbushjen e disa objektivave. Objektivi i parë, siç u theksua më lart, konsiston me mbrojtjen e parimit të kontrollit dhe balancit midis autoriteteve shtetërore, me qëllim të parashikimit të kontrollit shtesë nga një palë e tretë e pavarur dhe e pa interesuar-pushteti i tretë që nuk merr pjesë në proceset e drejtësisë penale, përkatësisht nuk merr pjesë në ndjekjen penale dhe/ose gjykimin e kryerësve të veprave penale. Një qëllim shtesë që po përmbushet përmes inkorporimit të sistemit të kontrollit të jashtëm mbi punën e autoriteteve që i zbatojnë MPH pasqyrohet në rritjen e besimit mbi autoritetet e ndjekjes duke e rritur transparencën dhe llogaridhënien sa i përket punës së këtyre autoriteteve para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por njëherësh edhe para publikut të gjerë. Së këtejmi, kjo formë e kontrollit mbi zbatimin e MPH, perceptohet përmes detyrimit të Prokurorisë Publike për të paraqitur raporte vjetore mbipunën e saj, por njëherësh edhe detyrimit për autoritetet shtetërore që i zbatojnë MPH që konsiston me ndjekjen e komunikimeve për llogaridhënien vjetore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut¹¹. Megjithatë, në përputhje me këtë që u tha më lartë, për të përmbushur qëllimin e zbatimit efektiv të MPH-ve përmes procedurave të qarta, pa ambiguiditet dhe jo kundërthënëse, është e nevojshme të zhvillohet edhe një metodologji adekuate për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të MPH nga autoritetet e ndjekjes. Përkatësisht, duhet të përfshihen kritere të qarta për vlerësimin dhe monitorimin e mënyrës së zbatimit të MPH, si dhe kritere për matjen e efikasitetit të MPH. Gjegjësisht, a justifikohet zbatimi i MPH, dhe me këtë a mbrohet qëllimi që synon ndjekjen dhe gjykimin efektiv të kryerësve të veprave penale të rënda dhe serioze. Pikërisht në kushtet e ekzistimit të një kuadri të vetëm metodologjik për kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të MPH, sigurohet edhe zbatimi i njëtrajtshëm i tyre, njëherësh duke e shmangur mundësinë e abuzimeve të mundshme ose zbatimin selektiv të këtyre masave nga autoritetet e ndjekjes. Për më tepër, për dallim nga mbikëqyrja, kontrolli nuk synon vetëm konstatimin e gjendjeve, por gjithmonë shoqërohet me udhëzime, masa dhe obligime konkrete të detyrueshme, madje edhe përcaktimin e përgjegjësisë për funksionimin e konstatuar të paligjshëm të institucionit që është objekt kontrolli. Nëpërmjet mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi zbatimin e MPH, sigurohet: ligjshmëria (sundimi i ligjit), efikasiteti (përshtatshmëria dhe ekonomizimi gjatë planifikimit të realizimit të kompetencave dhe qëllimeve të parashikuara) dhe efektiviteti (suksesi në realizimin e qëllimeve të përcaktuara) i zbatimit të këtyre masave¹². Përmes inkorporimit të metodologjisë së vetme për monitorimin, kontrollin dhe raportimin para publikut për zbatimin e MPH do të sigurohej:

- një nivel më i lartë i sigurisë tek publiku i gjerë në lidhje me zbatimin e ligjshëm
- dhe legjitim të masave nga ana e autoriteteve të ndjekjes,
- besim më i lartë i publikut tek autoritetet që i zbatojnë këto masa,
- autoriteteve të ndjekjes do t'ju lehtësohej detyra jo aq e thjeshtë e zbatimit të
- drejtë dhe të ligjshëm të masave.

1.2. Objektivat e hulumtimit

Hulumtimi i praktikës gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për miratimin dhe zbatimin e MPH ka një objektiv të përgjithshëm dhe katër objektiva të posaçme. Objektivi i përgjithshëm i hulumtimit konsiston me analizën e zbatimit të MPH në të gjitha fazat e procedurës penale, përmes pasqyrës dhe analizës së praktikës gjyqësore për miratimin, zbatimin dhe kontrollin e MPH në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

¹¹ Nenet 35, 40 dhe 47 të Ligjit për Ndjekjen e Komunikimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/2019 dhe 154/2023) përcaktojnë se mbikëqyrja mbi masat për ndjekjen e komunikimeve që zbatohen nga autoritetet e autorizuar për ndjekjen e komunikimeve, operatorët dhe mbi AOT, kryhet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për Sigurinë e Informacioneve të Klasifikuar, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Avokati i Popullit, Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare dhe nga subjekte të tjera të rregulluara me ligj.

¹² Shih: Kallajxhiev, G., Gjurçilova, P. (ed.) (2019). Manual për Zbatimin e Masave Për Ndjekjen e Komunikimeve, DCAF - Qendra për Qeverisje në Sektorin e Sigurisë - Gjenevë, Zyra në Shkup.

Duke i kombinuar qasjet kualitative dhe kuantitative dhe duke përdorur metoda teorike dhe empirike, bëhen përpjekje të fitohen njohuri të argumentuara në lidhje me mënyrën, vëllimin dhe kontekstin e zbatimit të MPH, me qëllim që të identifikohen sfidat praktike, mospërputhjet ligjore dhe mundësitë për avancimin e procedurës. Objektivat e posaçme të hulumtimit janë si më poshtë:

1. Analiza longitudinale e zbatimit të MPH

Objektivi konsiston me krijimin e bazës për monitorimin e zbatimit të MPH në praktikën gjyqësore për një periudhë më të gjatë kohore, në mënyrë që të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse të dinamikës së zbatimit të tyre. Ky hulumtim do të mundësojë përcaktimin e tendencave, ndryshime në praktikën gjyqësore dhe vlerësimin nëse zbatimi i MPH është i justifikuar në mënyrë adekuate nga autoritetet e ndjekjes. Qasja longitudinale nënkupton që një analizë e tillë duhet të përsëritet në të ardhmen, në intervale të caktuara kohore, me ç'rast do të mundësohej monitorimi i zhvillimit, identifikimi i përmirësimeve të mundshme ose sfida të reja në praktikë, si dhe krijimi i bazës për të dhëna që do ta mbështesin reformën e kuadrit ligjor dhe institucional.

2. Vlerësimi i restriktivitetit të zbatimit të MPH

Duke qenë se MPH në masë të konsiderueshme ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë themelore, zbatimi i tyre duhet të kufizohet rreptësisht në vepra të rënda penale dhe në raste të jashtëzakonshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, standardet ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Hulumtimi synon të vlerësojë nëse MPH zbatohen në praktikën gjyqësore në mënyrë restriktive, në përputhje me parimet e përcaktuara në LPP.

3. Analiza e procedurave të administrimit me të dhënat e mbledhura me MPH

Hulumtimi do të shqyrtojë ekzistimin dhe zbatimin konsekuent të rregullave të qarta, të sakta dhe të parashikueshme për përdorimin, ruajtjen, fshirjen dhe shkatërrimin e të dhënave të mbledhura me MPH. Në përputhje me standardet e GJEDNJ-së dhe legjislacionin kombëtar, do të analizohet nëse autoritetet e ndjekjes dhe gjykatat veprojnë në përputhje me normat dhe procedurat e përcaktuara.

4. Analiza e mekanizmave të kontrollit mbi zbatimin e MPH

Hulumtimi do të analizojë mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit mbi zbatimin e MPH. Do të shqyrtohet roli i policisë gjyqësore si iniciatore, roli i prokurorit publik si iniciator dhe kontrollues i MPH, si dhe roli i gjyqtarit të procedurës paraprake si mekanizëm gjyqësor garantues dhe kontrollues. Në mënyrë plotësuese, do të paraqiten mekanizma të jashtëm për mbikëqyrje dhe llogaridhënie në zbatimin e këtyre masave.

1.3. Kuadri kohor i hulumtimit

Hulumtimi është përpjekja e parë për një analizë sistematike të praktikës gjyqësore në lidhje me miratimin dhe zbatimin e MPH në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Analiza e përfshin periudhën nga hyrja në fuqi të Ligjit për Procedurën Penale nga viti 2010 deri në fund të vitit 2024.

1.4. Metodatat e hulumtimit

Për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse dhe relevante të zbatimit të MPH në praktikën gjyqësore, në këtë hulumtim është zbatuar një qasje e kombinuar që përfshin disametoda. Kjo qasje mundëson një përfshirje sistematike të kuadrit ligjor, zbatimit praktik dhe përvojave të subjekteve relevante. Metodatat përzgjidhen në mënyrë që të mblidhen dhe analizohen të dhënat kuantitative dhe kualitative, të cilat do të kontribuojnë në të kuptuarit më të mirë të situatës, tendencave dhe sfidave në këtë sferë.

Analiza e kuadrit ligjor

Në kuadër të hulumtimit, u implementua analiza e legjislacionit relevant, me fokus mbi dispozitat e LPP-së që rregullojnë procedurën e propozimit, miratimit dhe zbatimit të MPH. Për më tepër, do të rishikohen edhe ligje dhe akte nënligjore të tjera të ndërlidhura, si dhe standardet dhe rekomandimet relevante ndërkombëtare, në mënyrë që të sigurohet një panoramë e qartë e kuadrit normativ në të cilin ato zbatohen.

Analiza e të dhënave statistikore

Në hulumtimin prezantohen të dhëna zyrtare statistikore, para së gjithash ato që janë përfshirë në raportet vjetore për zbatimin e MPH, të cilat Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka detyrim ligjor t' i paraqesë në Kuvend, në përputhje me nenin 271 të LPP-së. Këto raporte përmbajnë të dhëna për numrin e MPH-ve të miratuara dhe të zbatuara, të kufizuara sipas llojit të masave dhe sipas llojit të veprave penale, që do të mundësojë një analizë kuantitative të vëllimit, dinamikës dhe tendencave në zbatimin e tyre në periudhën kohore të hulumtuar. Të dhënat statistikore shërbejnë për këqyrje në dinamikën dhe tendencat e miratimit të MPH dhe njëherësh mbështetje për metodat e tjera hulumtuese. Nga ana tjetër, do të përmbledhen dhe do të prezantohen të dhënat për numrin e ndjekjeve të aktivizuara të komunikimeve nga Agjencia Operative-Teknike (AOT), konform raporteve që i paraqet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Fokus Grupet

Në kuadër të hulumtimit, u zhvilluan katër fokus grupe në periudhën kohore mars-qershor 2025, të ndara sipas kategorive profesionale: një me gjyqtarë (gjyqtarët e procedurës paraprake dhe gjyqtarët e trupit gjykues), një me prokurorë publikë (nga prokuroritë themelore dhe të larta publike), një me nëpunës policie (të cilët punojnë në hetime kriminale dhe propozojnë zbatimin e MPH, si dhe nëpunës policie që punojnë në zbatimin e MPH, bashkë me nëpunës policie - hetues nga qendrat hetimore të prokurorive themelore publike) dhe një me avokatë. Pjesëmarrësit u seleksionuan në bazë të fushës së tyre të punës, përvojës dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë në proceset lidhur me kërkesën, propozimin, miratimin dhe zbatimin e MPH. Diskutimet në fokus grupet ishin të strukturuar, por fleksibile, përkatësisht u zhvilluan në bazë të pyetjeve dhe temave të parapërgatitura të përcaktuara në Aneksin I. Secili fokus grup zgjati rreth 1.5 deri në 2 orë. Fokus grupet ishin homogjene, përkatësisht të ndara sipas profesionit dhe rolit që e kanë në procesin e miratimit dhe zbatimit të MPH, në mënyrë që pjesëmarrësit të ndihen të lirë dhe të jenë të sigurtë dhe të hapur gjatë artikulimit të pikëpamjeve të tyre.

Para fillimit të diskutimeve, nga moderatorët, u theksua se biseda duhet të jetë e sigurtë, konstruktive dhe se të gjitha mendimet janë të mirëseardhura. Diskutimet u zhvilluan duke e aplikuar rregullin e diskutimit Chatam House¹³, kështu që përgjigjet e pjesëmarrësve janë anonime dhe nuk shoqërohen me emra, përveç nëse ndonjë pjesëmarrës kërkon shprehimisht që të citohet qëndrimi i tij. Gjatë diskutimit, mbahej llogari që të gjithë pjesëmarrësit të kenë mundësi të përfshihen dhe gjithë secili të ketë mundësi ta artikulojë lirisht mendimin e tij pa ndërprerje. Biseda nuk u regjistrua, por u morën shënime për përpilimin e një raporti përmbledhës me gjetjet kryesore. Në fund të diskutimit, pjesëmarrësit patën mundësinë t'i përmbledhin pikëpamjet e tyre dhe të shtojnë çdo gjë që ata mendojnë se është e rëndësishme dhe që nuk ishte përmendur më parë.

Kjo metodë mundësoi shkëmbimin e mendimeve midis pjesëmarrësve dhe nxiti debat të thellë rreth çështjeve që u diskutuan. Duke vepruar kështu, u mundësua të perceptohen sfidat praktike nga kënde të ndryshme dhe perspektivat profesionale, ndërkaq njohuritë e fituara shërbyen si një vlerë shtesë për verifikimin dhe pasurimin e të dhënave të siguruara përmes metodave të tjera.

¹³ <https://www.chathamhouse.org/about-us/chatham-house-rule>

1.5. Rezultatet dhe implikimet e pritshme

Hulumtimi ofron një analizë gjithëpërfshirëse dhe një vështrim kritik të rolit të subjekteve kryesore në procesin e propozimit, kërkesës, miratimit, zbatimit dhe kontrollit të MPH. Hulumtimi ofron njohuri të argumentuara në lidhje me mënyrën, vëllimin dhe konsistencën e zbatimit të masave në praktikën gjyqësore. Së këtejmi, ofron konkluzione për të gjithë procesin e zbatimit të MPH-ve, duke identifikuar lëshime konkrete, dobësi, mospërputhje dhe sfida praktike me të cilat ballafaqohen subjektet e drejtësisë. Në mënyrë plotësuese, u formuluan rekomandime konkrete për avancimin e zbatimit të MPH dhe për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut .

Implikimet e hulumtimit kanë të bëjnë si me avancimin e praktikës gjyqësore, ashtu edhe me formulimin e politikave dhe reformave institucionale. Në nivel shkencor, hulumtimi pritet të kontribuojë në të kuptuarit më të mirë të funksionimit dhe efekteve nga zbatimi i MPH në kontekstin e sundimit të ligjit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe llogaridhënies. Në nivel praktik, gjetjet e arritura duhet të shërbejnë si bazë për:

- përmirësimin e koordinimit institucional ndërmjet autoriteteve të sistemit të drejtësisë,
- zhvillimin e udhëzimeve dhe trajnimeve për një zbatim më të mirë dhe të harmonizuar të MPH,
- inicimin e ndryshimeve ose plotësimeve ligjore për boshllëqet apo paqartësitë e identifikuar në kuadrin ligjor,
- promovimin e besimit të publikut përmes transparencës më të madhe dhe llogaridhënies
- në zbatimin e masave që ndikojnë drejtpërdrejt mbi të drejtat themelore të qytetarëve.

Njëherësh, rezultatet mund të jenë të dobishme edhe për vendet e tjera të rajonit të cilat përballen me sfida të ngjashme, duke mundësuar analiza komparative dhe shkëmbim të praktikave të mira.

1.6. Arsyeshmëria e hulumtimit

Arsyeshmëria e zbatimit të këtij hulumtimi rezulton nga nevoja që në mënyrë sistematike të shqyrtohen dhe kuptohen efektiviteti, implikimet juridike dhe aspektet etike të përdorimit të MPH gjatë mbledhjes së të dhënave dhe njohurive në hetimin e formave të rënda të krimit. Duke qenë se asnjë hulumtim i ngjashëm nuk është bërë deri më tani, qëllimi është të ofrohet një pasqyrë e thelluar në zbatimin praktik të MPH, duke i identifikuar sfidat kryesore, boshllëqet dhe dobësitë me të cilat ballafaqohen praktikuesit e drejtësisë. Këto gjetje do të kontribuojnë që ligjvënësi më lehtë ta kuptojë ndikimin real të masave, nevojën e harmonizimit me standardet evropiane dhe nevojat eventuale për ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues.

Nga pikëpamja sociale, justifikimi bazohet në rëndësinë e sigurimit të zbatimit të përgjegjshëm, etik dhe ligjor të këtyre masave. Hulumtimi synon t'i informojë politikëbërësit, institucionet e drejtësisë dhe publikun e gjerë për mënyrat, implikimet dhe mekanizmat e kontrollit gjatë zbatimit të MPH. Kjo do të inkurajojë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave individuale, ndërkaq do të kontribuojë edhe në krijimin e mbikëqyrjes adekuate civile dhe institucionale mbi zbatimin e këtyre instrumenteve të fuqishme hetimore.

2. Kuadri ligjor për masat e posaçme hetimore

Në legjisllacionin maqedonas të procedurës penale, MPH për herë të parë u inkorporuan në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën Penale të miratuar në vitin 2004¹⁴. Me këto amendime të LPP, ligjvënësi përcaktoi tetë MPH:

¹⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 74/2004

1. ndjekja e komunikimeve dhe hyrja në shtëpi dhe ambiente të tjera ose në mjete transporti me qëllim krijimin e kushteve për ndjekjen e komunikimeve, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me ligj,
2. këqyrja dhe kërkimi në sistemin kompjuterik, sekuestrimin e sistemit kompjuterik ose një pjese të tij apo bazën e të dhënave për ruajtjen e të dhënave kompjuterike,
3. mbikëqyrja e fshehtë, ndjekja dhe regjistrimi audio-vizual i personave dhe sendeve me mjete teknike,
4. blerja e dukshme (e simuluar) e sendeve, si dhe mitë dhënia e dukshme (e simuluar) dhe mitë marrja e dukshme (e simuluar),
5. livrimi i kontrolluar dhe transporti i personave dhe sendeve,
6. përdorimi i personave me identitet të fshehur për ndjekjen dhe mbledhjen e informacioneve ose të dhënave,
7. hapja e llogarisë bankare e dukshme (e simuluar) në të cilën mund të depozitohen mjete që burojnë nga vepra e kryer penale, dhe
8. regjistrimi i personave juridikë i dukshëm (i simuluar) ose përdorimi i personave juridikë ekzistues për mbledhjen e të dhënave.

Sipas LPP-së të atëhershëm, në procedurën para hetimore, MPH-të përcaktoheshin me urdhër të prokurorit publik ose gjyqtarit hetues, ndërkaq në procedurën hetimore, vetëm me urdhër të gjyqtarit hetues. Baza ligjore dhe kushtet specifike për zbatimin e masës së posaçme hetimore “Ndjekja e komunikimeve dhe hyrja në shtëpi dhe ambiente të tjera ose në mjete transporti me qëllim krijimin e kushteve për ndjekjen e komunikimeve, në kushte dhe procedurë të përcaktuar me ligj” ishin rregulluar me Ligjin për Ndjekjen e Komunikimeve (LNK) të miratuar në vitin 2006¹⁵. Miratimit të tij i parapriu një ndërhyrje me amendament në nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Për më tepër, në tekstin fillestar të nenit 17 (objekt i amendimit), paragrafi 2 parashikonte se vetëm në bazë të vendimit gjyqësor “mund të devijohet nga parimi i paprekshmërisë së fshehtësisë së letrave”, nëse kjo është e nevojshme për zhvillimin e procedurës penale ose nëse këtë e kërkojnë interesat e mbrojtjes. Kështu e formuluar, përmbajtja e paragrafit 2 të nenit 17 të Kushtetutës siguronte bazë legale për shmangie vetëm sa i përket paprekshmërisë së fshehtësisë së letrave, dhe jo edhe mënyrave të tjera bashkëkohore të komunikimit që janë dominante në jetën e përditshme. Ekspertët ligjorë në vend ishin pothuajse unanimitë në qëndrimin e tyre se ky formulim kushtetues i anashkaloi format e reja të krimit, dhe se me këtë dispozitë kushtetutë bërësi praktikisht i çarmatosi institucionet në luftën kundër krimit të organizuar dhe llojeve të tjera të krimit¹⁷. Së këtëjmi, padyshim që kishte një marrëveshje që ishte më mirë të rregullohej përgjimi në mënyrë të ligjshme sesa të kryhej jashtë sferës juridike, praktikisht pa asnjë kontroll¹⁸.

Për këto arsye, në vitin 2003, u miratua Amendamenti XIX me të cilin u zëvendësua neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë¹⁹. Në përputhje me ndryshimet, vetëm në bazë të vendimit gjyqësor, në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj, mund të devijohet nga drejta e paprekshmërisë së letrave dhe formave të tjera të komunikimit

¹⁵ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 121/2006

¹⁶ Jankulovski, Z. (2000). Mbrojtja e privatësisë në Republikën e Maqedonisë (duhet të ndryshohet neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë) në Polici, Prokurorinë Publike, Gjykatë dhe Avokaturë në Procedurën Parapenale, Shoqata për Drejtësinë Penale dhe Kriminologji e Maqedonisë, Shkup, f. 372

¹⁷ Marjanoviq, G.J. (2002). Për përgjimin dhe për (jo) përgjegjësinë, Përmbledhja e Punimeve Eurointegrimi - I detë, Situatat, Realizimi, Fakulteti Juridik Justinianus Primus, Shkup, f. 95

¹⁸ Kallajxhiev, G. (2004). Kuadri kushtetues i privatësisë dhe masat e reja hetimore, Përmbledhje e Fakultetit Juridik “Justinianus Primus”, Shkup, f. 439

¹⁹ Amendamenti XIX i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë u botua në Gazetën Zyrtare Nr. 84/2003

nëse kjo është e nevojshme për parandalimin ose zbulimin e veprave penale, për shkak të zhvillimit të procedurës penale ose kur këtë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjatë periudhës njëzet vjeçare, zgjidhjet ligjore të MPH iu nënshtruan ndryshimeve dhe plotësimeve të rëndësishme me qëllim të zbatimit të tyre efektiv në praktikë. Ndër të tjera, Ligji aktual për Procedurën Penale²⁰ e zgjeroi listën e MPH-ve dhe përcaktoi dymbëdhjetë masa sipas renditjes së më poshtme:

1. ndjekja dhe regjistrimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike në procedurë të përcaktuar me ligj të posaçëm,
2. ndjekja dhe regjistrimi në shtëpi, hapësirë të mbyllur ose me gardh që i përket asaj shtëpie ose hapësirë afariste të specifikuar si private ose në automjet dhe hyrjen në ato hapësira me qëllim krijimin e kushteve për ndjekjen e komunikimeve,
3. ndjekja dhe regjistrimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose hapësirës afariste të specifikuar si private,
4. këqyrja e fshehtë dhe kërkimi në sistemin kompjuterik,
5. kërkimi automatik, ose kërkimi në mënyrë tjetër, dhe krahasimi i të dhënave personale,
6. këqyrje në komunikimet e realizuara telefonike dhe në komunikimet e tjera elektronike,
7. blerja e simuluar e sendeve,
8. mitë dhënia dhe mitë marrja e simuluar,
9. livrimi i kontrolluar dhe transporti i personave dhe sendeve dhe shtyrja e arrestimit ose sekuestrimit të sendeve,
10. përdorimi i personave me identitet të fshehur për regjistrimin, ndjekjen dhe mbledhjen e informacioneve ose të dhënave dhe infiltrimi në grupet e organizuara kriminale,
11. hapja e llogarisë bankare e simuluar dhe
12. regjistrimi i simuluar i personave juridikë ose përdorimin e personave juridikë ekzistues për mbledhjen e të dhënave dhe për krijimin e kushteve për infiltrim.

Duke e marrë parasysh intruzivitetin dhe shkallën e ndërhyrjes në privatësinë e secilës masë të posaçme hetimore, ligjvënësi bëri një distinkcion me ç'rast MPH-të nga pika 1 deri në pikën 5 zbatohen me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, ndërsa shtatë masat e tjera nga pika 6 deri në pikën 12, zbatohen me urdhër të prokurorit publik kompetent. Procedura për zbatimin e masës së posaçme hetimore Ndjekja dhe regjistrimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike në procedurë të përcaktuar me ligj të posaçëm është rregulluar me Ligjin aktual për Ndjekjen e Komunikimeve, i miratuar në vitin 2018 në kuadër të reformës gjithëpërfshirëse në sektorin e sigurisë dhe zbulimit. Një pjesë e zgjidhjeve normative të përfshira në këtë ligj, por edhe në ligjet e tjera të paketës së reformës, rezultuan nga rekomandimet e përfshira në dokumentin me titull Prioritetet Emergjente të Reformës²¹, të përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Lartë për Çështje Sistemike për Sundimin e Ligjit, i themeluar nga Komisioni Evropian dhe i kryesuar nga Reinhard Priebe.

Disa çështje të caktuara në lidhje me zbatimin e MPH janë rregulluar edhe me ligje të tjera, si Ligji për Komunikimet Elektronike, Ligji për Agjencinë Operative - Teknike, Ligji për Informacionet e Klasifikuara dhe Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare. Kuadri normativ u rrumbullakua me Ligjin për Punët e Brendshme, Ligjin për Policinë, Ligjin për Mbrojtje, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për Policinë Financiare dhe Ligjin për Drejtorinë e Doganave. Përveç kësaj, zbatimi operativ i këtyre masave trajtohet dhe rregullohet në mënyrë më të detajuar edhe me akte nënligjore – udhëzime, procedura të detyrueshme, etj. në institucionet përkatëse përgjegjëse për zbatimin e tyre, të cilat janë klasifikuar në një shkallë të caktuar dhe për këtë arsye nuk janë në dispozicion të publikut për t' u analizuar.

²⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, " nr. 15/2010

²¹ The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, Brussels, 8 June 2015. https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2016-12/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

3. Dinamika dhe tendencat në zbatimin e masave të posaçme hetimore

Në këtë pikë do të prezantohen të dhënat statistikore, për zbatimin e MPH-ve, që janë përfshirë në raportet vjetore të cilat Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut kadetyrim ligjor t' i paraqesë në Kuvend, në përputhje me nenin 271 të LPP-së. Këto raporte duhet t'i përmbajnë të dhënat si vijon:

1. numrin e procedurave në të cilat janë urdhëruar MPH në përputhje me nenin 252 të LPP-së,
2. veprat penale që shërbyen si shkas në përputhje me ndarjen në nenin 253 të LPP-së,
3. a është e ndërlidhur procedura me ndjekjen e krimit të organizuar,
4. numrin e objekteve të mbikëqyrura dhe numrin e personave të mbikëqyrur për secilën procedurë sipas personave të pandehur dhe që nuk janë të pandehur,
5. kohëzgjatjen e masës së posaçme hetimore,
6. nga ndjekja a kanë dalë rezultate relevante për procedurën ose ka të ngjarë të jenë relevante për procedurën,
7. nëse nga ndjekja nuk kanë dalë rezultate relevante , cilat janë arsyet për këtë, në mënyrë të diferencuara, sipas arsyeve teknike dhe arsyeve të tjera dhe
8. shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i masës së posaçme hetimore.

Tabela 1 e pasqyron në mënyrë komparative cilat nga të dhënat e listuara i përmbajnë raportet. Nga këqyrja dhe analiza e raporteve, rezultojnë gjetjet e mëposhtme:

1. Në raportet specifikohet numri i rasteve në të cilat është urdhëruar MPH, bashkë me numrin e MPH-ve të urdhëruara ndaj personave me identitet të përcaktuar, personave me identitet të panjohur dhe sendeve.
2. Raportet i përmbajnë veprat penale që kanë shërbyer si shkas për çdo masë të posaçme hetimore, por pa specifikuar një numër konkret për sa vepra penale është urdhëruar çdo masë.
3. Raportet nuk përmbajnë të dhëna nëse procedura ka lidhje me ndjekjen e krimit të organizuar.
4. Raportet e përmbajnë numrin e objekteve të mbikëqyrura dhe numrin e personave të mbikëqyrur me identitet të përcaktuar dhe të panjohur për secilën procedurë, pa bërë ndarje sipas personave të pandehur dhe që nuk janë të pandehur.
5. Raportet përmbajnë të dhëna për kohëzgjatjen e çdo mase të posaçme hetimore.
6. Raportet përmbajnë të dhëna për numrin e rasteve të cilat (i) kanë vazhduar me urdhrat e miratuar për zbatimin e procedurës hetimore, (ii) veprimet janë realizuar dhe vazhdojnë në procedurën para hetimore, (iii) masa është në rrjedhë e sipër dhe (iv) masa është ndërprerë pa siguruar prova të mjaftueshme. Këto të dhëna vënë në dukje atë se nga ndjekja a kanë dalë rezultate relevante për procedurën ose ka të ngjarë të jenë relevante për procedurën.
7. Raportet nuk përmbajnë të dhëna për arsyet nëse nuk kanë dalë rezultate përkatëse nga ndjekja, të diferencuara sipas arsyeve teknike dhe arsyeve të tjera.
8. Nga raportet rezulton se prokuroria nuk ka njohuri për implikimet financiare të shkaktuara nga zbatimi i MPH, duke e marrë parasysh se masat zbatohen nga Ministria e Punëve të Brendshme e cila nuk paraqet raport në prokurori për shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i këtyre masave. Për më tepër, raportet tregojnë se nuk ka implikime financiare për Prokurorinë Publike nga zbatimi i MPH.

Brendshme e cila nuk paraqet raport në prokurori për shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i këtyre masave. Për më tepër, raportet tregojnë se nuk ka implikime financiare për Prokurorinë Publike nga zbatimi i MPH. Në kuadër të fokus grupit me prokurorët publikë, u theksua se të dhënat për elemente të caktuara që duhet të përfshihen në raportin vjetor të Prokurorisë Publike janë të vështira për t'u mbledhur në praktikë. Për shembull, nëse zbatimi i MPH fillon nga fundi i vitit dhe vazhdon në vitin e ardhshëm, në kohën e hartimit të raportit nuk mund të përcaktohet me siguri nëse masa ka dhënë rezultate relevante.

Veç tjerash, u theksua se nuk ekziston një metodologji e standardizuar për përcaktimin e shpenzimeve nga zbatimi i MPH, gjë që e bën edhe më të vështirë pasqyrimin e implikimeve financiare, veçanërisht duke e pasur parasysh natyrën dhe kompleksitetin e ndryshëm të secilit rast individual.

Tabela 1. Pasqyrë komparative e të dhënave që duhet t'i përmbajnë raportet vjetore për MPH nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Të dhënat që duhet t'i përmbajnë në përputhje me nenin 271 të LPP-së		Të dhënat që i përmbajnë raportet vjetore për zbatimin e MPH për periudhën 2014-2024
1	numri i procedurave në të cilat janë urdhëruar MPH në përputhje me nenin 252 të LPP,	numri i rasteve në të cilat është urdhëruar MPH, bashkë me numrin e MPH-ve të urdhëruara ndaj personave me identitet të përcaktuar, personave me identitet të panjohur dhe sendeve.
2	veprat penale që shërbyen si shkas në përputhje me ndarjen në nenin 253 të LPP-së,	janë specifikuar veprat penale që kanë shërbyer si shkas për çdo MPH, por pa specifikuar një numër konkret për sa vepra penale është urdhëruar çdo masë
3	a ndërlihet procedura me ndjekjen e krimit të organizuar	nuk specifikohen të dhëna të tilla
4	numri i objekteve të mbikëqyrur dhe numri i personave të mbikëqyrur për secilën procedurë sipas personave të pandehur dhe të atyre që nuk janë të pandehur	specifikohen të dhëna për numrin e lëndëve dhe numrin e personave, pa u bërë ndarja midis të pandehurve dhe të atyre që nuk janë të pandehur
5	kohëzgjatja e masës së posaçme hetimore	përcaktohet kohëzgjatja e secilës masë veçmas
6	nga ndjekja a kanë dalë rezultate relevante për procedurën ose ka të ngjarë të jenë relevante për procedurën	po, përmes prezantimit të të dhënave për numrin e rasteve të cilat (i) kanë vazhduar me urdhrat e miratuar për zbatimin e procedurës hetimore, (ii) janë realizuar dhe vazhdojnë veprimet në procedurën para hetimore, (iii) masa është në rrjedhë e sipër dhe (iv) masa është ndërprerë pa siguruar prova të mjaftueshme.
7	nëse nga ndjekja nuk kanë dalë rezultate relevante, cilat janë arsyet për këtë, në mënyrë të diferencuar, sipas arsyeve teknike dhe arsyeve të tjera	nuk specifikohen të dhëna të tilla
8	shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i masës së posaçme hetimore	nuk specifikohen të dhëna të tilla

Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2014-2024 <https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Për tu kuptuar më qartë të dhënat, në raportet theksohet se pasqyra e përgjithshme statistikore e numrit të rasteve dhe numrit të personave me identitet të përcaktuar dhe të papërcaktuar ndaj të cilëve janë zbatuar MPH-të nuk është një shumë e thjeshtë e numrave individual për MPH sipas llojit dhe veprës penale. Kjo gjendje është rezultat i faktit që në praktikë më së shpeshti në një rast nuk zbatohet vetëm një masë e vetme e posaçme hetimore, por përdoret një kombinim i disa llojeve të MPH-ve, dhe kjo ndodh shumë shpesh në nurin më të madh të rasteve, ndërkaq bëhet me qëllim të zbulimit më efikas të veprave penale dhe kryerësve. Gjithashtu, në kuadër të një lënde, është e mundur me MPH të përfshihen më shumë persona dhe/ose sende.

Tabela 2 jep një pasqyrë të numrit të rasteve në të cilat janë zbatuar MPH në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2024, të klasifikuara sipas asaj nëse ato kanë të bëjnë me persona me identitet të përcaktuar ose të papërcaktuar, si dhe me sende. Të dhënat janë nxjerrë nga raportet vjetore të Prokurorisë Publike të përmbledhura në një tabelë dhe i pasqyrojnë tendencat dhe oscilimet e MPH të miratuara.

Është edukshme se nga viti 2014, kur prezantohen të dhënat në raportet, përdoret një metodologji e re e zgjeruar për evidencën në përputhje me nenin 271 të LPP-së, kështu që raportet përmbajnë të dhëna statistikore më të detajuara, me ç'rast mundësohet një ndarje e të dhënave sipas kategorive, analizës më të saktë dhe transparencës më të madhe. Deri në vitin 2013, të dhënat për personat me identitet të përcaktuar dhe të panjohur, si dhe për sendet, nuk janë të përfshira në raporte.

Numri më i lartë i rasteve në të cilat janë aplikuar MPH është regjistruar në vitin 2019 (103 raste). Numri më i madh i MPH-ve të aplikuara ndaj personave me identitet të përcaktuar ishte në vitin 2023 (416 masa), ndaj personave me identitet të panjohur në vitin 2015 (107 masa) dhe ndaj sendeve në vitin 2018 (551 masa).

Të dhënat konfirmojnë se numri i rasteve në të cilat janë aplikuar MPH është rritur në mënyrë të vazhdueshme që nga viti fillestar i analizuar (viti 2010), duke arritur kulmin në vitin 2019, dhe më pas duke shënuar rënie, me përjashtim të vitit 2023.


Tabela 2. Pasqyrë e rasteve me MPH të aplikuara për periudhën 2010-2024

	Raste	Ndaj personave me identitet të përcaktuar	Ndaj personave me identitet të panjohur	Ndaj sendeve
2010	23	-	-	-
2011	39	-	-	-
2012	41	-	-	-
2013	36	-	-	-
2014	88	183	36	0
2015	57	328	107	15
2016	61	182	0	382
2017	71	289	0	262
2018	95	317	0	551
2019	103	338	17	313
2020	67	404	22	124
2021	59	204	11	126
2022	53	413	2	136
2023	87	416	0	93
2024	35	363	8	163

Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2010-2024
<https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Grafiku 1 e pasqyron lëvizjen e numrit të rasteve në të cilat janë aplikuar MPH në periudhën 2010–2024, me ç'rast vija e drejtë blu e përfaqëson vijën e tendencës, e cila e tregon drejtimin e përgjithshëm dhe dinamikën e ndryshimeve ndër vite.

Grafiku 1. Pasqyrë e rasteve me MPH të aplikuara për periudhën 2010-2024



Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2010-2024
<https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Tabela 3 jep një pasqyrë të MPH-ve të aplikuara sipas llojit të masës për periudhën 2015-2024. Duke i analizuar masat individuale, mund të konstatohet se:

- masa nga neni 252, paragrafi 1, pika 1 është më shpesh e aplikuar gjatë gjithë periudhës. Kulmi u arrit në vitin 2018 (194), që është mbi gjysmën e të gjitha MPH-ve të aplikuara për atë vit,
- masa nga neni 252, paragrafi 1, pika 3 është gjithashtu e shpeshtë, me një numër të lartë në vitin 2018 (97), por në vitet e tjera është shumë më i ulët,
- masat nga neni 252 paragrafi 1, pikat 2, 4 dhe 9 janë aplikuar jashtëzakonisht rrallë, me një maksimum prej 6 herë brenda një vit,
- masa nga neni 252, paragrafi 1, pika 5 nuk u aplikua fare gjatë gjithë periudhës,
- masa nga neni 252, paragrafi 1, pika 6 ka fluktuacion të konsiderueshëm – numra të lartë në vitin 2016 (37) dhe në vitin 2019 (38), por pas vitit 2020 aplikohet shumë pak,
- masat nga neni 252, paragrafi 1, pikat 11 dhe 12 janë aplikuar vetëm në vitin 2018 (nga 11 herë).

Disa nga MPH-të e parashikuara ligjërisht nuk përdoren kurrë ose përdoren jashtëzakonisht rrallë, gjë që vë në dukje se sistemi fokusin e ka mbi masa të caktuara, ndërsa të tjerat ekzistojnë vetëm formalisht në ligj. Varësia dominante nga disa masa (1, 3 dhe 6) është e dukshme, gjë që çon në përfundimin se organet hetimore gjatë mbledhjes së të dhënave dhe provave mbështeten kryesisht në metoda klasike siç janë ndjekja e komunikimeve, këqyrja e komunikimeve dhe ndjekja teknike në vende publike.

Tabela 3. Pasqyrë e MPH-ve të aplikuara sipas llojit të masës për periudhën 2015-2024


MPH	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
1	30	29	32	194	39	54	44	37	31	25
2	6	4	1	1	5	2	0	2	2	3
3	28	23	14	97	39	55	40	42	34	26
4	1	0	1	4	1	0	0	0	0	0
5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	19	37	30	0	38	16	4	2	0	1
7	2	1	1	1	10	1	5	5	8	3
8	3	3	3	13	5	1	2	4	2	2
9	1	1	0	0	3	1	0	1	0	2
10	4	2	2	27	11	3	6	7	10	5
11	0	0	0	11	0	0	0	0	0	0
12	0	0	0	11	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	94	100	84	359	151	133	101	100	87	67

Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2015-2024 <https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Grafiku 2 e pasqyron lëvizjen e numrit të MPH-ve të aplikuara në periudhën 2015-2024 sipas të dhënave të përgjithshme për MPH-të e aplikuara nga Tabela 3. Vija blu e përfaqëson vijën e tendencës, e cila e tregon drejtimin e përgjithshëm dhe dinamikën e ndryshimeve ndër vite. Tendanca e të dhënave tregon sa vijon:

- numri më i madh i MPH-ve të lëshuara është regjistruar në vitin 2018 (359) - shumë më tepër se vitet e tjera,
- pas vitit 2018, vërehet një rënie e vazhdueshme e numrit të MPH-ve të aplikuara menjë rënie graduale të numrave, që korrespondon me reformën e komunitetit të sigurisë-zbulimit në vend,
- numri më i ulët i MPH-ve të lëshuara ishte në vitin 2024 (67), që është një rënie e konsiderueshme në krahasim me vitin 2018 madje edhe me vitet fillestare.

Grafiku 2. Pasqyrë e numrit të përgjithshëm të MPH-ve të aplikuara për periudhën 2015-2024



Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2015-2024 <https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Grafiku 3 ofron një pasqyrë vizuale të dinamikës së aplikimit të MPH-ve nga neni 252, paragrafi 1, pikat 1, 3 dhe 6 për periudhën 2015-2024, të cilat sipas të dhënave nga Tabela 3 janë më shpesh të aplikuara.

Grafiku 3. Pasqyrë e MPH-ve të aplikuar nga neni 252, paragrafi 1, pikat 1, 3 dhe 6 për periudhën 2015-2024



Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2015-2024
<https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Nga këqyrja në të gjitha raportet në dispozicion, mund të konkludohet se MPH-ët janë aplikuar më shpesh për zbulimin e veprave penale: prodhimi dhe shpërndarja e paautorizuar e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve; pastrimi i parave dhe produkte të tjera nga veprat penale; shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit; mitë dhënia dhe mitë marrja; kontrabanda e migrantëve; terrorizmi; organizata terroriste; dhe bashkimi kriminal. Kjo tregon se masat janë përdorur kryesisht për zbulimin e formave të rënda dhe serioze të krimit, përfshirë edhe veprat penale korruptive, si dhe në rastet kur provat vështirëse mund të siguroheshin ndryshe.

Saupërket organeve që e kanë iniciuar aplikimin e MPH, raportet nuk japin informacione të detajuara, por përmbajnë vetëm konstatime të përgjithshme në konkluzionin e tyre se në shumicën e rasteve iniciativa buron nga MPB. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se në një numër të caktuar rastesh Prokuroria Publike, veçanërisht PTHP NKOK, ka aplikuar MPH me iniciativën e vet, ndërkaq në një raport përmendet Drejtoria e Policisë Financiare si propozuese e MPH.

Neni 260 i LPP-së parashikon që MPH mund të zgjasin deri në 4 muaj, me mundësinë e vazhdimin deri në 4 muaj dhe në mënyrë plotësuese edhe 6 muaj për rastet e veprave të rënda penale të kryera nga grupe të organizuara, banda ose bashkime kriminale. Kjo do të thotë se në praktikë masat mund të zgjasin maksimum deri në 14 muaj. Së këtejmi, në përputhje me nenin 261 të LPP-së, kur do të arrihen qëllimet për të cilat janë përcaktuar ose do të pushojnë së ekzistuari bazat për të cilat u miratuan, prokurori publik është i detyruar të urdhërojë menjëherë ndërprerjen e masave të përcaktuara nga ai, përkatësisht për një gjë të tillë do ta njoftojë gjyqtarin dhe do të kërkojë ndërprerjen e tyre. Në tabelën 4 janë pasqyruar rastet e kohëzgjatjes së aplikimit të MPH nga neni 252, paragrafi 1, pika 1 për periudhën 2019-2024 të shprehura në muaj. Tendencat e përgjithshme që mund të nxirren nga të dhënat janë si më poshtë:

- Numri më i madh i rasteve të aplikimit të kësaj mase është brenda afatit bazë të lejuar (deri në 4 muaj). Nga ana tjetër, ka edhe raste me kohëzgjatje më të gjatë (mbi 6 dhe deri në 12 muaj), që lejohet vetëm në kushte të rrepta të nenit 260 paragrafi 3.

- Kjo masë është aplikuar në një numër të madh me kohëzgjatje deri në 1, 2 ose 3 muaj, duke e vënë në dukje përdorimin e saj si një instrument i shpejtë për mbledhjen e provave. Kjo gjithashtu tregon se masa u ndërpre në përputhje me nenin 261 të LPP-së para përfundimit të periudhës bazë prej 4 muajsh për zbatimin e saj.

- Në një numër të madh rastesh, masa ka vijuar të aplikohet deri në skadimin e afatit bazë ligjor të përcaktuar prej 4 muajsh.

- Vazhdimi mbi 4 muaj është bërë në 47 raste (22%). Në 37 raste (17%) masa është vazhduar edhe për 4 muaj të tjerë, kurse në 10 raste (4.6%) masa është vazhduar përsëri, për 1 ose 4 muaj të tjerë, megjithëse mundësia e dhënë ligjore është 6 muaj. Kjo vë në dukje se vazhdimi i masave përdoret me kujdes. Megjithatë, nga të dhënat e prezantuara nuk mund të shihet se a janë zbatuar masat deri në fund të periudhës së caktuar të vazhdimit, ose eventualisht janë ndërpre në përputhje me nenin 261 të LPP-së.

Në përgjithësi, praktika gjyqësore zakonisht lëviz brenda afatit bazë deri në 4 muaj, në përputhje me nenin 260 të LPP-së. Vazhdimet mbi 4 muaj nuk janë të shpeshta dhe tregojnë një aplikim selektiv në hetimet komplekse të rasteve të krimit të organizuar.

Tabela 4. Pasqyrë e rasteve të kohëzgjatjes së aplikimit të MPH nga neni 252, paragrafi 1, pika 1 për periudhën 2019-2024 të shprehura në muaj

MPH	< 1 muaj	< 2 muaj	< 3 muaj	< 4 muaj	< 5 muaj	< 6 muaj	< 7 muaj	< 8 muaj	< 9 muaj	< 10 muaj	< 11 muaj	< 12 muaj
2019	18	2	7	3	0	7	0	0	2	0	0	0
2020	4	1	19	4	1	2	0	5	0	0	0	0
2021	8	6	2	11	0	7	2	0	0	0	0	1
2022	7	18	2	7	0	3	0	0	0	0	0	1
2023	13	4	0	17	5	0	0	0	0	0	0	3
2024	0	1	0	16	1	0	0	4	0	0	0	3
CË	50	32	30	58	7	19	2	9	2	0	0	8

Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2019-2024 <https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>

Ndërmjetësimi teknik në aktivizimin e ndjekjes së komunikimeve për nevojat e autoriteteve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet nga Agjencia Operative-Teknike (AOT). Në përputhje me nenin 7 të Ligjit për Agjencinë Operative-Teknike²², në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqitet për shqyrtim Raporti Vjetor për Punën e AOP, i cili, ndër të tjera, përmban të dhëna për:

- numrin e komunikimeve të aktivizuara për nevojat e autoriteteve të autorizuara - i shprehur si numër i të gjitha komunikimeve të aktivizuara në bazë të urdhrave të marra nga gjykata në AOT për zbatimin e masave në lidhje me ndjekjen dhe regjistrimin e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike, dhe
- numrin e komunikimeve të aktivizuara për çdo autoritet të autorizuar veçmas, por në këtë numër nuk theksohet numri i komunikimeve të aktivizuara për qëllimet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Së këtëjmi, me masat për ndjekjen dhe regjistrimin e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike, në përputhje me raportet e AOT,

²² Ligjin për Agjencinë Operative - Teknike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/2019)

nënkuptohen MPH dhe masat për ndjekjen e komunikimeve me qëllim mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit. Me komunikim të aktivizuar nënkuptohet çdo komunikim i ri i aktivizuar me një parametër të caktuar unik të papërsëritshëm – numri i identifikimit i përfshirë në urdhrin e gjykatës. Nga shqyrtimi i raporteve, vërehet se AOT deri në vitin 2022, përveç të dhënave për numrin e aktivizimeve të reja, e prezanton edhe numrin e masave të vazhduara.

Tabela 5 ofron një pasqyrë të numrit të komunikimeve të aktivizuara nga AOT sipas autoriteteve të autorizuara për periudhën 2018-2024 konform raporteve vjetore të aksesshme në faqen zyrtare të saj. Për më tepër, nga të dhënat e tabelës vërehet si vijon:

- MPB deri më tani është përdoruesi më i madh i masave për ndjekjen e komunikimeve përmes AOT-së gjatë gjithë periudhës (2018-2024). Numri i komunikimeve të aktivizuara është më i larti në vitin 2020 (321), pasuar me një rënie graduale, me numrin më të ulët në vitin 2023 (164).
- Drejtoria e Policisë Financiare (DPF) ka një përdorim minimal të masave – në vitin 2019 (8) dhe në vitin 2023 (2).
- Në raportet deri në vitin 2021, AOT e jep numrin e komunikimeve të aktivizuara për nevojat e Prokurorisë Publike (PP), pa specifikuar nëse bëhet fjalë për PTHP apo për PTHPNKOK. Tashmë në raportet për vitin 2023 dhe 2024, bëhet një distinkcion midis PTHPNKOK dhe PTHP Shkup. Nga ana tjetër, vërehet se prokuroria publike fillon të përdorë masat madje nga viti 2020 (68), dhe më pas në vitin 2021 kemi rënie të konsiderueshme (12). PTH PNKOK filloi të shfaqet si përdorues në vitin 2023 (1), ndërsa në vitin 2024 pati një rritje të konsiderueshme (9). PTHP Shkup u shfaq për herë të parë në vitin 2024 me përdorim minimal (1). Prokuroria Speciale Publike (PSP)²³ i përdori këto masa vetëm në vitin 2018 (8), gjë që është e pritshme për shkak të kompetencës të saj të atëhershëm; pastaj nuk shfaqet më për shkak të suprimimit të saj.

Tabela 5. Pasqyrë e numrit të komunikimeve të aktivizuara nga AOT sipas autoriteteve të autorizuara për periudhën 2018-2024

	MPB	DPF	PP	PSP	PTHPNKOK	PTHP Shkup
2018	5	0	0	8	0	0
2019	269	8	0	0	0	0
2020	321	0	68	0	0	0
2021	292	0	12	0	0	0
2022	278	0	0	0	0	0
2023	164	2	0	0	1	0
2024	195	0	0	0	9	1

Burimi: Raportet vjetore mbi punën e Agjencisë Operative - Teknike për periudhën 2018-2024
<https://ota.mk/odnosi-so-javnost/izvestai>

²³ Emërtimi zyrtar: Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të Lidhura dhe të Cilat Rezultojnë nga Përmbajtja e Ndjekjes së Paligjshme të Komunikimeve

4. Propozimi i masave të posaçme hetimore

Propozimi për zbatimin e masave të posaçme hetimore në një rast konkret paraqitet nga policia gjyqësore, e cila sipas nenit 21, pikës 9 të LPP-së është një emërtim i përbashkët për punonjësit e policisë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe pjesëtarët e Drejtorisë së Policisë Financiare dhe me ligj personat e autorizuar të Drejtorisë së Doganave që punojnë në zbulimin e veprave penale. Propozimin për zbatimin e një ose më shumë MPH-ve, policia gjyqësore ia dërgon prokurorit publik kompetent.

Në kuadër të fokus grupit me punonjësit policorë nga MPB që punojnë në çështjet që lidhen me MPH, u theksua se më së shpeshti policia gjyqësore i propozon Prokurorisë Themelore Publike zbatimin e këtyre masave në rastet kur për një ngjarje të caktuar të drejtësisë penale nuk janë mbledhur të dhëna të mjaftueshme relevante përmes zbatimit të masave dhe veprimeve të tjera. Sipas tyre, bëhet fjalë për raste kur hetimi nuk mund të përparojë pa informacione shtesë, të cilat mund të sigurohen vetëm përmes masave hetimore specifike dhe me dedikim. Punonjësit epolicisë nga MPB dhe prokurorët publikë janë unanimë në qëndrimin se po punojnë të koordinuar në një rast konkret përpara se të kërkojnë zbatimin e ndonjë mase të posaçme hetimore. Sidoqoftë, punonjësit e policisë theksuan se inicimi i masave varet shumë nga mënyra se si punon një prokuror publik, sepse ekzistojnë standarde të ndryshme të punës me karakter subjektiv në kuptimin që një iniciativë e caktuar me një argumentim të caktuar për një prokuror publik mund të jetë e mjaftueshme ndërsa për një tjetër të mos jetë. Në praktikë, përvoja e tyre tregon se është më e lehtë të propozohet dhe të merret miratimi për aplikimin e MPH-ve për të cilat prokurori publik lëshon urdhër. Megjithatë, procedura është më komplekse kur prokurori publik duhet t'i kërkojë gjyqtarit të procedurës paraprake të lëshojë urdhër për zbatimin e MPH. Kjo rezultoi nga fakti se masat e nenit 252, paragrafi 1, pika 1-5 kanë kontroll të dyfishtë, që e nënkupton nevojën për arsye të forta dhe të hollësishme për propozimin dhe kërkesën e tyre para gjyqtarit.

Në fokus grupin me prokurorët publikë, të gjithë bashkëbiseduesit ranë dakord se propozimet që ata i marrin nga inspektorët në pjesën më të madhe përmbajnë gjetje operative që konsiderohen të kënaqshme për miratimin e propozimit nga prokurori publik. Prokurorët konsiderojnë se koordinimi me policinë gjyqësore kontribuon që propozimet të jenë më të sakta, efektive dhe të bazuara në njohuri reale për veprën penale dhe personat e involvuar, ndërkaq prokurori publik të ketë një pasqyrë më të mirë për arsyet për të cilat propozohet zbatimi i masës së PH. Atëherë, policia gjyqësore bën identifikimin dhe analizën e detajuar të provave të mundshme që do të mblidheshin, si dhe seleksionimin dhe lidhjen e personave të përfshirë në grupet e organizuara kriminale. Qasja bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe invazivitetit minimal, duke i dhënë përparësi masave që ndërhyjnë më pak në privatësinë e personave. Sipas prokurorëve publikë, propozimet zakonisht argumentohen nga pamundësia për të mbledhur të dhënat dhe njohuritë e nevojshme përmes aplikimit të mjeteve dhe metodave të tjera. Njëherësh, në propozimet identifikohen dhe analizohen pritshmëritë e arsyeshme për rezultatet e zbatimit të masës.

Edhe pse propozimet e policisë gjyqësore zakonisht janë të arsyetuara dhe të argumentuara mirë, megjithatë, ato varen nga disa faktorë, siç janë lloji i ngjarjes së drejtësisë penale, kompleksiteti i çështjes, lloji i veprave penale që hetohen, numri i personave të involvuar, si dhe lloji dhe karakteri i provave tashmë në dispozicion dhe ato që duhet të sigurohen. Në këtë kontekst, për shkak të koordinimit sa i përket veprimit të prokurorëve publikë dhe inspektorëve nga MPB dhe harmonizimit thelbësor me kriteret e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të masave në një rast konkret, prokurori publik më së shpeshti i aprovon propozimet për zbatimin e MPH. Në rastet e rralla të refuzimit, arsyeja kryesore është mbështetja e pamjaftueshme e propozimit me njohuri specifike dhe të besueshme, veçanërisht nëse ato nuk janë siguruar përmes masave të tjera operative-taktike të zbatuara paraprakisht ose veprimeve hetimore. Ka raste në të cilat, edhe pse propozimet për aplikimin e MPH kanë qenë formalisht në rregull, ato nuk janë parashtruar në gjykatë në formën e kërkesës. Arsyeja kryesore për një qasje të tillë ishte vlerësimi se në rastin konkret nuk ka nevojë reale për zbatimin e masave, përkatësisht që synimet e hetimit mund të arrihen duke aplikuar metoda të tjera, më pak invazive.

Koordinimi i prokurorëve publikë me inspektorët e policisë gjyqësore kontribuon që propozimet të jenë më të sakta, efektive dhe të bazuara në njohuri reale për veprën penale dhe personat e involvuar, ndërkaq prokurori publik të ketë një pasqyrë më të mirë për arsyet për të cilat propozohet zbatimi i MPH.

5. Kërkesë për aplikimin e masave të posaçme hetimore

Prokurori publik vendos për propozimin e paraqitur për përcaktimin e masave të posaçme hetimore nga policia gjyqësore.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimit, veprimi i mëtejshëm i prokurorit publik varet nga ajo nëse në një rast konkret propozohet masë e posaçme hetimore sipas nenit 252, paragrafi 1, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të LPP-së apo masë e posaçme hetimore sipas nenit 252, paragrafi 1, pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të LPP-së.

Në fokus grupin me prokurorët për rolin e tyre në këtë pjesë të procedurës, ata theksuan se gjithmonë kujdesen që t'i aprovojnë MPH vetëm kur është e domosdoshme, përkatësisht si alternativë e fundit për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme. Ndër të tjera, ata janë të vetëdijshëm për burimet që shpenzohen duke i zbatuar këto masa dhe për këtë arsye kërkojnë të koordinohen në mënyrë të duhur teknike me gjyqtarin e procedurës paraprake. Gjatë vlerësimit të propozimeve nga policia gjyqësore, ata përballen me këto sfida:

- presion nga shpejtësia dhe urgjenca e veprimit me qëllim sigurimin e provave të nevojshme,
- pozicioni specifik i prokurorëve publikë të cilët janë midis policisë gjyqësore nga njëra anë, e cila propozon MPH bazuar në njohuritë e siguruara në periudha të caktuara kohore dhe pritshmëritë se ato do të aprovohen shpejt, dhe gjyqtarit të procedurës paraprake nga ana tjetër, i cili gjithashtu duhet të vendosë shpejt (për shembull, për masën e posaçme hetimore sipas nenit 252, paragrafi 1, pika 1, ka 72 orë në dispozicion për vlerësimin e kërkesës në përputhje me nenin 9 të LNK),
- propozim për zbatimin e MPH ndaj personit që është në paraburgim ose vuan dënimin me burgim, gjë që e vështirëson zbatimin e disa masave, situatat kur vendndodhja në të cilën do të zbatohen MPH nuk përcaktohet me saktësi dhe precizitet nga propozuesi, gjë që çon në probleme gjatë zbatimit të urdhrin,
- përcaktimi i pasaktë i identitetit të personave, veçanërisht kur identifikimi bazohet vetëm mbi numrin e telefonit, gjë që mund të çojë në zbatim të padrejtë ose të pajustificuar të masave.

Nevojitet një koordinim veçanërisht i mirë midis gjyqtarit të procedurës paraprake dhe prokurorëve publikë.

Përmes prizmit të përvojës së gjyqtarëve të procedurës paraprake që vendosin për miratimin e MPH nga neni 252, paragrafi 1, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të LPP-së, në fokus grupin mbizotëroi qëndrimi se kërkesat e prokurorëve publikë në përgjithësi janë të argumentuara mirë, por kishte edhe mendime të veçuara se kërkesat e prokurorëve publikë shpesh nuk janë të justifikuara sa duhet. Gjatë diskutimeve, gjyqtarët e procedurës paraprake si mungesë kryesore të propozimeve nga prokurorët publikë e theksuan faktin se ato kërkesa zakonisht janë të njëjta me propozimet e marra nga MPB, pa elemente shtesë të futura nga prokuroria publike. Perceptimi i gjyqtarëve të procedurës paraprake konsiston me atë se prokurorët themelorë publikë në disa raste i paraqesin nxitimthi kërkesat për zbatimin e MPH, në bazë të propozimeve të marra nga MPB të cilat nuk përmbajnë informacione të mjaftueshme. U theksua se megjithëse aplikimi i MPH duhet të kërkohet si mjet i fundit dhe pasi të jenë shteruar metodat e tjera të mbledhjes së provave, megjithatë, në praktikë zakonisht është e kundërta, përkatësisht aplikimi i MPH kërkohet në fazë të hershme. Vetë kërkesat më së shpeshti justifikohen me nevojën për të

vepruar shpejt. Perceptimi i gjyqtarëve se MPH kërkohen në një fazë shumë të hershme korrespondon edhe me mendimin e inspektorëve nga MPB, të cilët, sipas përvojës së tyre vërejnë se është më lehtë për prokurorët që së pari të aplikojnë ndonjë masë për të marrë informacione të caktuara mbi bazën e të cilave ata do ta drejtojnë hetimin dhe do të vazhdojnë të mbledhin prova të tjera. Duke pasur parasysh se këto masa zbatohen në hetimet për vepra penale ku shpejtësia është një faktor kryesor dhe shpesh një element vendimtar për suksesin e hetimit, gjyqtarët e procedurës paraprake theksuan se ata ndiejnë presion të konsiderueshëm gjatë vendimmarrjes, por në të njëjtën kohë janë të vetëdijshëm se faktori kohë nuk mund të jetë në kurriz të të drejtave të njeriut. Ata nënvizuan se janë plotësisht të fokusuar dhe të kujdesshëm gjatë vendimmarrjes ndaj kërkesave të marra dhe lëshimit të urdhrave për MPH.

Megjithatë, gjyqtarët janë unanimitë në qëndrimin se kohëve të fundit vërehet një përmirësim i caktuar në praktikë. Së këtejmi, pyetja kryesore që parashtrohet në këtë kontekst është: “Çfarë do të thotë kërkesë e arsyetuar mirë?”. Të gjithë bien dakord se kjo nënkupton që kërkesa duhet të përmbajë elemente të mjaftueshme për të bindur gjyqtarin se masa e posaçme hetimore e kërkuar është proporcionale me nevojën për të siguruar njohuri që në ndonjë mënyrë tjetër nuk do të mund të siguroheshin ose sigurimi i tyre do të ishte dukshëm më i vështirë.

Gjyqtarët e procedurës paraprake, por edhe gjyqtarët e trupit gjykues, konsiderojnë se në çështjet e krimit të organizuar, kërkesat janë zakonisht më të argumentuara dhe me informacione dhe njohuri të mjaftueshme, duke qenë se vetë lëndët janë shumë vëllimore dhe komplekse, ndërsa lëndët e të ashtuquajturit “krim i përgjithshëm” nuk janë gjithmonë të arsyetuara sa duhet, dhe jo gjithmonë japin rezultate. Në çdo rast, nëse një gjyqtar i procedurës paraprake konstaton se kërkesa nuk është e arsyetuar dhe argumentuar sa duhet, ai mund të kërkojë ndryshimin e saj nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me prokurorin publik, në mënyrë që të mund të marrë një vendim. Në raste të tilla, gjyqtarët konsiderojnë se përfshirja e hetuesve është me përfitim të madh, meqë u mundëson të shtojnë detaje plotësuese për çështjen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur kemi të bëjmë me raste komplekse që përfshijnë grupe të organizuara kriminale, ku ka shumë detaje dhe ndërlikime që mund të jenë kryesore për një vendimarrje të duhur.

Kërkesa nga prokurori publik për përcaktimin e masës së posaçme hetimore duhet të përmbajë elemente të mjaftueshme për të bindur gjyqtarin e procedurës paraprake se masa e kërkuar është proporcionale me nevojën për sigurimin e informacioneve që nuk do të mund të siguroheshin me ndonjë mënyrë tjetër ose sigurimi i tyre do të ishte dukshëm më i vështirë.

Argumentimi më i mirë dhe arsyetimi më i detajuar i kërkesave për zbatimin e MPH vërehen edhe në hetimet ndërkombëtare që zhvillohen me aplikimin e ndihmës së drejtësisë penale ndërkombëtare. Arsyja për këtë, sipas të gjithë bashkëbiseduesve, është fakti se këto kërkesa duhet të harmonizohen me standardet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, që nënkupton një përcaktim të saktë të nevojës për masën, bazën ligjore, proporcionalitetin dhe rezultatet e pritshme.

6. Vendimmarrja për aplikimin e masave të posaçme hetimore

Në përputhje me nenin 256 të LPP-së, MPH-të nga neni 252, paragrafi 1, pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të LPP-së i përcakton gjyqtari i procedurës paraprake me urdhër me shkrim, ndërsa MPH-të nga neni 252, paragrafi 1, pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të LPP-së i përcakton prokurori publik me urdhër me shkrim.

Neni 257, paragrafi 1 i LPP-së në mënyrë taksative i liston elementet e mëposhtme të përfshira në urdhrin për përcaktimin e një ose më shumë MPH:

- emërtimi ligjor i veprës penale,
- personi ose sendet mbi të cilat do të zbatohen masat,
- mjetet teknike që do të aplikohen,
- vëllimi dhe vendi i zbatimit të masave,

- njohuritë dhe provat mbi të cilat mbështeten bazat e dyshimit dhe justifikimi i arsyeve për shkak të të cilave të dhënat ose provat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër,
- autoriteti i cili duhet ta zbatojë urdhrin, dhe
- kohëzgjatja e masës.

Në përputhje me nenin 257, paragrafi 2 të LPP-së, urdhri për ndjekjen dhe regjistrimin e komunikimeve sipas nenit 252, paragrafi 1, pikat 1 dhe 2 të LPP-së, duhet ta përmbajë edhe llojin e sistemit të telekomunikacionit, numrin e telefonit ose ndonjë të dhënë tjetër për identifikimin e lidhjes së telekomunikacionit. Si kritere kryesore që gjyqtarët e procedurës paraprake i marrin parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave të prokurorëve publikë për përcaktimin e MPH, u theksuan si vijon:

- A është e arsyetuar dhe argumentuar mjaftueshëm kërkesa e prokurorit themelore publik?
- A i kanë ndërmarrë dhe shteruar paraprakisht prokurori themelore publik dhe punonjësit e policisë nga MPB të gjitha metodat në dispozicion në drejtim të mbledhjes së informacioneve dhe njohurive në lidhje me ngjarjen e drejtësisë penale?
- A janë siguruar njohuri adekuate dhe relevante?
- Çfarë është konstatuar nga prokurori publik në bazë të njohurive të marra?
- A ka mënyra alternative për sigurimin e njohurive të nevojshme?
- A bëhet fjalë për grupe të mëdha të organizuara kriminale me një strukturë dhe komunikim të brendshëm të mirë vendosur?
- A përmban rasti elemente ndërkombëtare (grup ndërkombëtar i krimit të organizuar, ndihmë ndërkombëtare në materien penale, etj.)?
- Çfarë njohurish pritet të merren përmes aplikimit të masës?
- Cili është justifikimi financiar i aplikimit të MPH? Në këtë kuptim, vlerësohet që çmimi i kostos sa i përket efektivitetit të prishëm dhe domosdoshmërisë së zbatimit të masës konkrete, veçanërisht në rastet kur ekzistojnë metoda alternative për sigurimin e informacioneve të nevojshme.

Ky vlerësim, sipas gjyqtarëve të procedurës paraprake, është thelbësor që të sigurohen se zbatimi i MPH është proporcional, i nevojshëm dhe i justifikuar. Lidhur me përcaktimin e MPH, përvoja e prokurorëve publikë konsiston me atë se gjyqtarët zakonisht i aprovojnë kërkesat e tyre, por konsiderojnë se detyrimi ligjor i gjyqtarit në këto veprime është vetëm ta vlerësojë kërkesën nga aspekti formal dhe të vlerësojë se a rrezikohen të drejtat e njeriut. Nëse është e nevojshme, gjyqtari në çdo rast mund ta kthejë kërkesën për plotësim, veçanërisht në rastet kur kërkohet vazhdimi i masave. Sipas tyre, gjyqtari i procedurës paraprake nuk duhet të hyjë në shqyrtimin material të lëndës, sepse ka një gjyqtar të çështjes me ç'rast çështja do të shqyrtohet dhe vendoset. Në të kundërt, gjyqtarët e procedurës paraprake i referohen detyrimit ligjor që u është dhënë atyre të vendosin për të drejtat dhe liritë e qytetarëve me ç'rast e marrin parasysh faktin se MPH përbëjnë ndërhyrje invazive pikërisht mbi disa prej të drejtave dhe lirive themelore personale.

7. Zbatimi i masave të posaçme hetimore

Në përputhje me nenin 258 të LPP-së, autoriteti i autorizuar për zbatimin e masave të posaçme hetimore është prokurori publik ose policia gjyqësore nën kontrollin e prokurorit publik.

Sa i përket zbatimit të MPH, përvoja e prokurorëve publikë të përfshirë në fokus grupin është se në praktikë shfaqen kryesisht pengesa teknike dhe institucionale. Si sfida teknike u theksua kufizimi i burimeve, përkatësisht mungesa e automjeteve zyrtare të nevojshme për zbatimin e masës ndjekja dhe regjistrimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtetësisë apo hapësirave afariste. Si sfida e theksuar edhe shfaqjen e problemeve me stabilitetin e linjës telefonike gjatë ndjekjes së komunikimeve në kohë reale, gjë që mund të pengojë efektivitetin e masës. Në nivel institucional, u theksua se prokuroria publike ende nuk ka

në dispozicion agjentë të fshehtë, prandaj duhet të mbështetet në resurset e MPB, gjë që krijon varësi dhe shtyrje të procedurave. Një sfidë shtesë në zbatimin e MPH është mënyra në të cilën kryerësit e veprave penale e përshtatin komunikimin e tyre për të shmangur zbulimin, duke përdorur gjithnjë e më shumë metoda të reja, inovative të komunikimit.

Në këtë drejtim, prokurorët i vunë në dukje edhe sfidat e mëposhtme:

- probleme me përkthimin e komunikimit të realizuar, që shpesh çon në humbje kohe dhe ndërlikim të hetimit,
- gjatë aplikimit të mjeteve teknike, prokurorët duhet të kontrollojnë së pari kapacitetet teknike të policisë gjyqësore para fillimit të përpunimit kriminalistik, për të ditur nëse mund të aplikojnë një PIM të caktuar në një rast konkret,
- njohuri të pamjaftueshme të specifikës dhe mënyrës së komunikimit të personave që përgjohen. Do të ishte më mirë që gjatë përgjimit të marrin pjesë hetuesit që ishin të përfshirë në rastin dhe që tashmë kanë njohuri solide për personat e involvuar në rastin.

Përveç kësaj, prokurorët publikë theksuan se duhet të përqendrohen në zbulimin e organizatorëve kryesorë të grupeve kriminale, dhe të mos harxhojnë resurse në zbatimin e MPH për persona të caktuar. Ata konsiderojnë se lista e veprave penale të listuara për lëshimin e MPH duhet të zgjerohet, veçanërisht sa i përket veprës penale tregtia e paligjshme me armë (neni 396, KP). Ata gjithashtu theksuan se praktika ka ndryshuar dhe se në të kaluarën ishte më e lehtë të paraqitej kërkesa për MPH, por viteve të fundit ka një zhvendosje në këtë praktikë. Sipas tyre, perceptimi se ato kërkohen dhe miratohen lehtë dhe shpejtë tashmë është një relike e së kaluarës.

Punonjësit e policisë që punojnë në MPH theksuan se zbatimi i masave bëhet sipas Procedurave Standarde të Operimit (PSO) dhe se para çdo veprimi përgatitet një plan i përshtatshëm. Aktet nënligjore në bazë të të cilave zbatohen MPH klasifikohen me gradën "Tepër Sekret". Nga përvoja e tyre, zbatimi i urdhrave shoqërohet me sfida të një natyre tjetër. Sfida kryesore gjatë zbatimit të MPH janë njohuritë e pamjaftueshme të mbledhura për personat dhe sendet e përfshira në hetimin, si dhe mungesa e profilizimit bazë të personit ose sendit. Sipas përvojës së deritanishme, ka raste në të cilat sektorët në MPB të ngarkuar për zbatimin e MPH veprojnë sipas urdhrave që nuk përmbajnë informacione të mjaftueshëm dhe të dhëna të rëndësishme që janë të nevojshme për zbatimin e masave. Në situata të tilla, inspektorët në mënyrë plotësuese i mbledhin informacionet e tjera relevante. Ata konsiderojnë se për shkak të kuantitetit, ndonjëherë vihet në rrezik kualiteti i veprimit. Si një problem tjetër, e vunë në Ëdukje faktin se ndonjëherë marrin urdhra madje fare pa u konsultuar me ta ose eprorët e tyre se a mund ta zbatojnë menjëherë masën përkatëse. Si rezultat i kësaj, në disa raste duhet pak kohë para se urdhri i lëshuar të fillojë të zbatohet. Për këto arsye, janë të mendimit se prokurori publik duhet të koordinohet me udhëheqësin e Sektorit për Hetime Kriminalistike në MPB. Ata theksuan se në vitet e para të inkorporimit të MPH, cilësia e punës në MPB në lidhje me këto masa ishte në një nivel më të lartë. Një nga arsyet e këtij konstatimi ishte politika joadekuate kadrovike dhe ritransferimi i punonjësve të trajnuar dhe të specializuar në këtë fushë. Një arsye tjetër është fakti që teknologjitë e komunikimit ndërkohë po ndryshojnë dhe përsosen, gjë që kontribuon në mundësinë për të komunikuar përmes llojeve të ndryshme të aplikacioneve të sofistikuar për të cilat mundësitë teknike për ndjekje janë më komplekse.

Ndonjëherë urdhrat e gjykatës mbërrijnë në policinë gjyqësore fare pa u konsultuar me shërbimet kompetente të ngarkuara për zbatimin e MPH a mund të zbatohet ndonjë masë e caktuar pa u prolonguar.

Hetuesit dhe inspektorët e theksuan nevojën e akteve nënligjore shtesë që do ta rregullonin në mënyrë më të detajuar procedurën për zbatimin e MPH në qendrat hetimore të prokurorisë themelore publike.

Njëherësh, si sfida plotësuese në zbatimin e MPH, u theksuan:

- mangësitë në kapacitetet dhe burimet njerëzore, si në MPB ashtu edhe në qendrat hetimore dhe nevoja për një ekip të veçantë për çdo rast individual që do të fokusohet ekskluzivisht mbi atë rast,
- numri i madh i detyrave tek inspektorët e policisë, siç është mbledhja e informacioneve, informimi i vazhdueshëm për zbatimin e masave dhe kryerja e aktiviteteve të tjera për qëllimet e hetimit, gjë që e vështirëson efikasitetin dhe suksesin e punës,
- pamundësia teknike për ndjekjen e aplikacioneve për komunikim, të cilat sot përdoren gjithnjë e më shumë, si Viberi, What'sAppi, Telegrami, Signali dhe të tjera,
- mëdyshje në shërbimin policor për sa i përket dilemave se cilët sektorë në MPB duhet të kenë mundësi ligjore për zbatimin e MPH. Inspektorët nga Sektori për Operacione të Fshehta janë të mendimit se edhe kolegët e tyre nga Sektori për Hetime Kriminallistike duhet të përfshihen në zbatimin e një mase të caktuar, nëse në një rast konkret Sektori për Operacione të Fshehta në momentin nuk ka kapacitete për zbatimin e masës. Megjithatë, ka edhe mendime të kundërta, përkatësisht se një mundësi e tillë do të jetë sfidë për mbrojtjen e fshehtësisë së procedurës dhe për të siguruar veprime të specializuara gjatë zbatimit të masave,
- mungesa e kapaciteteve teknike për ndjekjen efektive të të dhënave, prandaj ndjekja e të dhënave dhe njohurive të marra nga MPH është shumë e ngadaltë, sepse procesi i leximit dhe marrjes së shënimeve nga komunikimet merr shumë kohë gjatë hetimeve. Duke e thjeshtuar procedurën aktuale, përpunimi i informacioneve do të jetë shumë më efikas,
- nevoja për instalimin e digjitalizimit gjatë lëshimit të urdhrave për të gjitha llojet e MPH-ve, dhe jo vetëm për masën e nenit 252, paragrafi 1, pika 1 të LPP-së (duke e pasur parasysh se procesi aktual i digjitalizimit ka të bëjë vetëm me miratimin dhe zbatimin e masës nga neni 252, paragrafi 1, pika 1),
- mundësia e ndjekjes të një targeti nga disa institucione (MPB, qendrat hetimore, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria e Doganave). Megjithatë, njohuritë e tyre tregojnë se edhe vendet e tjera përballen me këtë sfidë,
- sektorë të ndryshëm në MPB, si Sektori për Hetime Kriminallistike, Sektori për Antiterrorizëm dhe Departamenti i Policisë Kriminallistike, mund të propozojnë aplikimin e MPH, kështu që janë të mendimit se për shkak të koordinimit, duhet të ketë ndjekje të centralizuara brenda një institucioni.

7.1. Kohëzgjatja e masave të posaçme hetimore

Në përputhje me nenin 260, paragrafi 1 të LPP-së, MPH mund të zgjasin më së shumti katër muaj. Kohëzgjatja e masave mund të vazhdohet në kushte të përcaktuara ligjërisht dhe me afate të sakta kohore, megjithatë, LPP në nenin 261 e detyron autoritetin që e ka lëshuar ose e ka vazhduar urdhrin menjëherë të urdhërojë ndërprerje të masave kur do të arrihen qëllimet për të cilat janë përcaktuar MPH ose arsyet për të cilat janë miratuar do të pushojnë së ekzistuari.

Në kuadër të fokus grupit me inspektorët e policisë nga MPB, u theksua se një numër të madh të masave i lënë të zbatohen deri në fund të afatit për të cilin janë miratuar, kurse ndonjëherë edhe masat që janë vazhduar, pavarësisht rezultateve nga zbatimi i tyre dhe pavarësisht nëse ato në ndërkohë e kanë arritur qëllimin. Inspektorët janë unanim në qëndrimin se në interes të mbrojtjes së privatësisë së personave, masa duhet të ndërpritet pas marrjes së informacioneve të duhura dhe relevante për hetimin, dhe jo të vazhdohet deri në skadimin e afatit të parashikuar ligjor.

Vazhdimi i masave sipas nenit 252, paragrafi 1, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të LPP-së më së shumti edhe për katër muaj mund të miratohet nga gjyqtari i procedurës paraprake, sipas kërkesës së arsyetuar me shkrim të prokurorit publik.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burgim prej së paku katër vjet dhe për të cilat ekziston dyshim i bazuar se janë kryer nga një grup i organizuar, bandë ose bashkim tjetër kriminal, gjyqtari i procedurës paraprake mund ta vazhdojë

zbatimin e masave për më së shumti gjashtë muaj, sipas kërkesës me shkrim të prokurorit publik, në bazë të vlerësimit të dobisë nga të dhënat e mbledhura përmes zbatimit të masës dhe mbi pritje të arsyeshme se masa edhe më tutje mund të sigurojë të dhëna me interes për procedurën. Masat nga neni 252 paragrafi 1, pikat 9, 10, 11 dhe 12 të LPP-së mund të vazhdohen derisa të arrihet qëllimi për të cilin është përcaktuar masa, dhe më së voni deri në përfundimin e hetimit.

Përvoja e inspektorëve të policisë nga MPB e prezantuar në diskutimet në fokus grupin, tregon se të gjitha propozimet për vazhdimin e MPH miratohen. Nga ana tjetër, gjyqtarët e procedurës paraprake janë decid në qëndrimin se vazhdimi i MPH mund të jetë i nevojshëm për konfirmimin shtesë të informacioneve, ndjekjen e zhvillimeve të reja të çështjes ose zbulimin e detajeve të reja të rëndësishme të çështjes. Sipas tyre, gjetjet e reja ose plotësuese që e vënë në dukje nevojën për vazhdimin e aktiviteteve hetimore janë arsyet më të shpeshta për shkak të të cilave prokurori publik në një rast konkret kërkon vazhdimin e zbatimit të një mase të caktuar.

Nëse gjatë zbatimit të masës merren të dhëna për veprën penale që nuk është përfshirë me urdhrin, në përputhje me nenin 263 të LPP-së, masa do të vazhdojë vetëm nëse bëhet fjalë për vepër penale sipas nenit 253 të LPP-së ndërkohë që të dhënat e mbledhura në këtë mënyrë mund të përdoren si prova në procedurën penale.

Përvoja e gjyqtarëve të procedurës paraprake e ndarë brenda fokus grupit konsiston me atë se zgjerimi i urdhrin për MVH lejohet kur gjatë zbatimit shfaqen prova ose informacione të reja që u referohen personave të tjerë që janë pjesë të rrjetit ose grupit të organizuar kriminal. Sipas tyre, zgjerimi i urdhrin zakonisht jep rezultate pozitive, meqë vë në dukje se hetimi ka zbuluar vepra penale të reja ose kryerës të rinj që nuk ishin përfshirë fillimisht. Kjo është një mundësi për zgjerimin e hetimit dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë penale në luftimin e krimit të organizuar. Kështu, si sfidë kryesore në vazhdimin e urdhrin për MPH u theksua vendimmarrja nga një gjyqtar tjetër, por jo nga ai që fillimisht e kishte lëshuar urdhrin, për shkak të specifikave të sistemit ACMIS, që konsiderojnë se mund të çojnë në mospërputhje në qasjen dhe vlerësimin e çështjes. Për të siguruar vazhdimësinë e procedurës, gjyqtarët e procedurës paraprake janë të mendimit se do të ishte mirë që çështja dhe vendimi për vazhdimin e masës të mbeten në kompetencën e të njëjtit gjyqtar të procedurës paraprake që e ka lëshuar urdhrin fillestar. Sipas tyre, kjo do të kontribuonte në njohjen më mirë me detajet e çështjes dhe konsistencë në arsyetimin ligjor. Ata theksuan se ka raste kur, me kërkesë të prokurorit publik, dhe për shkak të kontinuitetit, gjyqtari i njëjti i procedurës paraprake që e ka lëshuar urdhrin për zbatimin e MPH vendos edhe për vazhdimin e zbatimit të masës.

Zgjerimi i urdhrin zakonisht çon në rezultate pozitive, dhe vë në dukje se hetimi ka zbuluar vepra penale të reja ose kryerës të rinj që nuk ishin përfshirë fillimisht. Kjo është një mundësi për zgjerimin e hetimit dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë penale në luftimin e krimit të organizuar.

7.2. Masat për mbrojtjen e fshehtësisë së zbatimit të masave të posaçme hetimore

Personi i cili në çfarëdo mënyre zbulon të dhëna që kanë të bëjnë me ose që rrjedhin nga zbatimi i MPH e ka për detyrë t'i ruajë ato si sekret zyrtar (neni 263 i LPP-së).

I gjithë dokumentacioni që përpilohet për propozimin, kërkesën dhe miratimin e MPH është i klasifikuar me shkallë fshehtësie "Tepër Sekret". Nga ana tjetër, praktikuesit konsiderojnë se klasifikimi i tillë është një shkallë e lartë fshehtësie e panevojshme, ndërsa një trajtim më efikas dhe më ekonomik i këtij dokumentacioni do të arrihej nëse do të ri-klasifikohej si "Konfidencial". Në këtë mënyrë, do të sigurohej mbrojtja e nevojshme e informacioneve. Në fokus grupin me gjyqtarët, nga gjyqtarët e procedurës paraprake u theksua se në procesin e lëshimit të urdhrave për MPH ata janë plotësisht të përkushtuar dhe veprojnë në mënyrë profesionale për të mbrojtur fshehtësinë e procesit të miratimit dhe zbatimit të masave.

Gjyqtari i procedurës paraprake nuk e di se çfarë punon një gjyqtar tjetër i procedurës paraprake. Për një rast konkret, njoftohet vetëm gjyqtari i çështjes i procedurës paraprake, procesverbalisti dhe oficeri i sigurisë i informacioneve të klasifikuara.

Gjyqtari i procedurës paraprake nuk e di se çfarë punon një gjyqtar tjetër i procedurës paraprake. Për një çështje konkrete, njoftohet vetëm gjyqtari i çështjes i procedurës paraprake, procesverbalisti dhe oficeri i mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara.

Përveç kësaj, u shpreh një dakordësim i përgjithshme që inkorporimi i sistemit për digjitalizimin e procesit të miratimit dhe zbatimit të MPH do të kishte rëndësi të madhe për fshehtësinë dhe sigurinë më të madhe të gjithë procesit. Nga ana tjetër, qëndrimi i disa prej gjyqtarëve të trupit gjykues të përfshirë në këtë proces hetimor ka të bëjë me atë se nuk janë marrë masa të mjaftueshme efikase për mbrojtjen e fshehtësisë. Sipas tyre, rreziku kryesor i shkeljes së fshehtësisë së zbatimit të MPH lidhet me faktorin njerëzor, i cili e përfshin kontrollin joadekuat të qasjes në informacione sensitive ose zbulimet aksidentale të informacioneve nga persona që nuk janë të trajnuar sa duhet për ta ruajtur fshehtësinë, gjë që mund të çojë në komprometimin e hetimeve.

8. Përdorimi i masave të posaçme hetimore si provë në procedurën penale

Në përputhje me nenin 259, paragrafi 1 të LPP-së, të dhënat, njoftimet, dokumentet dhe sendet e siguruar nga aplikimi i MPH, mund të përdoren si prova në procedurën penale. Sipas nenit 259, paragrafi 5 të LPP-së, nëse gjatë zbatimit të masës nuk është vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së, vendimi gjyqësor nuk mund të mbështetet mbi të dhënat e marra.

Deklaratat e marra me aplikimin e MPH nga persona të cilët, në përputhje me LPP-në, janë liruar nga detyrimi për të dëshmuar, nuk mund të përdoren si prova. Personat që kanë marrë pjesë në zbatimin e masave mund të merren në pyetje si dëshmitarë të mbrojtur sipas kushteve të përcaktuara në nenet 226 deri në 232 të LPP-së, me ç'rast identiteti i personave që kanë marrë pjesë në zbatimin e masave përbën sekret zyrtar.

Gjyqtarët janë unanimë në qëndrimin se provat e siguruara përmes aplikimit të MPH e kanë të njëjtën rëndësi provuese si të gjitha provat e tjera të pranuar. Këto prova shpesh ndërlidhen me prova të tjera që të konfirmohet relevanca dhe besueshmëria e tyre. Sipas praktikës së deritanishme, perceptimi është se MPH tregojnë efikasitet dukshëm më të madh në krimin klasik (vepra penale të listuara në nenin 253, paragrafi 1, pika 2 të LPP-së). Megjithatë, kur bëhet fjalë për krimin e organizuar, për shkak të kompleksitetit të rasteve, metodave dhe nivelit të koordinimit midis kryerësve, këto masa jo gjithmonë japin rezultate pozitive.

Provat e siguruar përmes aplikimit të MPH shpesh ndërlidhen me prova të tjera që të konfirmohet relevanca dhe besueshmëria e tyre.

Nga përvoja e gjyqtarëve të trupit gjykues gjatë nxjerrjes së provave të mbledhura përmes MPH, mbrojtja shpesh kërkon qasje në njohuritë e plota të siguruar përmes MPH, si dhe në të gjitha provat përkatëse. Megjithatë, nuk ka një mënyrë të uniformuar të veprimit midis gjyqtarëve në situata të tilla. Për më tepër, gjyqtarët theksuan se kërkesat për aplikimin e MPH nuk u dërgohen avokatëve, por vetëm urdhrat, me kërkesë të avokatëve, gjë që është veçanërisht e rëndësishme nga aspekti i së drejtës për mbrojtje, por edhe në kontekstin e transparencës së procedurës.

Nga diskutimet në fokus grupin me avokatët rezultoi se ata ndajnë këtë mendim me ç'rast vunë në dukje edhe sfida të tjera me të cilat përballen në lidhje me MPH. Ata theksuan se përgjithësisht nuk kanë qasje të plotë dhe në kohë në materialet e siguruar përmes aplikimit të MPH dhe se nuk kanë akses në urdhrat për MPH, as në rrjedhën e hetimit madje as në procedurën e provave. Ata theksuan se në shumicën e rasteve, urdhrat jepen për këqyrje me kërkesë të avokatëve edhe atë në procedurën e provave, që sipas tyre, rezulton se avokatët nuk janë të informuar sa duhet për rrjedhën e plotë dhe vëllimin e aplikimit të MPH. Përveç kësaj,

avokatët shpjeguan se mbrojtja nuk ka qasje në materialet e siguruara përmes MPH që janë zbatuar nga Prokuroria Publike. Këto materiale u vihen në dispozicion në seancën kryesore, kur avokatët paraqesin kërkesë për këqyrje. Por edhe atëherë, këqyrja zakonisht lejohet vetëm në sallën e gjyqimit, sepse këto materiale shtypen vetëm në një kopje, kështu që avokatëve nuk u jepet kohë e mjaftueshme t'i shqyrtojnë materialet në tërësi, megjithëse ato shpesh janë mjaft vëllimore dhe komplekse. Si problem shtesë që e kërcënon drejtësinë e procedurës, e theksuan faktin se gjykatat shpesh nuk i aprovojnë kërkesat e mbrojtjes për të kontrolluar ligjshmërinë e provave të siguruara. Veç tjerash, në kuadër të fokus grupit me avokatët, u theksuan një sërë sfidash të tjera, me të cilat ballafaqohen si mbrojtës në çështje konkrete në të cilat janë aplikuar MPH dhe për të cilat janë të mendimit se ndikojnë seriozisht mbi drejtësinë dhe transparencën e procedurave gjyqësore. Sfidat e apostrofuara kanë të bëjnë me sa vijon:

- pritje të gjata për deklasifikimin e materialeve të siguruara përmes MPH, ndërsa palët janë shpesh në paraburgim dhe nuk kanë akses në provat kryesore, gjë që cenon të drejtën për mbrojtje efektive,
- ka raste të përdorimit të MPH me persona me identitet të fshehur të cilët nxisin veprime të caktuara, kurse provat e marra në këtë mënyrë megjithatë janë aprovuar nga gjykata, megjithëse ka dyshime për ligjshmërinë e tyre,
- regjistrime të bëra nga qytetarët ndonjëherë aprovohen si prova me të njëjtën peshë si ato të marra përmes MPH formale, pa një distinkcion të qartë sa i përket vlerës së tyre procedurale,
- masa e simulimit të mitë dhënies dhe mitë marrjes, përmes shënimit të parave, zbatohet drejtpërdrejt nga MPB pa urdhër nga Prokuroria Publike, gjë që e vë në pikëpyetje ligjshmërinë e masës së aplikuar.

Avokatët vunë në dukje edhe një rast konkret gjyqësor kur, gjatë dëgjimit të bisedave telefonike në një sallë gjyqimi, u lejua të dëgjohet një bisedë midis të pandehurit dhe avokatit të tij. Edhe pse me lejen e avokatit është dëgjuar biseda e regjistruar në mënyrë që të konstatohet se nuk ka elemente të palejuara gjatë bisedës, megjithatë vlerësimi i avokatëve është se një praktikë e tillë vë në dukje rrezikun serioz të shkeljes së privilegjit avokat-klient dhe të drejtës për komunikim privat. Avokatët angazhohen për një kuadër ligjor më të qartë, procedura më të rrepta dhe kontroll më të madh gjyqësor në përdorimin, vlerësimin dhe nxjerrjen e provave të siguruara përmes MPH. Perceptimi i avokatëve konsiston me atë se ekziston favorizim i pozitës së prokurorisë publike nga gjykata, si dhe se nevojitet transparencë më e madhe në procedurën dhe këqyrje në kohë të duhur të materialit të provave të siguruara nga prokurorët, me qëllim të trajtimit të barabartë dhe të ndershëm të armëve në procedurë.

Nga ana tjetër, në fokus grupin me gjyqtarët u theksuan edhe sfidat me të cilat përballen gjyqtarët e trupit gjykues gjatë nxjerrjes së provave të siguruara përmes aplikimit të MPH. Gjyqtarët e vunë në dukje të folurit dhe vokabularin e përdorura nga kriminelët, gjë që mund ta vështirësojë të kuptuarit dhe interpretimin e përmbajtjes së regjistrimeve. Ata theksuan se nuk ekziston një regjistër kodesh për interpretimin/përkthimin e frazave dhe zhargonit të tyre. Së këtejmi, probleme gjatë nxjerrjes së provave lindin edhe me mosfunksionimin e CD-disqeve, si dhe me disa mospërputhje midis informacioneve të raportit dhe atyre në dosjet audio, që mund të shkaktojnë jokonsekuencë dhe konfuzion. Sipas gjyqtarëve, problem është edhe cilësia e dobët e regjistrimeve, veçanërisht ato me cilësi të pamjaftueshme të zërit ose të folurit të paqartë, gjë që mund të kërcënojë besueshmërinë e tyre si prova. Ekziston edhe dyshime se regjistrimet e një bisede midis të pandehurit dhe avokatit të tij a duhet të prezantohen në gjykatë dhe si të bëhet kjo, duke e pasur parasysh mbrojtjen ligjore të fshehtësisë së komunikimit midis të pandehurit dhe avokatit të tij. Atëherë, në mënyrë legjitime parashtrahet pyetja - mbrojtja e komunikimit a ka të bëjë vetëm me avokatin e të pandehurit ose me çdo avokat, në përgjithësi, pavarësisht nëse në rastin konkret është mbrojtës i autorizuar i të pandehurit në procedurën.

Për gjyqtarët e trupit gjykues ekzistojnë dilema edhe sa i përket pyetjes MPH-të e një lënde a mund të përdoren si prova në një lëndë tjetër. Probleme lindin edhe me atë se AOT nuk jep kopje të dosjeve audio që i ruajnë, veçanërisht ato për rastet më të vjetra

që janë zbatuar nga ish-Drejtoria e Sigurisë dhe Kundërzbulimit, gjë që mund të krijojë pengesa në procedurën e provës. Është e shpeshtë praktika që avokatët të kërkojnë informacione më të detajuara dhe këqyrje në pajisjet me të cilat janë zbatuar MPH. Së këtejmi, shfaqet problem edhe në rastet kur një gjë e tillë kërkohet pas një periudhe të gjatë kohore, kështu që pajisjet vjetërsohen dhe nuk janë më në përdorim, gjë që e bën të pamundur kontrollin ose këqyrjen e tyre. Kjo e bën procesin e kontrollit të vlefshmërisë së masave të zbatuara të jetë vështirë i zbatueshëm, gjë që mund të ndikojë në sigurinë ligjore dhe efikasitetin e procesit të hetimit.

Disa gjyqtarë të trupit gjykues kanë krijuar një praktikë që e mbron privatësinë e personave të interesuar. Me fjalë të tjera, ato lejojnë këqyrje në shkresat e MPH të zbatuara në hapësirat e prokurorisë publike, në praninë e prokurorit themelor publik dhe nëpunësve të gjykatës, por pa mundësinë e bërjes së kopjeve. Së këtejmi, gjyqtari i kërkon prokurorit në seancën kryesore të prezantohet vetëm pjesa relevante e shkresave, duke e informuar paraprakisht mbrojtjen edhe me një kërkesë për dakordësimin e tyre, që shënohet në procesverbal. Ndonjëherë, mbrojtja paraqet kërkesa shtesë për qasje në një gamë më të gjerë të materialeve, të cilat zgjidhen në varësi të rastit konkret. Disa gjyqtarë, duke iu referuar nenit 8 të KEDNJ-së, refuzojnë të lejojnë akses në të gjithë materialin e mbledhur me MPH, veçanërisht në situata në të cilat mbrojtja e privatësisë së të pandehurit dhe personave të tjerë të përfshirë është e domosdoshme.

Gjykata Themelore Penale Shkup ka krijuar një praktikë të veprimit me kërkesë të personave të interesuar, të cilët, në përputhje me dispozitat e LPP-së, kanë të drejtë të informohen nëse ndaj tyre është zbatuar ndonjë MPH. Ky është një hap pozitiv drejt promovimit të transparencës dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve në procedurë.

Megjithëse LPP-ja parashikon shkatërrimin e të dhënave të siguruara përmes MPH, në praktikë ky detyrim akoma nuk zbatohet në gjykatat, prokuroritë dhe në policinë gjyqësore. Arsyeja kryesisht ka të bëjë me atë se dispozitat ligjore nuk janë mjaftueshëm të qarta dhe të sakta, ndërsa përveç kësaj mungon edhe rregullimi i aspekteve teknike të procesit. Kjo është arsyeja e përpilimit të Udhëzuesit për Shkatërrimin e të Dhënave të Mbledhura me Masat e Posaçme Hetimore²⁴, i cili synon të shërbejë si mbështetje për praktikuesit ligjorë në lidhje me fillimin e duhur dhe konsekuent të këtij procesi.

9. Bashkëpunimi ndërinstitucional gjatë aplikimit të masave të posaçme hetimore

Bashkëpunimi ndërinstitucional, komunikimi dhe koordinimi midis autoriteteve kompetente për zbatimin e MPH me prokurorinë publike dhe gjykatën përgjithësisht u vlerësuan si të mira nga të gjithë të anketuarit. Ata theksuan se ka komunikim aktiv dhe konsultime të rregullta midis MPB dhe prokurorisë publike, me ç'rast shmanget lëshimi i kërkesave për MPH pa justifikimin e duhur dhe një panoramë të plotë të rastit.

Të anketuarit theksuan se komunikimi dhe bashkëpunimi janë veçanërisht të mira sa u përket hetimeve ndërkombëtare. Kjo ka të bëjë me standardet e larta që zbatohen në ndihmën ndërkombëtare të drejtësisë penale, që nënkupton qasje të koordinuar, kërkesa të justifikuara në detaje dhe bashkëpunim të ngushtë midis autoriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, në hetimet ndërkombëtare, autoritetet kompetente nga vende të ndryshme bashkëpunojnë përmes mekanizmave të dakordësuar ligjorë, siç janë marrëveshjet dypalëshe, konventat dhe instrumentet ligjore të Bashkimit Evropian. Duke vepruar kështu, kërkohet kujdes i jashtëzakonshëm gjatë përpilimit të kërkesave, pasi ato i nënshtrohen kontrollit nga autoritetet e huaja, të cilët shpesh kanë standarde të larta për miratimin e masave të tilla. Si rezultat, kërkesat e paraqitura në kuadër të hetimeve ndërkombëtare përgjithësisht janë më të detajuara, të argumentuara më sistematikisht dhe me një logjikë të qartë ligjore, me ç'rast sigurohet qëndrueshmëri më e madhe ligjore dhe pranueshmëri ndërkombëtare të tyre.

²⁴ Periq, C. etj. (2024). Udhëzues për Shkatërrimin e të Dhënave të Mbledhura me Masat e Posaçme Hetimore. Shkup DCAF, <https://jorm.gov.mk/vodich-za-nishtene-podatoczi-sobrani-so-posebni-istrazhni-merki/>

Prokurorët publikë nga këndvështrimi i tyre konsiderojnë se bashkëpunimi me policinë gjyqësore është solid, me mundësi përmirësimi. Ata theksuan se qendrat hetimore në kuadër të prokurorisë janë një aspekt veçanërisht pozitiv, ku inspektorët policorë punojnë në koordinim të drejtpërdrejtë me prokurorët publikë. Ky bashkëpunim i ngushtë mundëson përgatitjen në kohë dhe me cilësi të përmbajtjes të propozimeve për zbatimin e MPH, gjë që rezulton me një proces hetimor më efikas dhe me cilësi më të mirë.

Një nga mënyrat formale për përmirësimin e bashkëpunimit që e theksuan prokurorët publikë është Memorandumi i Bashkëpunimit midis MPB dhe Prokurorisë Publike, i cili është një dokument i gjallë që duhet të aktivizohet përmes Komisionit për Monitorimin e Zbatimit të tij. Kjo e përfshin evaluimin e aspekteve praktike të koordinimit, komunikimit dhe bashkëpunimit. Prokurorët theksuan se ka nevojë për një ndërgjegjësim më të madh në MPB për rolin dhe funksionin e prokurorëve publikë kujdestar. Duhet të sqarohen saktësisht se për çfarë duhet të informohen dhe çfarë kërkon MPB prej tyre në kuadër të procesit të propozimit të MPH. Ata theksuan se komunikimi me inspektorët është shumë i rëndësishëm. Ata janë të mendimit se prokurori publik duhet të jetë në komunikim të ngushtë dhe të marrë pjesë në takime koordinuese me inspektorët e përfshirë në zbatimin e MPH. Ata theksuan se disa prokurorë marrin pjesë drejtpërdrejt në terren gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore konkrete.

Bashkëpunimi, sipas inspektorëve nga MPB, varet shumë nga prokurori publik si individ. Sipas tyre, prokurorët publikë kanë standarde të ndryshme për sa i përket asaj nëse dhe cilën MPH e konsiderojnë të nevojshme në një rast konkret. Inspektorët konsiderojnë se është i nevojshëm inicimi i takimeve të përbashkëta me prokurorët publikë dhe gjyqtarët, me qëllim rishikimin e uniformitetit dhe harmonizimit me çështje të caktuara që kanë të bëjnë me zbatimin e MPH.

10. Trajnimi dhe resurset për përdorimin më efikas të masave të posaçme hetimore

Të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupet ranë dakord se kanë nevojë për trajnime të specializuara përmes të cilave do të fitojnë njohuri që korrespondojnë me specifikat dhe problematikën që e trajtojnë.

Në kuadër të fokus grupit me inspektorët nga MPB, u theksua se aktualisht të sapopunësuarit që fillojnë të punojnë në njësitë organizative që propozojnë dhe zbatojnë MPH përfshihen në punë përmes një trajnimi dy-javor të organizuar nga Akademia e Policisë pranë MPB. Nga ana tjetër ka edhe trajnime të specializuara që fokusohen mbi aspektet teknike të zbatimit të MPH, të organizuara në partneritet me ministritë dhe policitë e vendeve të tjera, meqë bëhet fjalë për trajnime specifike për të cilat nuk ka trajnues adekuat në vendin tonë. Megjithatë, ata theksuan se ekzistojnë sfida me procesin e implementimit të trajnimeve. Në Akademinë e Policisë, me iniciativën e Departamentit për Zbulim Kriminalistik dhe Analizë pranë MPB, u organizuan trajnime për analizën e të dhënave dhe përgatitjen e grafikëve, në të cilat morën pjesë trajnues dhe ekspertë vendas, të cilët nuk vazhduan të ofrohen si trajnues. Përveç kësaj, trajnuesit nuk lirohen nga detyrat e tyre të rregullta të punës gjatë organizimit dhe zbatimit të trajnimeve, gjë që e bën procesin e trajnimit më pak tërheqës për ta, pa motivim të mjaftueshëm për t'i transferuar njohuritë e fituara tek kolegët e tyre në mënyrë sistematike formale. Zëvendësimi i stafit udhëheqës në njësitë organizative është një problem shtesë, sepse kjo e çrregullon vazhdimësinë e trajnimeve.

Gjyqtarët e fokus grupit vunë në dukje se trajnimi shtesë për ta në fushën e provave digjitale dhe teknologjive të reja hetimore është më se i nevojshëm. Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, gjyqtarët duhet të jenë mirë të informuar për metodat e reja të mbledhjes dhe përpunimit të provave digjitale, siç janë nënshkrimet elektronike, që të jenë në gjendje t'i vlerësojnë dhe zbatojnë në mënyrë efektive këto prova në procedurat. Trajnimi duhet të

²⁵ Në përputhje me nenet 71 dhe 77 të Ligjit për Punë të Brendshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 160/2025), Qendra e Trajnimit në MPB u riemërua në Akademia e Policisë kompetente për implementimin e trajnimeve në Ministri.

mbulojë edhe tema të tilla si kriptografia, enkriptimi i të dhënave, siguria e të dhënave dhe mbrojtja e privatësisë, si dhe dallimi midis formave tradicionale dhe të reja të provave, në mënyrë që të sigurohet ligjshmëria dhe interpretimi i drejtë i tyre në procedurat gjyqësore. Gjatë trajnimit fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, nuk organizohen simulime dhe ushtrime për përpilimin e dokumentacionit (kërkesa dhe urdhra) për zbatimin e MPH, as simulime praktike për propozimin, kërkesën dhe zbatimin e tyre. Nga ana tjetër, aspektet teknike, fare nuk janë përfshirë në programin mësimor. Përveç kësaj, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, nuk ka trajnime të specializuara për provat digjitale dhe teknologjitë e reja hetimore. Kjo është një mangësi e rëndësishme, pasi trajnimet e tilla janë të domosdoshme që gjyqtarët të fitojnë njohuri adekuate për atë se si funksionon sistemi i ndjekjes së komunikimeve nga aspekti teknik, gjë që është thelbësore për trajtimin efektiv të provave digjitale.

Avokatët, gjithashtu, janë të mendimit se ekziston nevojë për një trajnim profesional më përmbajtësor dhe më sistematik dhe shkëmbim përvojash me qëllim avancimin e njohurive dhe aftësive praktike në këtë fushë. Ata theksuan se disa nga avokatët në praktikën e tyre profesionale asnjëherë nuk janë përballur me masa të tilla dhe nuk janë njoftuar me procedurat dhe aspektet teknike të aplikimit të MPH, që do të ishin të dobishme gjatë kontestimit eventual të provave të mbledhura përmes aplikimit të MPH. Ata vlerësojnë se njohja e pamjaftueshme e kësaj materieje mund të ndikojë mbi cilësinë e avokimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të pandehurve në procedurë.

11. Kontrolli dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e masave të posaçme hetimore

Procesi i aplikimit të MPH, përveç të gjitha segmenteve të lartpërmendura, përfshin edhe mekanizma adekuat përmes të cilëve do të monitorohet zbatimi i masave në praktikë. Kontrolli dhe mbikëqyrja ndryshojnë nga njëra tjetra sipas llojit të veprimeve që ndërmerren brenda tyre dhe subjekteve të cilave u drejtohen ato veprime. Si kontrolli ashtu edhe mbikëqyrja përcaktohen nga një sërë faktorësh, si dhe nga mjedisi i përgjithshëm shoqëror, politik dhe i sigurisë në një vend. Është jashtëzakonisht i rëndësishëm integriteti dhe pavarësia e subjekteve dhe institucioneve të përfshira në këto procese, të cilat duhet të jenë korrektor të punës së autoriteteve të autorizuara për aplikimin e këtyre masave invazive.

11.1. Kontrolli mbi zbatimin e masave të posaçme hetimore

Kontrolli mbi aplikimin e MPH zbatohet në kuadër të autoriteteve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht nga prokurori publik që e zhvillon hetimin dhe nga gjyqtari i procedurës paraprake që e ka lëshuar urdhrin për MPH, përcaktimi i të cilave është në kompetencën e tij. Kontrolli duhet të praktikohet vazhdimisht në mënyrë që do ta pamundësojë aplikimin e MPH të jetë një mjet i parregullsive ose abuzimeve eventuale. Në funksion të kontrollit efektiv, prokurorët publikë dhe gjyqtarët e procedurës paraprake mund të angazhojnë ekspertë teknikë ndërsa kontrollin ta kryejnë sipas nevojës, por edhe pa paralajmërime. Në lidhje me masën ndjekja e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike, aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar me nenin 59 të LPP-së. Organet e kontrollit mund të bëjnë këqyrje në vendin ku ndodhen stacionet e punës të cilat i përdorin autoritetet e autorizuara, në hapësirat e AOT-së ku ndodhen pajisjet për ndjekjen e komunikimeve dhe pajisjet e ndërmjetësimit, por edhe në vendin ku operatorët i ruajnë pajisjet për ri-drejtimin e sinjalit deri te AOT. Ata gjithashtu mund të kërkojnë ose të qasen drejtpërdrejt në sistemin e regjistrimit elektronik; të kërkojnë këqyrje ose të marrin një kopje të regjistrimit në formë të shtypur dhe të urdhrin të anonimizuar; t'i lexojnë të gjitha regjistrat që janë krijuar, regjistruar ose ruajtur nga sistemet që i përdorin AOT dhe operatorët.

11.1.1. Kontrolli gjyqësor mbi aplikimin e masave të posaçme hetimore

Kontrolli gjyqësor ushtrohet nga gjyqtari i procedurës paraprake i cili ka lëshuar urdhër për përcaktimin e MPH. Gjyqtari si individ duhet të ketë një qasje jashtëzakonisht të kujdesshme gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave të prokurorëve publikë për përcaktimin e MPH. Para lëshimit të urdhrin për përcaktimin e MPH, gjyqtari i procedurës paraprake duhet të bëjë një vlerësim objektiv:

- A është e vërtetë se në rastin konkret bëhet fjalë për rrezik që korrespondon me shmangien nga të drejtat personale të individëve?
- MPH-tësiaktivitetet e thellësisht intruzivën një rast konkret ndërmerrensi alternativa ekstreme për mbledhjen e të dhënave dhe provave të nevojshme?

Gjyqtarët e procedurës paraprake që morën pjesë në sesionet e punës të fokus grupeve në lidhje me kontrollin mbi zbatimin e MPH, vunë në dukje se ajo zbatohet në dy mënyra: 1. përmes raporteve të paraqitura nga policia gjyqësore përmes Prokurorisë Publike; dhe 2. përmes kontrolleve ad hoc. Megjithëse mund të bëjnë vizita në institucionet kompetente për zbatimin e masave (AOT dhe autoritetet e autorizuara), gjyqtarët theksuan se vizitat nuk janë vendosur si praktikë e rregullt. Një nga arsyet për këtë e theksuan faktin se nuk ka një mënyrë të detajuar për zbatimin e kontrollit në formën e një udhëzimi ose procedure që do t'i përfshinte aspektet teknike dhe hapat konkret për ushtrimin e kontrollit gjyqësor mbi zbatimin e MPH. Si një mangësi shtesë, e theksuan faktin se, edhe pse LNK e parashikon mundësinë e angazhimit të ekspertëve teknikë në mbështetje të kontrollit gjyqësor, megjithatë, ata ende nuk janë zgjedhur nga Kuvendi. Mungesa e njohurive të duhura teknike dhe mbështetjes teknike i pamundëson gjyqtarët e procedurës paraprake në zbatimin e kontrollit efektiv. Megjithatë, ata potencuan se janë veçanërisht të kujdesshëm sa i përket mbrojtjes së privatësisë dhe ligjshmërisë gjatë zbatimit të këtyre masave. Ata janë të vetëdijshëm se megjithëse nuk kryhen kontrolle fizike, ata kanë detyrim ligjor për ndjekjen e kujdesshme të proceseve dhe garantimin që të gjitha procedurat në lidhje me MPH ndërmerren në përputhje me normat ligjore. Nga ana tjetër, avokatët si mbrojtës janë të mendimit se megjithëse kontrolli gjyqësor ekziston formalisht, veçanërisht gjatë vlerësimit të provave para fillimit të procedurës provuese, praktika megjithatë vë në dukje mangësi të caktuara sa i përket efektivitetit dhe konsekuencës së tyre në fazën e ndryshme të procedurës. Avokatët theksuan se gjykatat shpesh lëshojnë urdhra për aplikimin e MPH për personat me identitet të panjohur, gjë që lë hapësirë për një përfshirje më të gjerë personash, pa individualizim dhe konkretizim të mjaftueshëm.

11.1.2. Kontrolli i prokurorit publik mbi aplikimin e masave të posaçme hetimore

Në përputhje me nenin 258 të LPP-së, gjatë zbatimit të MPH, policia gjyqësore përpilon raport të cilin ia dërgon prokurorit publik me kërkesë të tij, kurse pas zbatimit të masave përpilon një raport të veçantë, të cilit ia bashkëngjit të gjithë dokumentacionin e evidencës teknike dhe të njëjtat ia dërgon prokurorit publik. Raporti i policisë gjyqësore e përmban kohën e fillimit dhe përfundimit të masës; numrin dhe identitetin e personave të përfshirë me masën, si dhe një përshkrim të shkurtër të rrjedhës dhe rezultateve të zbatimit të masës.

Sipas inspektorëve të policisë gjyqësore që punojnë në zbatimin e MPH, kontrolli kryhet përmes raporteve mujore që ligjërisht i paraqiten Prokurorisë Publike, por edhe përmes konsultimeve të drejtpërdrejta me gojë me prokurorin publik, të cilat janë të rregullta dhe të vazhdueshme. Qëllimi i konsultimeve është të sigurohet efektiviteti dhe harmonizimi i masave me aktet ligjore. Prokurori publik ka mundësi ligjore në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi zbatimin e MPH ndaj lëndës për të cilën ai është përgjegjës. Megjithatë, ekziston një qasje e ndryshme nga prokurorët publikë gjatë zbatimit të kontrollit mbi aplikimin e MPH. Për këtë qëllim, është krijuar një praktikë e takimeve të rregullta koordinuese të prokurorëve publikë me inspektorët që i zbatojnë MPH, si dhe prezencë të prokurorit publik gjatë zbatimit të MPH.

Raportin e policisë gjyqësore dhe të gjithë dokumentacionin prokurori publik në përputhje me nenin 258 paragrafi 5 të LPP-së, ia dërgon gjyqtarit të procedurës paraprake.

Nga aspekti i përvojës së tyre, prokurorët publikë theksuan se zbatimin e MPH e kontrollojnë përmes komunikimit dinamik dhe të vazhdueshëm me policinë gjyqësore. Ata çdo ditë monitorojnë nëse masa e aplikuar ofron njohuri të rëndësishme për hetimin dhe zbulimin e rastit, duke bërë një vlerësim të vazhdueshëm të relevancës dhe efektivitetit

të masës. Përveç kësaj, ata presin që sistemi i digjitalizimit për propozimin, kërkesën dhe lëshimin e MPH-ve të funksionojë për të gjitha MPH-të, gjë që do të mundësojë një kontroll më të madh mbi procesin e përgjithshëm.

LPP në nenin 271 e detyron Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit të paraqesë raport në Kuvend në të cilin do të specifikojë të dhënat për të 8 pikat e MPH-ve të kërkuara në vitin kalendarik të mëparshëm.

Edhe pse dispozitat e LPP-së nuk i përcaktojnë kompetencat e Kuvendit në lidhje me raportin vjetor të paraqitur, nga përmbajtja e nenit 271 të LPP-së rezulton se qëllimi i këtij informimi të Kuvendit është të marrë të dhëna që e pasqyrojnë jo vetëm statistikisht dinamikën e zbatimit të MPH-ve, por edhe të dhëna të tjera mbi bazën e të cilave mund të krijohet një panoramë e plotë dhe reale e të gjitha aspekteve relevante të procesit të zbatimit të MPH-ve dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare gjatë aplikimit të tyre. Sipas avokatëve, ekziston një praktikë që autoritetet hetimore të inspektojnë komunikimet telefonike pa kërkesë paraprake për aplikimin e MPH. Ata e theksojnë si veçanërisht problematik sekuestrimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera vetëm mbi bazën e një vërtetimi për sendet e sekuestruara përkohësisht, pasuar nga analiza forenzike dhe këqyrja në përmbajtjen e tyre pa vendim gjyqësor. Kjo qasje është dukshëm më invazive se MPH-të e tjera, kurse në këtë mënyrë e vë në pikëpyetje respektimin e të drejtës për privatësi dhe procedurë të ndershme, veçanërisht pasi nuk ekzistojnë procedura të përcaktuara shtesë për aplikimin dhe kontrollin e saj, siç janë parashikuara për MPH. Avokatët janë të mendimit se praktikat e tilla vënë në dukje nevojën emergjente për fuqizimin e kontrollit gjyqësor dhe rregullimin më të qartë të procedurave për miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të MPH.

11.2. Mbikëqyrje mbi aplikimin e masave të posaçme hetimore

Mbikëqyrja mbi zbatimin e MPH-ve është një segment i rëndësishëm i procesit të përgjithshëm sepse mundëson detektimin në kohë të mospërputhjeve të mundshme në aplikimin e këtyre masave. Disa komisione dhe organe të ndryshme, nga aspekti i kompetencave të tyre, mund të ushtrojnë mbikëqyrje mbi aplikimin e MPH. Sidoqoftë, më e rëndësishmja është mbikëqyrja parlamentare si një instrument që mundëson ex ante ose ex post këqyrje në aktivitetet komplekse operative të organeve të përfshira në procesin e zbatimit të MPH. Dy komisione parlamentare (Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Punës së Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe Agjencisë për Zbulim) e mbikëqyrin punën e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit, ndërkaq ekziston edhe Komisioni i specializuar për Mbikëqyrje Mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve.

Me LNK të vitit 2018 në mënyrë evidente u tejkaluan mospërputhjet ligjore të cilat, edhe pse në shikim të parë të natyrës teknike, megjithatë e vështirësonin dhe në periudha të caktuara e kanë paralizuar plotësisht mbikëqyrjen mbi ndjekjen e komunikimeve. Kjo kryesisht ka të bëjë me angazhimin e ekspertëve teknikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë me njohuri të duhura profesionale, të cilët do të marrin pjesë në mbikëqyrjen. Në drejtimin e njëjtë është edhe lëshimi i certifikatës së sigurisë në një procedurë që nuk do të zgjasë më shumë se 30 ditë (neni 37, paragrafi 2 i LNK-së). Është e rëndësishme edhe ajo që Komisioni e ushtron mbikëqyrjen pa paralajmërim, sipas nevojës, dhe të paktën një herë në tre muaj, madje edhe në mungesë të shumicës së votave (neni 44, paragrafi 1 i LNK-së). Komisioni mund të ushtrojë këqyrje për të përcaktuar nëse operatorët i kanë siguruar kushtet e nevojshme adekuate për lidhjen e saktë dhe të qartë të informacioneve që kanë të bëjnë me komunikimin e ndjekur të përmbajtjes së komunikimit, një detyrim që rezulton nga neni 68, paragrafi 6 i LNK-së. Gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, Komisioni mund të kërkojë mbështetje ekspertësh nga çdo institucion dhe autoritet shtetëror që nuk është objekt i mbikëqyrjes, mes tjerash nga Agjencia për Komunikime Elektronike, Drejtoria për Sigurinë e Informacioneve të Klasifikuar dhe Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për çështje në kompetencë të tyre.

Kundrejt këtyre elementeve, përfshirja e të cilave në dispozitat ligjore ishte e nevojshme, mbetet përshtypja se komisioni parlamentar kompetent megjithatë ka autorizime të kufizuara ligjore që mund ta vënë në pikëpyetje cilësinë e mbikëqyrjes. Për më tepër, Komisioni, por edhe ekspertët teknikë të akredituar, në ushtrimin e mbikëqyrjes, mund të bëjnë krahasimin e regjistrave për kohën dhe datën e fillimit dhe përfundimit të ndjekjes të komunikimeve të cilat mund të merren si të dhëna nga operatorët, AOT dhe autoritetet e autorizuara. Nga AOT dhe autoritetet e autorizuara, për Komisionin është i aksesshëm edhe urdhri anonim i gjykatës (urdhri i rregullt dhe i përkohshëm me shkrim) ndërsa nga AOT dhe regjistrat për numrin e përgjithshëm të masave të zbatuara për ndjekjen e komunikimeve për një periudhë të caktuar kohore. Me aksesin në të dhënat e specifikuar, Komisioni dhe ekspertët teknikë megjithatë nuk kanë akses në të dhënat për identitetin e personit, numrin e telefonit, email adresën, etj. Për këto arsye, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, Komisioni dhe ekspertët teknikë nuk mund t'i krahasojnë të dhënat nga urdhri i lëshuar gjyqësor me ndjekjen e aktivizuar reale të komunikimeve në lidhje me personin konkret, numrin e telefonit ose email adresën. Në mungesë të mundësisë për këtë krahasim, Komisioni si organ mbikëqyrës nuk mund të konstatojë nëse një person ose një mjet komunikimi është ndjekur në mënyrë të paligjshme. Përveç komisioneve parlamentare për mbikëqyrje, në përputhje me nenin 35 të LNK-së, Drejtoria për Sigurinë e Informacioneve të Klasifikuara, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Avokati i Popullit mund të ushtrojnë mbikëqyrje edhe mbi autoritetet e autorizuara për ndjekjen e komunikimeve, operatorët dhe AOT. Me LNK u promovua edhe Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare si një organ i ri që ushtron mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e masave për ndjekjen e komunikimeve dhe mbi AOT. Këshilli vepron me iniciativë të vet ose sipas parashtresës së paraqitur nga një qytetar, kurse për punën e tij paraqet raport vjetor në Kuvend. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë nga radhët e ekspertëve dhe OJQ nga fusha e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sigurisë dhe mbrojtjes. Megjithatë, Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare nuk ka mundësi të veprojë i vetëm për të përcaktuar nëse, në lidhje me ndonjë person ose numër telefoni, komunikimet ndiqen në mënyrë të paligjshme. Me fjalë të tjera, pas marrjes së parashtresës, Këshilli duhet të paraqesë kërkesë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Ndjekjes së Komunikimeve në mënyrë që ai të kryejë mbikëqyrje dhe për të njëjtën ta njoftojë Këshillin brenda 15 ditëve. Relacioni i krijuar midis Këshillit për Mbikëqyrje Qytetare dhe Komisionit për Mbikëqyrje, e vë Këshillin në një pozitë të marginalizuar në raport me Komisionin. Nga ana tjetër, pozita e Këshillit për Mbikëqyrje Qytetare është marginalizuar edhe më shumë nga fakti se mbikëqyrja, e cila në përputhje me nenin 51, paragrafi 2, pika 2 të LNK-së, megjithatë mund të ushtrohet nga Këshilli, duhet të paralajmërohet dhe t' i referohet vetëm krahasimit të urdhrave të anonimizuar në 3 muajt e fundit. Mbikëqyrja teknike në AOT dhe operatorët, është e kufizuar vetëm në këqyrjen e urdhrin të anonimizuar të gjykatës dhe kontrollin e (regjistrave) të dhënave elektronike të krijuara dhe të ruajtura automatikisht në pajisjet teknike të ndërmjetësimit tek operatorë dhe tek AOT (neni 41 dhe 42 të LNK-së) të cilat kanë të bëjnë me kohën e aktivizimit dhe përfundimit të masave, numrin e urdhrave të anonimizuar gjyqësor dhe numrin e përgjithshëm të masave të zbatuara në një periudhë të caktuar kohore, ndërsa tek autoritetet e autorizuara, mbikëqyrja teknike është e kufizuar (neni 43 i LNK) vetëm në këqyrjen mbi urdhrin e anonimizuar gjyqësor dhe mbi dokumentet që kanë të bëjnë me fillimin dhe përfundimin e zbatimit të masës. Versioni bazik i ligjit nuk e rregulloi në mënyrë specifike statusin e Këshillit për Mbikëqyrje Qytetare, prandaj ky organ mbikëqyrës nuk ishte funksional për shumë vite. Së këtejmi, në vitin 2023, u miratuan ndryshimet në Ligjin për Ndjekjen e Komunikimeve²⁶, të cilat në mënyrë plotësuese i rregulluan mangësitë që e pamundësonin funksionimin e Këshillit. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ushtron mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale. Drejtoria për Sigurinë e Informacioneve të Klasifikuara ushtron mbikëqyrje mbi autoritetet e autorizuara për zbatimin e masave, operatorët dhe AOT në lidhje me trajtimin e informacioneve të klasifikuara. Avokati i Popullit, si autoritet që i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur ata cenohen me akte, veprime ose mosveprime të autoriteteve që kanë autorizime publike, mund të ushtrojë mbikëqyrje edhe mbi ligjshmërinë sa i përket zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve. Përveç subjekteve të listuara, një korrektor i duhur mbi punën e autoriteteve të përfshira në procesin e ndjekjes së komunikimeve është edhe media, sektori joqeveritar dhe publiku i gjerë.

²⁶ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndjekjen e Komunikimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 154/2023)

Konkluzione

Hulumtimi i implementuar, përmes analizës së kuadrit ligjor për aplikimin e MPH-ve, analizës së të dhënave relevante statistikore publikisht të aksesshme dhe diskutimeve brenda fokus grupeve me gjyqtarë, prokurorë publikë, inspektorë policie dhe avokatë, mundësoi krijimin e një panorame më të plotë dhe më të qartë sa i përket aplikimit praktik të MPH-ve dhe sfidave kryesore gjatë implementimit të tyre. Në bazë të njohurive të marra, konstatohen konkluzionet e mëposhtme:

Për kuadrin ligjor

Kuadri ligjor me të cilin është rregulluar aplikimi i MPH-ve u përmbyll në mënyrë solide me paketën e reformave të ligjeve që hynë në fuqi në vitin 2018. Megjithatë, në lidhje me zgjidhjet e caktuara ligjore, është evidente nevoja për përshtatje adekuate sa i përket ballafaqimit me sfidat me të cilat, në situata të caktuara, përballen autoritetet e sistemit të drejtësisë që marrin pjesë në propozimin, kërkesën, miratimin, zbatimin dhe kontrollin e MPH-ve. Nga ana tjetër, për çështje të caktuara, imponohet nevoja e specifikimit ose rregullimit ligjor me akte nënligjore përkatëse. Nga analiza e kuadrit ligjor dhe sfidave të identifikuar nga përfaqësuesit e autoriteteve të sistemit të drejtësisë, konkludohet si vijon:

- Lista e veprave penale për të cilat lejohet aplikimi i MPH-ve nuk është gjithëpërfshirëse dhe nevojitet të plotësohet me vepra ku këto masa do të kishin rezultate veçanërisht të rëndësishme, siç është tregtia e paligjshme me armë, me drogë.
- Duke e pasur parasysh zhvillimin tekniko teknologjik, telefonat celularë dhe pajisjet e tjera teknike (tableta, laptopë, orët smart, etj.) gjithnjë e më shumë përbëjnë mjet komunikimi dhe magazinimi të të dhënave sensitive nga jeta private. Edhe pse sekuestrimi i tyre nga prokuroria publike dhe policia gjyqësore nuk është parashikuar si një masë e posaçme hetimore, në praktikë ato përdoren si një mjet për sigurimin e provave. Kjo situatë ngre çështje në lidhje me shkallën e mbrojtjes së privatësisë së qytetarëve, duke qenë se masa është jashtëzakonisht invazive, megjithatë nuk është objekt i rregullimit specifik ligjor dhe kontrollit gjyqësor siç parashikohet për MPH.
- Mënyra e zbatimit të kontrollit gjyqësor mbi autoritetet e autorizuara për aplikimin e MPH, përfshirë këtu edhe aspektet teknike të këtij kontrolli, nuk është mjaft e qartë dhe e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse në kuadrin ligjor ekzistues, gjë që e vë në dukje nevojën e precizimit plotësues të tij.

Për të dhënat statistikore në lidhje me aplikimin e MPH

Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për aplikimin e MPH-ve përmbajnë të dhëna për numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe rezultatin e masave. Megjithatë, këto raporte nuk përmbajnë informacione mbi lidhjen me krimin e organizuar, mbi arsyet për shkak të të cilave në raste të caktuara nuk janë marrë rezultate relevante, si dhe mbi implikimet financiare nga aplikimi i MPH.

Në bazë të të dhënave të aksesshme statistikore, mund të nxirren konkluzionet si vijon:

- Aplikimi i MPH-ve shënon rritje më të theksuar në vitin 2018 dhe 2019, kurse më pas zvogëlohet, gjë që përkon me reformat në komunitetin e sigurisë dhe zbulimit.
- Numri më i madh i MPH-ve ndaj personave me identitet të përcaktuar është shënuar në vitin 2023, ndaj personave me identitete të panjohura në vitin 2015, kurse ndaj sendeve në vitin 2018.
- Më së shpeshti aplikohet masa e përcaktuar në nenin 252, paragrafi 1, pika 1, me aplikim më të madh në vitin 2018, ndërsa shpesh aplikohet edhe masa e përcaktuar në pikën 3, më së shumti në vitin 2018, kurse masat e tjera rrallë ose fare nuk përdoren.

- Vërehet varësia nga një numër i caktuar i MPH-ve (ndjekja e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike; këqyrje në komunikimet telefonike dhe në komunikimet e tjera elektronike të realizuara; ndjekja dhe regjistrimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose hapësirave afariste të shënuara si private), gjë që i referohet diversitetit të kufizuar në praktikë.
- Aplikimi i MPH zakonisht lëviz brenda afatit ligjor prej 4 muajsh të përcaktuar për caktimin e masave, ndërsa vazhdimet nuk janë të shpeshta dhe praktikohen në hetime komplekse për raste të krimit të organizuar.

Për propozimin e aplikimit të MPH

- Policia gjyqësore më së shpeshti i propozon Prokurorisë Themelore Publike aplikimin e MPH në rastet kur të gjitha masat e tjera më pak invazive për mbledhjen e të dhënave janë shteruar madje është evidente se hetimi nuk mund të përparojë pa informacione shtesë që mund të sigurohen vetëm përmes MPH.
- Punonjësit e policisë nga MPB dhe prokurorët publikë punojnë të koordinuar mbi ndonjë rast konkret para se të përgatitet kërkesa formale për aplikimin e MPH.
- Nërastin konkret kur dotë vlerësojë senukkanevojët e aplikohen MPH, prokurori publik nuk ia adreson propozimin gjyqtarit të procedurës paraprake në formë në kërkesë për miratimin e masave.

Për kërkesën në lidhje me përcaktimin e MPH

- Gjatë vlerësimit të propozimeve nga punonjësit e policisë të MPB për aplikimin e MPH, prokurorët publikë përballen me sfida kryesisht në rastet kur propozimi ka të bëjë me një person që është në paraburgim ose që e vuan dënimin me burgim, si dhe në rastet kur lokacioni për zbatimin e MPH është caktuar në mënyrë të pasaktë ose jo precize, apo identiteti i personave në lidhje me të cilët propozohen këto masa është caktuar në mënyrë të pasaktë.
- Ekziston një koordinim i mirë midis gjyqtarëve të procedurës paraprake dhe prokurorëve publikë në rastet kur kërkohet përcaktimi i MPH, kur nga e njëjta rezultojnë probleme teknike.
- Është krijuar një praktikë në të cilën gjyqtari i procedurës paraprake kërkon një plotësim ose sqarim nga prokurori publik në lidhje me propozimin për përcaktimin e MPH.
- Në çështjet e krimit të organizuar dhe në hetimet ndërkombëtare që zbatohen duke përdorur ndihmën e drejtësisë penale ndërkombëtare, kërkesat e prokurorëve publikë zakonisht mbështeten me informacione më të hollësishme dhe me njohuri paraprakisht të marra në lidhje me rastin specifik.
- Presioni nga shpejtësia dhe emergjenca në drejtim të sigurimit të provave të nevojshme është sfidë për veprimin e prokurorëve publikë dhe gjyqtarëve të procedurës paraprake në rastet kur ka nevojë për aplikimin e MPH.
- Gjyqtarët e procedurës paraprake dhe prokurorët publikë kanë qëndrime të ndryshme sa i përket asaj se gjyqtari i procedurës paraprake a duhet të futet në shqyrtimin material të çështjes para se të merret vendimi për miratimin e MPH.

Për vendimmarrjen në lidhje me aplikimin e MPH

- Kërkesat e prokurorit publik drejtuar gjyqtarit të procedurës paraprake për miratimin e MPH janë përgjithësisht me përmbajtje identike si edhe propozimet e policisë gjyqësore.
- Balancimi midis të drejtave të njeriut dhe nevojës për veprim urgjent në raste sensitive është sfidë për gjyqtarët e procedurës paraprake kur duhet të marrin vendim sipas kërkesës të prokurorit publik për aplikimin e MPH.
- Kriteret kryesore të cilat gjyqtarët e procedurës paraprake i marrin parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave të prokurorëve publikë për përcaktimin e MPH është respektimi i parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit në rastin konkret, si dhe fakti se a bëhet fjalë për grupe të organizuara kriminale dhe a përmban rasti element ndërkombëtar.

Për zbatimin e MPH

- Zbatimi operativ i MPH zhvillohet dhe është rregulluar me akte nënligjore të cilat klasifikohen me shkallën “Tepër Sekret” dhe në bazë të një plani të përgatitur.
- I gjithë dokumentacioni që përpilohet për propozimin, kërkesën dhe miratimin e MPH është i klasifikuar me një shkallë fshehtësie “Tepër Sekret”, që vlerësohet si një shkallë e panevojshme dhe tepër e lartë e fshehtësisë.
- Digjitalizimi i procedurës për propozimin, kërkesën, miratimin dhe lëshimin e MPH do të kontribuojë në kursimin e konsiderueshëm të kohës dhe resurseve gjatë zbatimit të masave.
- Sfidat gjatë zbatimit të MPH të karakterit teknik kanë të bëjnë me:
 - o Mungesën e kapaciteteve teknike për ndjekjen efektive në kohë reale dhe problemet me stabilitetin e linjës gjatë përgjimit në kohë reale.
 - o Mungesën e numrit të mjaftueshëm të automjeteve zyrtare të nevojshme për zbatimin e MPH ndjekjen dhe regjistrimin e fshehtë të personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirave afariste.
 - o Mënyra në të cilën përpunohen dhe analizohen transkriptet e komunikimeve të ndjekura kërkon shumë kohë dhe kështu ndikon në mënyrë indirekte në shpejtësinë dhe rezultatin e hetimit.
 - o Personat e përfshirë në aktivitete kriminale e përshtatin komunikimin e tyre dhe përdorin metoda inovative të komunikimit.
 - o Aftësi të kufizuara teknike për ndjekjen e komunikimeve që zhvillohen përmes aplikacioneve të sofistikuara.
 - o Problemet dhe zvarritjet gjatë përkthimit të transkripteve të marra nga ndjekja e komunikimeve.
- Sfidat gjatë zbatimit të MPH të karakterit institucional kanë të bëjnë me:
 - o Pamundësinë e policisë gjyqësore në raste të caktuara të veprjës menjëherë pas urdhrimit të lëshuar për MPH për shkak të resurseve të kufizuara teknike dhe njerëzore.
 - o Urdhrat e paplota në të cilët mungojnë informacione të rëndësishme për zbatimin e masës.
 - o Mbingarkimin e stafit të trajnuar ekzistues.

Për kohëzgjatjen e MPH

- Një pjesë e madhe e MPH-ve të miratuara zbatohen deri në fund të afatit për të cilin janë miratuar pavarësisht rezultateve të arritura përmes zbatimit të tyre.
- Propozimet për vazhdimin e zbatimit të MPH zakonisht miratohen, ndërsa arsyeja për këtë është nevoja për konfirmimin shtesë të informacioneve, ndjekjes së zhvillimeve të reja të rastit ose zbulimit të detajeve të reja të rëndësishme të rastit.
- Për shkak të specifikave të sistemit ACMIS, për vazhdimin e aplikimit të MPH shpesh nuk vendos gjyqtari i njëjtë i procedurës paraprake i cili e ka lëshuar urdhrin për përcaktimin e MPH.

Për masat e mbrojtjes së fshehtësisë së zbatimit të MPH

- Në procesin e vendimmarrjes sipas kërkesës për përcaktimin e MPH, me rastin konkret njoftohet gjyqtari i çështjes i procedurës paraprake, procesverbalisti dhe oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara.
- Rreziku i shkeljes së fshehtësisë së të dhënave në rastet e MPH është kontrolli joadekuat i aksesit në informacionet sensitive; mungesa e mjeteve përkatëse materiale-teknike për trajtimin e dokumenteve lidhur me MPH; ose zbulimi aksidental i të dhënave nga persona që nuk janë të trajnuar sa duhet për mbrojtjen e fshehtësisë së të dhënave.
- Digjitalizimi i procesit të miratimit dhe zbatimit të MPH do të ndikojë ndjeshëm në mbrojtjen e fshehtësisë së të dhënave dhe sigurinë e gjithë procesit.

Për përdorimin e MPH si provë në procedurën penale

- MPH tregojnë efikasitet dukshëm më të madh tek krimet që nuk kryhen në mënyrë të organizuar, ndërsa për shkak të specifikave të ekzekutimit të krimit të organizuar dhe përshtatshmërisë së personave të involvuar, masat jo gjithmonë kanë rezultat pozitiv.
- Sfidat që lindin gjatë përdorimit të MPH si provë në procedurë janë:
 - o Të folurit dhe fjalët që i përdorin personat në komunikimin e ndërsjellë që ndonjëherë interpretohen/përkthehen me vështirësi.
 - o Mospërfundimi i CD-disqeve.
 - o Regjistrimet me cilësi të dobët të zërit ose me të folur të paqartë.
 - o Mospërputhjet midis informacioneve të raportit kundrejt informacioneve në dosjet audio.
 - o Ekzistenca e dyshimeve nëse njohuritë e mbledhura përmes MPH nga një lëndë mund të përdoren si prova në një lëndë tjetër.
 - o Pamundësia e aksesit në dosjet audio për raste më të vjetra të trajtuara nga ish-Drejtoria e Sigurisë dhe Kundërzbulimit.
- Avokatëve të të pandehurve nuk ju sigurohet akses i plotë dhe në kohë të duhur në materialet e siguruara përmes MPH.

Për bashkëpunimin ndërinstitucional gjatë zbatimit të MPH

- Bashkëpunimi ndërinstitucional midis të gjitha autoriteteve dhe institucioneve që marrin pjesë në veprime procedurale në lidhje me MPH, është përgjithësisht i kënaqshëm.
- Komunikimi aktiv dhe konsultimet e rregullta zhvillohen vazhdimisht në relacionin MPB – Prokuroria Publike.
- Bashkëpunimi është veçanërisht cilësor në hetimet ndërkombëtare për procedurat që e përfshijnë ndihmën e drejtësisë penale ndërkombëtare.
- Qendrat hetimore në kuadër të prokurorisë janë shembull i mirë i punës së koordinuar dhe komunikimit të drejtpërdrejtë të inspektorëve të policisë dhe prokurorëve publikë.

Për trajnimin dhe resurset për përdorimin më efikas të MPH

- Të sapo punësuarit në njësitë organizative të MPB të cilët propozojnë dhe zbatojnë MPH përfshihen në problematikën specifike përmes një trajnimi dy javor në Akademinë Policore pranë MPB.
- Trajnimet e specializuara të fokusuara mbi aspektet teknike të zbatimit të MPH organizohen në partneritet me ministritë dhe policitë e vendeve të tjera . Trajnimet me trajnues dhe ekspertë vendor për analizën e të dhënave tani më nuk organizohen.
- Vazhdimësia e trajnimeve çrregullohet me ndryshimin e stafit udhëheqës në njësitë organizative.
- Nevojitet një trajnim i specializuar për prokurorët publikë dhe gjyqtarët në fushën e provave digjitale dhe teknologjive të reja hetimore me tema në fushën e kriptografisë, enkriptimit të të dhënave, sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjes së privatësisë.
- Trajnimi fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë nuk ofron simulime dhe ushtrime për përpilimin e dokumentacionit lidhur me kërkesat dhe urdhrat për zbatimin e MPH.
- Aspektet teknike të MPH nuk janë përfshirë aspak në programin mësimor të Akademisë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë.
- Një pjesë e avokatëve në praktikën e tyre profesionale nuk janë ballafaquar asnjë herë dhe nuk janë njoftuar sa duhet me procedurat për zbatimin e MPH.

Për kontrollin mbi aplikimin e MPH

- Prokurorët publikë i kontrollojnë inspektorët e ngarkuar për zbatimin e MPH përmes raporteve mujore që i paraqesin dhe përmes praktikës së krijuar të takimeve të rregullta koordinuese dhe takimeve e konsultimeve të drejtpërdrejta.
- Gjyqtarët e procedurës paraprake e kontrollojnë zbatimin e MPH përmes raporteve që i paraqet policia gjyqësore në Prokurorinë Publike; si dhe përmes kontrolleve ad hoc .
- Vizita në institucionet përgjegjëse për zbatimin e MPH të përcaktuara në nenin 252, paragrafi 1, pika 1 të LPP-së nuk janë vendosur si një praktikë e rregullt për shkak të mënyrës së pa definuar të zbatimit të kontrollit dhe mungesës së mbështetjes nga ekspertët teknikë të cilët, konform LNK-së, duhet të sigurohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Nevojitet përforsimi i kontrollit gjyqësor, veçanërisht në rastet e:
 - o Lëshimit të urdhrave për aplikimin e MPH për personat me identitet të panjohur.
 - o Këqyrjes mbi komunikimet telefonike të realizuara dhe komunikimet e tjera elektronike pa kërkuar zbatimin e MPH.
 - o Sekuestrimit të telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera të komunikimit teknik vetëm me një vërtetim për sendet e sekuestruara përkohësisht.

Rekomandime

Në bazë të sfidave dhe konstatimeve të identifikuara, me qëllim të avancimit të aplikimit të MPH-ve dhe përforsimit të kapaciteteve institucionale, është e këshillueshme të mendohet në drejtimin si vijon:

- 1. Zgjerimi i bazës ligjore** - Lista e veprave penale për të cilat mund të aplikohen MPH-të të zgjerohet dhe ta përfshijë veprën penale “Prodhimi, mbajtja, ndërmjetësimi dhe tregtia e paautorizuar me armë dhe materie eksplozive” të nenit 396 të KP.
- 2. Zhvillimi i metodologjisë së unifikuar për llogaridhënie dhe përpilimin e raporteve vjetore për aplikimin e MPH-ve,** e cila do të mundësojë: një pasqyrim më të qartë të lidhjes midis masave të aplikuara me krimin e organizuar, evidentim sistematik dhe konsistent të rezultateve të masave të zbatuara brenda vitit, përfshirë edhe ato që vazhdojnë në periudhën e ardhshme llogaridhënëse, dhe përcaktim objektiv dhe preciz të implikimeve financiare nga aplikimi i MPH-ve, me ç’rast do të fuqizohet transparenca, konsistenca dhe cilësia e raporteve vjetore të Prokurorisë Publike.
- 3. Koordinimi i përforsuar** - Vendosja e një praktike të koordinimit të rregullt midis prokurorit publik dhe udhëheqësve të njësive organizative të ngarkuar me kërkimin dhe zbatimin e MPH, me qëllim shmangien e dërgesës së urdhrave gjyqësor në policinë gjyqësore të cilat nuk mund të zbatohen menjëherë.
- 4. Propozimi i centralizuar i MPH** - Të mundësohet propozimi i centralizuar i aplikimit të MPH, me ç’rast do të arrihet një koordinim më i mirë midis sektorëve të ndryshëm organizativë në policinë gjyqësore.
- 5. Përfshirja e hetuesve në ndjekjen** - Në procedurat e ndjekjes së komunikimeve të përfshihen inspektorët që e hetojnë rastin konkret dhe që janë të njohur me specifikat dhe mënyrën e komunikimit të personave të involvuar.
- 6. Thjeshtimi i procedurave** - Të racionalizohet procesi i përpunimit dhe analizës së transkripteve nga komunikimet e ndjekura, gjë që do të rrisë efikasitetin dhe zbatimin në kohë të procedurës.
- 7. Kontinuiteti i vendimmarrjes gjyqësore gjatë vazhdimin të MPH** - Të sigurohet që lënda dhe vendimmarrja për vazhdimin e MPH konkrete të mbeten në kompetencën e të njëjtit gjyqtar të procedurës paraprake që e lëshoi urdhrin fillestar, me ç’rast do të sigurohet kontinuiteti, konsekuenca dhe siguria më e madhe juridike.
- 8. Rishikimi i vlerës procedurale të provave specifike** - Të rishikohet vlera procedurale e provave të siguruara përmes MPH nëpërmjet personave me

identitet të fshehur, nëpërmjet regjistrimeve të bëra nga qytetarët, si dhe nëpërmjet mitë dhënies dhe mitë marrjes së simuluar të kryera pa urdhër nga prokurori publik, me qëllim sigurimin e harmonizimit të tyre me parimet e ligjshmërisë dhe gjyqimit të drejtë.

9. Procedura më të rrepta dhe kontroll i përforcuar gjyqësor - Përfshirja e procedurave më të rrepta dhe shkallës më të lartë të kontrollit gjyqësor në përdorimin, vlerësimin dhe prodhimin e provave të siguruar përmes MPH, me qëllim parandalimin e abuzimeve të mundshme dhe garantimin e procedurës të drejtë.

10. Optimizimi i shkallës së fshehtësisë së dokumentacionit për MPH - Ulja e klasifikimit nga "Top Sekret" në "Konfidencial", gjë që do të mundësojë trajtim më efikas dhe më ekonomik të informacioneve, pa prishur nivelin e nevojshëm të mbrojtjes.

11. Deklasifikimi në kohë i materialeve - Të bëhen përpjekje që deklasifikimi i materialeve të siguruar me MPH, kur është e nevojshme, të bëhet brenda afateve më të shkurtra kohore, për të siguruar përdorimin në kohë të tyre në procedurë.

12. Akses i mbrojtjes në materialet nga MPH - T'u mundësohet avokatëve të të pandehurve këqyrje në kohë mbi materialet e siguruar me MPH para mbajtjes së seancës kryesore, me ç'rast do të sigurohet realizimi efektiv i të drejtës për mbrojtje.

13. Zbatimi i shkatërrimit të të dhënave të siguruar me MPH - Të sigurohet zbatim konsistent të dispozitave ligjore për shkatërrimin e të dhënave të siguruar përmes aplikimit të MPH, në rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së të drejtave të personave të interesuar, zvogëlimin e rrezikut të mbajtjes së pajustificuar të informacioneve të klasifikuara dhe të dhënave personale si dhe forcimin e integritetit dhe besimit në procedurat që kanë të bëjnë me MPH.

14. Mbrojtja e privilegjit avokat-klient - Të braktiset praktika e dëgjimit të bisedave telefonike të realizuara midis të pandehurit dhe avokatit të tij në sallën e gjyqimit gjatë një seance, pasi kjo e cenon konfidencialitetin avokat-klient dhe të drejtën për mbrojtje.

15. Rregullimi i qartë i kontrollit gjyqësor - Të përcaktohet në mënyrë më të detajuar mënyra e zbatimit të kontrollit gjyqësor mbi autoritetet e autorizuara për aplikimin e MPH, duke i përfshirë aspektet teknike të këtij kontrolli, me qëllim rritjen e sigurisë ligjore dhe llogaridhënies.

16. Dialogu institucional dhe harmonizimi i praktikës - Të vendoset praktikë e rregullt e organizimit të takimeve midis gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe inspektorëve që punojnë në zbatimin e MPH-ve, për diskutimin e sfidave dhe harmonizimin e pikëpamjeve rreth çështjeve kontestuese.

Literatura e përdorur

botimet:

- Council of Europe, Recommendation CM/Rec (2017) 6 of the Committee of Ministers to member States on “special investigation techniques” in relation to serious crimes including acts of terrorism.
- Deployment of Special Investigative Measures, COE, Office in Belgrade, Serbia, 2013, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/deployment-of-special-investigative-means-eng/16807828fa>.
- Hert, P. (2005). Balancing security and liberty within the European human rights framework. A critical reading of the Court’s Case law in the light of surveillance and criminal law enforcement strategies after 9/11. *Utrecht Law Review* 1: 68–96.
- McBride, J. (2018). *Human Rights and Criminal Procedure*, 2-nd Ed., Council of Europe.
- The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts’ Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, Brussels, 8 June 2015. https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2016-12/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf
- Turanjanin, V. (2022). Special investigative measures: Comparison of the Serbian Criminal Procedure Code with the European Court of Human Rights Standards, *The International Journal of Evidence & Proof*, Vol. 26(1) 34–60.
- Jankulovski, Z. (2000). Mbrojtja e privatësisë në Republikën e Maqedonisë (duhet të ndryshohet neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë) në Polici, Prokurorinë Publike, Gjykatë dhe Avokaturë në Procedurën Parapenale, Shoqatën për Drejtësi Penale dhe Kriminologji të Maqedonisë, Shkup.
- Kallajxhiev, G. (2004). Kuadri kushtetues i privatësisë dhe masat e reja hetimore, Përmbledhje e Fakultetit Juridik “Justinianus Primus”, Shkup.
- Kallajxhiev, G., Gjurçilova, P. (ed.). (2019). *Manual për Zbatimin e Masave Për Ndjekjen e Komunikimeve*, DCAF - Qendra për Qeverisje në Sektorin e Sigurisë - Gjenevë, Zyra në Shkup.
- Kallajxhiev, G., Lazhetiç Buzharovska, G., Misoski, B., Iliq Dimoski, D. (2015). *E drejta e procedurës penale*, Shkup.
- Kalajxhiev, G., Llazetiç, G., Nedellkova, Ll., Denkovska, M., Trombeva, M., Vitlarov, T., Jankulovska, P., Kadiev, D. (2018). *Koment mbi Ligjin e Procedurës Penale*, OSBE, Shkup.
- Liç, F. (2010). *Paraqitja e lëndës në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, Tabernakul, f.
- Marjanoviç, GJ. (2002). *Për përgjimin dhe për (pa) përgjegjësinë*, Përmbledhja e Punimeve Eurointegrimi - Idetë, Situatat, Realizimi, Fakulteti Juridik Justinianus Primus, Shkup.
- Matovski, N. (2005). *Ndryshimi i Ligjit për Procedurën Penale i Republikës së Maqedonisë të vitit 2004*, Shkup.
- Periç, C. etj. (2024). *Udhëzues për Shkatërrimin e të Dhënave të Mbledhura me Masat e Posaçme Hetimore*. Shkup: DCAF, <https://jorm.gov.mk/vodich-zanishtene-podatoczi-sobrani-so-posebni-istrashni-merki/>

aktet ligjore:

- Ligji për Punë të Brendshme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 160/2025)
- Ligji për Procedurën Penale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 150/2010, 100/2012, 142/2016 dhe 198/2018). Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U. nr. 2/2016 i 28 shtator 2016, botuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 193/2016
- Ligji për Agjencinë Operative - Teknike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/2019)
- Ligjin për Ndjekjen e Komunikimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 108/2019 dhe 154/2023)

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52/1991), me Amendamentet I dhe II të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 1/1992), Amendamenti III i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/1998), Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 91/2001), Amendamenti XIX i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 84/2003), Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX dhe XXX të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 107/2005), Amendamenti XXXI i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 3/2009), Korrigjimi i Amendamentit XXXI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 13/2009), Amendamenti XXXII i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 49/2011), Amendamentet XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 6/2019) dhe Shpallja (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 36/2019).

raportet:

- Raportet vjetore të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me zbatimin e masave të posaçme hetimore për periudhën 2019-2024 <https://jorm.gov.mk/category/dokumenti/izvestai/>
- Raportet vjetore mbipunëne Agjencisë Operative-Teknike për periudhën 2018-2024 <https://ota.mk/odnosi-so-javnost/izvestai>

ANEKSI I

PYETJE PËR FOKUS GRUPIN ME INSPEKTORËT DHE HETUESIT E POLICISË

1. Cilat janë arsyet më të shpeshta për shkak të të cilave policia gjyqësore ia propozon prokurorisë publike aplikimin e masave të posaçme hetimore?
2. Me cilat sfida ballafaqoheni gjatë mbledhjes dhe paraqitjes së provave për justifikimin e propozimit?
3. Si e vlerësoni bashkëpunimin me Prokurorinë Publike në inicimin e masave të tilla?
4. A u refuzuan propozime të caktuara dhe cilat ishin arsyet kryesore për këtë?
5. Me cilat sfida logjistike dhe teknike ballafaqoheni gjatë zbatimit të masave?
6. Çfarë kontrolli ushtrohet mbi zbatimin e masave të posaçme hetimore dhe nga kush?
7. A ka nevojë për trajnime shtesë ose resurse për përdorimin më efikas të masave të posaçme hetimore?

PYETJE PËR FOKUS GRUPIN ME PROKURORËT PUBLIKË

1. A janë propozimet për aplikimin e MPH zakonisht të arsyetuara dhe të argumentuara mirë?
2. Cilat janë sfidat kryesore ligjore dhe faktike gjatë vlerësimit të propozimeve nga policia gjyqësore për aplikimin e masave të posaçme hetimore?
3. A keni refuzuan propozime të caktuara dhe cilat ishin arsyet kryesore për këtë?
4. A ka raste kur propozimet kanë qenë formalisht të sakta por ju nuk i keni paraqitur në gjykatë në formën e kërkesës? Nëse po, pse?
5. Si e vlerësoni bashkëpunimin me policinë gjyqësore në procesin e propozimit dhe për gatitjes së kërkesave?
6. Si e vlerësoni vendimmarrjen gjyqësore në lidhje me miratimin apo refuzimin e masave?
7. A jeni ballafaqur me pengesa ligjore, institucionale ose teknike gjatë aplikimit të masave të posaçme hetimore?
8. Si e kontrolloni zbatimin e masave të posaçme hetimore?

PYETJE PËR FOKUS GRUPIN ME GJYQTARËT

1. Cilat janë kriteret kryesore që i merrni në konsideratë gjatë miratimit apo refuzimit të kërkesave për masat e posaçme hetimore?
2. A janë, kërkesat për lëshimin e urdhrit për aplikimin e MPH, zakonisht të arsyetuara dhe argumentuara mirë?
3. Cilat janë mangësitë më të shpeshta në kërkesat e paraqitura nga prokuroria publike?
4. Si e vlerësoni bashkëpunimin, komunikimin dhe koordinimin ndër-institucional të autoriteteve kompetente të ngarkuara për zbatimin e masave të posaçme hetimore me prokurorinë dhe gjykatën?
5. Për cilat arsye kërkohet më shpesh vazhdimi i masave të posaçme hetimore?
6. Nëse dhe në bazë të cilave prova në praktikën tuaj është zgjeruar urdhri për masën e posaçme hetimore?

7. A ndërmerren masa mjaftueshëm efektive për mbrojtjen e fshehtësisë së zbatimit të masave të posaçme hetimore?
8. Si e kontrolloni zbatimin e masave të posaçme hetimore?
9. A mendoni se kuadri ligjor ekzistues mjaftueshëm i përcakton kushtet për aplikimin e këtyre masave?
10. A ka shembuj të praktikës gjyqësore ku masat e posaçme hetimore janë përjashtuar si prova të siguruara në mënyrë të paligjshme dhe për cilat arsye?
11. Me cilat sfida ballafaqoheni gjatë nxjerrjes së provave që janë siguruar përmes aplikimit të masave të posaçme hetimore?

PYETJE PËR FOKUS GRUPIN ME AVOKATËT

1. A jeni të mendimit se ka kontroll dhe mbikëqyrje të mjaftueshme gjyqësore mbi zbatimin e MPH-ve?
2. A keni akses të plotë dhe në kohë të duhur në materialet e siguruara përmes MPH-ve kur mbroni një klient?
3. Çfarë sfidash ekzistojnë gjatë përdorimit të provave të siguruara përmes MPH-ve në procedurat gjyqësore?
4. A ekziston praktikë e standardizuar apo a shihni dallime midis gjykatave ose gjyqtarëve të ndryshëm gjatë aprovimit ose përjashtimit të materialeve provuese të siguruara përmes MPH-ve?
5. A mendoni se duhet të ketë më shumë trajnime profesional për avokatët në lidhje me këtë çështje?



APPLICATION OF SPECIAL INVESTIGATIVE MEASURES IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Skopje, 2026

Authors:

Prof. Dr.sc. Biljana Karovska Andonovska, Ass. Prof. Dr.sc. Kire Babanoski, Prof. Dr.sc. Gordan Kalajdjiev, Daniela Dimovska MA, Sandra Krstikj, Pajazit Pajaziti, Nenad Saveski MA, Ermon Neziri, Natasha Saramandova, Verica Berzhecka Krsteva MA, Engjelushe Leshi Kadriu, Gavril Bubevski, Spasenka Andonova, Snezhana Petrovikj Arsovska, Aleksandar Tumanovski MA, Gent Salihi MA, Radmila K.Onchevska MA

Editor

MSc Gent Salihi

Number of pages 152 / Printed by Polyesterday Skopje / Copies printed 250

Publisher:



©DCAF, 2025 All rights reserved DCAF – Geneva Center for Security Sector Governance
Maison de la Paix Chemin Eugène-Rigot 2E, CH1202- Geneva, Switzerland

©DCAF, 2025 All rights reserved DCAF – Geneva Center for Security Sector Governance – Geneva
Branch Office, Skopje
Str. Macedonia No. 11-1/2, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia

The survey was conducted within the framework of the Intelligence and Security Sector Reform Program in the Republic of North Macedonia, conducted by DCAF – Geneva Center for Security Sector Governance and financially supported by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC), the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands and the Swedish Agency for International Development (SIDA). The program, among other things, assists judicial institutions and legal practitioners in strengthening their capacities and expertise necessary to consistently conduct the process of requesting and judicial approval of special investigative measures.

The contents of this publication do not express the views and opinions of donors or DCAF.



Foreword

The decision to conduct this study arose from the need to systematically analyze the application of Special Investigative Measures (SIMs) in the case law of the Republic of North Macedonia. Such an approach allows for a better understanding of the ways in which SIMs are approved, implemented and monitored, in order to identify practical challenges and formulate guidelines for their advancement.

The methodology for conducting the survey was based on a combined approach that links qualitative and quantitative methods, including analysis of the legal framework, presentation and processing of official statistics, and conducting focus groups. Through this approach, a complete picture of the normative, institutional, and practical aspects of the implementation of SIMs has been provided.

The process of conducting the survey covered several stages: data collection and systematization, organization of four focus groups with judges, public prosecutors, police inspectors, investigators and lawyers, as well as analysis of the findings. Through this process, several key issues related to the legal framework, practice, and control in the implementation of SIMs have been identified.

The expectation that was set before this survey was to obtain reasoned insights that would contribute to increased transparency and accountability in the implementation of the measures, as well as concrete recommendations for advancing procedures. The results obtained showed that such a systematized approach not only offers a critical reflection on the current situation, but also forms the basis for future further improvements to the institutional and legal framework. Future steps related to this research should be aimed at further application and practical verification of the recommendations made, as well as continuous monitoring of trends in the application of the measures in case law.

The process is part of the **Intelligence and Security Sector Reform Program in the Republic of North Macedonia**. The development of the methodology, research and analysis was conducted through a series of activities (coordination meetings, focus groups, round tables, workshops, etc.) organized by DCAF - Geneva Center for Security Sector Governance, in the period October 2023 - October 2025. The conduct of the research was initiated at the request of the Judicial Expert Group of DCAF Skopje and approved by the Academy of Judges and Public Prosecutors in accordance with the recommendations of the Manual for the Implementation of Special Investigative Measures and the Guide to the Deletion of Data Collected by means of Special Investigative Measures.

The report of this research is a collaborative effort of all participants. During the workshops, legal practitioners and experts discussed established international standards, analyzed the findings of the focus groups, and the legal obligations related to the implementation and control of the measures. Through a participatory process, the objectives and content of the document, the methodology developed, and the finalized text were defined, which was later shared with the competent institutions. In this way, additional expert verification and compliance with the needs of institutions in the application of the SIMs was ensured.

DCAF - Geneva Center for Security Sector Governance
Skopje, February 2026

Statement by the Director of the Academy for Judges and Public Prosecutors

The modern forms of crime, especially organized crime, cannot be detected nor can evidence be secured without the application of special investigative measures. These measures are determined only in cases where relevant evidence cannot be obtained through other evidentiary means. Their application is strictly limited, yet necessary for the effective detection and proving of the most serious forms of crime. They represent an interference with certain human freedoms and rights guaranteed by the Constitution and international agreements, carried out for the purpose of protecting the state and citizens from organized crime, corruption, terrorism, as well as for ensuring a successful fight against them.

In this sense, special investigative measures enable the collection of information that would otherwise remain inaccessible due to their concealed and complex nature. Criminal organizations continuously introduce innovations in the way they operate, which is why it is important for states to update their investigative techniques in order to conduct successful investigations.

The significance of these measures derives not only from their operational efficiency, but also from their legal sensitivity. According to the standards of the European Court of Human Rights, any restriction of the right to privacy, guaranteed by Article 8 of the European Convention on Human Rights, must be proportional to the legitimate aim, strictly necessary in a democratic society, and accompanied by appropriate safeguards against abuse. In our country, the special investigative measures are aligned with European standards, and their application is subject to strict judicial oversight, written justification, and time limitation.

This research aims to provide a systematized analysis of the legal framework and practical aspects of the application of special investigative measures, to connect the domestic regulation with European and comparative practice, and to offer guidance for public prosecutors, judges, and investigators. The goal is to provide a practical, clear, and applicable tool for enhancing expertise, harmonizing practice, and strengthening legal certainty in the process of determining these measures. We believe that this analysis will contribute to further strengthening the role of judges and public prosecutors as guardians of the rule of law and protectors of human rights in criminal proceedings.

Special gratitude goes to DCAF for the successful long-term cooperation within the “Intelligence and Security Sector Reform Programme in the Republic of North Macedonia (2021-2026),” specifically the project component related to strengthening the capacities of domestic judicial authorities regarding the application and oversight of invasive information-gathering methods used by law enforcement and intelligence services.

Irina Trajkoska-Strezoski

Director of the Academy for Judges and Public Prosecutors “Pavel Shatev”, Skopje
Skopje, February 2026

CONTENTS

Foreword	106
Statement by the Director of the Academy for Judges and Public Prosecutors	107
List of tables	109
List of charts	109
List of abbreviations used	109
Introduction	110
1. Methodology	111
1.1. Theoretical definition of the subject of the research	111
1.2. Research objectives	114
1.3. Research timeline	115
1.4. Research methods	116
1.5. Expected results and implications	117
1.6. Justification of the research	117
2. Legal framework for special investigative measures	118
3. Dynamic and trends in the application of special investigative measures	120
4. Proposal for Special Investigative Measures (SIMs)	129
5. Request for the application of Special Investigative Measures (SIMs) ...	130
6. Decision on the application of Special Investigative Measures (SIMs) ...	131
7. Conducting special investigative measures	132
7.1. Duration of special investigative measures	134
7.2. Measures for the protection of the confidentiality of the implementation of special investigative measures	135
8. Use of special investigative measures as evidence in criminal proceedings	136
9. Inter-institutional cooperation in the application of special investigative measures	138
10. Training and resources for the more effective use of special investigative measures	139
11. Control and supervision of the implementation of special investigative measures	140
11.1. Oversight of the implementation of special investigative measures	140
11.1.1. Judicial oversight of the application of special investigative measures	140
11.1.2. Control by the public prosecutor over the application of special investigative measures	141
11.2. Oversight of the application of special investigative measures	142
Conclusions	145
References	149
Recommendations	151
ANNEX I	152

List of tables

Table 1. A comparative overview of the data to be included in the annual SIMs reports by the Public Prosecutor Office of the Republic of North Macedonia	122
Table 2. Overview of cases with applied SIMs for the period 2010-2024	123
Table 3. Overview of applied SIMs by type of measure for the period 2015-2024	125
Table 4. Overview of cases on the duration of application of SIMs under Art. 252, paragraph 1, item 1 for the period 2019-2024, in months	127
Table 5. Overview of the number of activated communications from OTA according to authorized bodies for the period 2018-2024	128

List of charts

Figure 1 Overview of cases with applied SIMs for the period 2010-2024	124
Figure 2 Overview of the total number of applied SIMs for the period 2015-2024	125
Figure 3 Overview of applied SIMs under Art. 252, paragraph 1, items 1, 3 and 6 for the period 2015-2024	126

List of abbreviations used

ACCMIS	Automated Court Case Management Information System
ECHR	European Convention on Human Rights
ECtHR	European Court of Human Rights
CPC	Criminal Procedure Code
LIC	Law on Interception of Communications
ICT	Information and communications technology
etc.	and so on
PPO	Public Prosecutor's Office
CC	Criminal Code
MOI	Ministry of the Interior
month.	Months
BPPO	Basic Public Prosecutor's Office
BPPOPOCC	Basic Public Prosecutor's Office for Prosecution of Organized Crime and Corruption
OTA	Operational-Technical Agency
SIM	Special investigative measures
SPPO	Special Public Prosecutor's Office
para.	paragraph
PO	Financial Police Office
Art.	Article

Introduction

Special Investigative measures (SIMs) are techniques applied by the competent authorities in the context of criminal investigations to prevent, detect, investigate, prosecute and suppress serious crimes¹. They have a high evidentiary value, but they also pose a serious invasion of the privacy of suspects². Their nature is invasive and often indiscriminate, both in personal and content terms. They are considered unconventional measures that, from a human rights perspective, are bordering on justification because they impose a necessary departure from traditionally protected values.

Because of these characteristics, SIMs open dilemmas related to guarantees of individual rights, justification for invasion of individuals' privacy, public versus personal safety, the presumption of innocence, and other sensitive issues. However, their incorporation into criminal procedure legislation decades ago has been imposed as an alternative to effectively tackling organized crime and its transnational forms. There is no doubt that in modern democratic societies, SIMs are an adequate means of preventing and detecting crimes. Their legalization meant accepting a kind of compromise between requirements to protect public safety, versus guarantees of respect for human rights. In striking a balance between these core interests, it is crucial to strive to minimize the possibilities of infringement of individual rights as a function of security. The state should build a legal framework that will provide adequate and effective protection against the eventual misuse of SIMs and in each specific case provide clear evidence of the necessity of their application.

SIMs have been a part of Macedonian criminal procedural practice for about twenty years. Their practical application began in 2005, and the trend of increase became evident in 2008, when legal conditions were created for the implementation of the special investigative measures that includes monitoring communications under conditions and procedures established by a special law. Namely, as a member of relevant international organizations that, at the end of the 20th century, began to seriously address the problem of organized crime, transnational crime, and terrorism, the Republic of Macedonia was obliged to align itself with ongoing and upcoming reform efforts aimed at effectively preventing and suppressing these contemporary socially negative phenomena.

The reforms of the criminal procedure legislation and the introduction of the so-called unconventional methods for dealing with contemporary public security challenges, among other things, were to include the introduction of special methods and the use of techniques which also involve a departure from the constitutional guarantees of the right to privacy, the secrecy of communications, the inviolability of the home and the security of personal data.

The process of authorizing and implementing special investigative measures is complex and multi-layered. This process involves various entities, which are in turn subject to oversight and control by other relevant bodies. Each entity, within the scope of its authority, must carefully assess the necessity of intruding into individuals' privacy in light of all the circumstances of the case. In accordance with international standards, it is not permissible to a priori downplay privacy in favor of the interest in safeguarding security.

This research analyzes the justice system (prosecutorial and judicial) practice of approving, implementing and controlling SIMs. The analysis is based on the assumption that the various actors in this process face a number of challenges, each from their own

¹ Council of Europe, Recommendation CM/Rec (2017) 6 of the Committee of Ministers to Member States on "special investigation techniques" in relation to serious crimes including acts of terrorism.

² Hert, P. (2005). Balancing security and liberty within the European human rights framework. A critical reading of the Court's Case law in the light of surveillance and criminal law enforcement strategies after 9/11. *Utrecht Law Review* 1: 68-96.

perspective of procedural competence. Among these is, of course, the challenge of balancing the general interest in safeguarding security against the interest of individuals in having their privacy respected. The generally accepted standard that the individual interest in privacy should be overridden only if it is assessed to be the only way to protect another high societal interest. This places an obligation on the competent authorities in this process to respect the principle of proportionality and to propose and approve SIMs only if their implementation is necessary as a last resort, *ultima ratio*, in a specific case. This requires the application of the principle of subsidiarity or proportionality, that is, to start with the application of a less intrusive measure and proceed to a more intrusive one, and the implementation of the most intrusive measures should only be sought and permitted if the less intrusive ones do not yield the expected result.

The goal set in this research is aimed at a comprehensive and realistic understanding of all challenges and drawing relevant conclusions regarding the application of SIMs. Guided by this goal, the research was conducted using several relevant scientific-research methods³. During their implementation, not a single segment of the series of procedural actions taken during the approval and implementation of SIMs was omitted, starting with the proposal for the application of SIMs which the judicial police submits to the public prosecutor's office, through the request of the public prosecutor's office for approval of SIMs which it submits to the court, the issuance of an order for SIM by a preliminary hearing judge, the implementation of SIMs by the authorized bodies, the control and supervision over the implementation, and all the way to the use of the results of the implemented SIMs in criminal proceedings. The proposals for overcoming the challenges, which could affect the improvement of practice, are the result of these observations. In the research, an effort was made to impartially consider the different perspectives of the subjects involved in this complex process. In doing so, the perceptions of investigators in the judicial police who work on collecting operational information regarding a specific criminal law event and who propose the application of SIMs, the public prosecutors in the basic public prosecutor's offices together with the investigators in the investigative centers at the basic public prosecutor's offices, the preliminary hearing judges, the authorized persons who work on implementing approved SIMs within the authorized bodies, as well as the trial judges, were included and taken into account in the investigation. The perception of the defense was not omitted either, through the challenges faced by the defenders of the suspects in the investigation, respectively the accused in the criminal proceedings.

In the research, the statistical data from the twenty-year application of SIMs in Macedonian judicial practice were also analyzed. As a relevant basis for the investigation, the official data contained in the annual reports of the Public Prosecutor's Office of the Republic of North Macedonia, which pursuant to Art. 271 of the Criminal Procedure Code (CPC) are submitted to the Assembly of the Republic of North Macedonia, were used. On the basis of these data, the trend of approval of SIMs was tracked and commented on. The subject of analysis also included the achievements from the application of approved special investigation measures in terms of expediency and the final outcome which resulted in an appropriate court decision.

1. Methodology

1.1. Theoretical definition of the subject of the research

The development of information and telecommunications technology (ICT) and its reach and presence in citizens' daily lives have significantly facilitated the commission of criminal offenses and communication among perpetrators. Conversely, scientific and technological advances have progressively improved criminalistic-operational practices for detecting modes of commission and perpetrators. These modern means constitute sources of numerous, and at the same time exceptionally high-quality and valuable, evidence through which criminality is proven

³ The methodology for conducting this research was proposed by Prof. Dr. Boban Misoski, Prof. Dr. Aleksandra Gruevska-Drakulevski, and Prof. Dr. Besa Arifi.

before the courts⁴.

